

NORA HALIMI

ART FIGURATIV

TEKST MËSIMOR PËR VITIN E DYTË TË GJIMNAZIT

ART FIGURATIV PËR VITIN E II (dytë)

Arsimi i gjimnazit

Miratuar nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, në bazë të Vendimit nr. 26-560/1, datë 4.5.2026.

Titulli original: Ликовна уметност за II (втора) година, гимназиско образование

Botues

Litera Group, Shkup, 2026

Autore

Nora Halimi

Kryeredaktore

Ajnure Selmani

Redaktore

Samije Limani Musliu

Bashkëpunëtore profesionale

Ana Frangovska

Komisioni recensues nga MASH

Akademik Nevzat Bejtuli - Kica

Prof. dr. Nehat Beqiri

Katerina Filiposka Stefanovska

Përktheu nga maqedonishtja në shqip

Nora Halimi

Redaktim profesional

Rina Adili

Redaktim gjuhësor

Lirim Shala

Dizajni

Litera Group - Arbana Dehari, Nora Halimi

Redaktim grafik dhe teknik

Litera Group

Shtypi

Polyesterday - Shkup

Tirazhi

1900

© 2026 Litera Group. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara.

Ndalohet kopjimi, riprodhimi, regjistrimi, shpërndarja, vënia në dispozicion të publikut ose transmetimi i çfarëdo pjese të këtij libri shkollor, në çfarëdo forme ose me çfarëdo mjeti elektronik ose mekanik, pa autorizimin paraprak me shkrim të botuesit.

CIP - Каталогизација во публикација

Национална и универзитетска библиотека "Св. Климент Охридски", Скопје

73/76(075.3)=18

HALIMI, Nora

Art figurativ : për vitin e II (dytë) : arsimi i gjimnazit / Nora

Halimi ; [përktheu nga maqedonishtja në shqip Nora Halimi]. - Shkup :

Litera Group, 2026. - 127 стр. : илустр. ; 30 см

Превод на делото: Ликовна уметност : за II (втора) година : гимназиско образование. - Fjalor i posioneve: стр. 122-126. - Библиографија: стр.

127

ISBN 978-608-4855-90-3

COBISS.MK-ID 69177861

PARATHËNIE

Arti është një nga format universale të shprehjes njerëzore që lidh të kaluarën, të tashmen dhe të ardhmen. Ai është dritare drejt mendimit dhe emocionit njerëzor dhe pjesë thelbësore dhe e qëndrueshme e përvojës njerëzore. Arti figurativ pasqyron larminë e shprehjes krijuese të kulturave të ndryshme dhe na ndihmon të kuptojmë botën që na rrethon. Nëpërmjet formave vizuale, njeriu gjatë historisë ka përcjellë mendimet, ndjenjat dhe idetë e veta, duke krijuar vepra që dëshmojnë për kohën, shoqërinë dhe kulturën në të cilat kanë lindur.

Arti figurativ ka rol të rëndësishëm në arsim sepse nxit të menduarit krijues, edukimin dhe kulturën vizuale dhe aftësinë për të shprehur mendime e ndjenja. Nëpërmjet edukimit figurativ, nxënësit mësojnë të vëzhgojnë, të analizojnë dhe të interpretojnë përmbajtje vizuale, si dhe të zhvillojnë mendimin kritik dhe vetëdijen estetike.

Ky tekst mësimor u kushtohet nxënësve të vitit të dytë të gjimnazit dhe është hartuar në përputhje me Programin mësimor të Ministrisë së Arsimit dhe të Shkencës të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Ai mbështetet në njohuritë e fituara gjatë vitit të parë dhe synon njohjen me artin modern në botë dhe në Republikën e Maqedonisë së Veriut, me shprehjen figurative, artin në hapësirë, dizajnin, komunikimin vizual dhe artin digjital.

Brenda njësive tematike, nxënësit do të gjejnë shembuj vizualë, nocione kyçe, aktivitete, të dhëna interesante dhe pyetje që nxisin pjesëmarrjen aktive në procesin mësimor, duke u ndihmuar të ndërtojnë një marrëdhënie personale me artin në kontekstin më të gjerë të historisë, të shprehjes figurative dhe të komunikimit vizual.

Duke studiuar këto përmbajtje, nxënësit do të fitojnë njohuri themelore dhe do të zhvillojnë aftësi për të kuptuar më tej artin dhe rolin e tij në kontekstin bashkëkohor, kulturor e shoqëror. Arti figurativ në arsimin bashkëkohor lidh praktikatat tradicionale me mediat digjitale dhe teknologjitë e reja.

Shpresoj që ky tekst mësimor të jetë i dobishëm për mësimdhënësit gjatë realizimit të programit mësimor dhe t'i përgatisë nxënësit për pjesëmarrje aktive dhe të përgjegjshme në mjedisin dinamik vizual të shoqërisë bashkëkohore.

Nora Halimi

PËRMBAJTJA

PARATHËNIE	3
------------	---

TEMA 1: ZHVILLIMI I ARTIT MODERN DHE BASHKËKOHOR

1.1 Roli dhe struktura e veprës artistike	7
1.2 Fillimet e artit modern	11
1.3 Impresionizmi	11
1.4 Postimpresionizmi	14
1.5 Në prag të shekullit të ri: fovizmi, ekspresionizmi dhe kubizmi	17
1.6 Fovizmi	18
1.7 Ekspresionizmi	20
1.8 Kubizmi	22
1.9 Eksperimentet në artin modern	25
1.10 Dadaizmi	25
1.11 Surrealizmi	27
1.12 Arti abstrakt	30
1.13 Ekspresionizmi abstrakt	33
1.14 Op-arti	36
1.15 Arti postmodern dhe bashkëkohor	38
1.16 Pop-arti	38
1.17 Arti konceptual	40
1.18 Fluksusi dhe performanca artistike	42
1.19 Video-arti	44
1.20 Arti digjital dhe imersiv	45
1.21 Inovacioni dhe vazhdimësia: lëvizje të tjera artistike nga fundi i viteve 1960 dhe gjatë viteve 1970	47
1.22 Arti modern dhe bashkëkohor në Republikën e Maqedonisë së Veriut	52

TEMA 2: SHPREHJA PAMORE

2.1 Teknikat e vizatimit	64
2.2 Teknikat e pikturës	70
2.3 Teknikat e grafikës	75
2.4 Teknikat e skulpturës	79

TEMA 3: ARTI NË HAPËSIRË

3.1 Arkitektura dhe urbanizmi	83
3.2 Arti urban	88
3.3 Ndërhyrja në hapësirë	92

TEMA 4: DIZAJNI, KOMUNIKIMI VIZUAL DHE ARTI DIGJITAL

4.1 Llojet e dizajnit	97
4.2 Komunikimi vizual	107
4.3 Fotografia si medium vizual	110
4.4 Mediat digjitale dhe shprehja multimediale	115

TEMA 1: ZHVILLIMI I ARTIT MODERN DHE BASHKËKOHOR

Ne i studiojmë artet dhe historinë e tyre sepse na ndihmojnë të kuptojmë mënyrën se si njerëzit janë shprehur, si në të kaluarën, ashtu edhe në ditët tona.

Historia e artit na mundëson të hulumtojmë kulturat e ndryshme njerëzore dhe të kuptojmë shoqërinë dhe botën në të cilën jetojmë.

Nga pikturat në shpella, deri te veprat bashkëkohore, është zhvilluar një larmi e madhe drejtimesh artistike. Historianët dhe kritikët e artit i japin secilit drejtim përkufizime dhe interpretime të ndryshme. Megjithatë, pavarësisht kohës ose vendit të krijimit, kontekstit shoqëror, kulturor, shpirtëror dhe historik, arti ka ekzistuar gjithmonë sepse artisti ka pasur diçka për të thënë dhe ka zgjedhur një mënyrë për ta shprehur atë.

Nevoja dhe dëshira për të komunikuar mendimet, ndjenjat dhe idetë kanë qenë gjithmonë në qendër të shprehjes artistike. Arti është një nga format universale të shprehjes njerëzore që lidh të kaluarën me të tashmen dhe me të ardhmen.

Tema e parë e këtij teksti mësimor është vazhdim i përmbajtjeve të trajtuara në tekstin mësimor "Art figurativ I" për vitin e parë të gjimnazit. Në të jeni njohur me zhvillimin e artit figurativ nga parahistoria, deri në fund të mesjetës. Në këtë pjesë të tekstit do të njiheni me fillimet dhe zhvillimin e artit modern, dallimet ndërmjet tyre, kontekstin historik, veçoritë kryesore, lëvizjet më të rëndësishme dhe përfaqësuesit e tyre, si dhe me artin modern dhe bashkëkohor në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Nëpërmjet studimit të artit modern dhe bashkëkohor do të kuptoni se si forma dhe domethënia e veprave artistike kanë ndryshuar në përputhje me ndryshimet shoqërore, ekonomike dhe teknologjike. Ju do të zhvilloni aftësi për analizimin, vlerësimin dhe interpretimin e veprave artistike dhe do të mësoni se si arti na ndihmon ta shohim dhe ta përjetojmë botën që na rrethon.

Qëllimet e temës

- T'i identifikoni dhe t'i shpjegoni drejtimet kryesore të artit modern dhe bashkëkohor, veçoritë e tyre kryesore, përfaqësuesit dhe veprat më të njohura.
- Të njihni dhe t'i krahasoni veprat e rëndësishme të artistëve të njohur nga bota dhe nga Republika e Maqedonisë së Veriut në kontekstin e stilit dhe të kohës së tyre.
- Të analizoni vepra artistike sipas formës, ngjyrës, kompozicionit, simbolikës dhe idesë, duke përdorur terminologjinë e përshtatshme të artit figurativ.
- Të krijoni një vepër origjinale figurative të frymëzuar nga praktikat bashkëkohore artistike dhe nga ideja juaj personale.
- Të zhvilloni ndjenjë respekti ndaj artit bashkëkohor, duke njohur rolin e tij në kulturë dhe në shoqëri.
- Të zhvilloni perceptimin vizual me anë të njohjes së vlerave estetike dhe figurative në veprën artistike.

ROLI DHE STRUKTURA E VEPRËS ARTISTIKE

Veprë artistike është çdo krijim i realizuar nga një artist i cili ka për qëllim të shprehë ide, ndjenja ose vizione, të komunikojë ose frymëzojë, si dhe të nxisë reflektime, reagime emocionale ose intelektuale te shikuesi.

Vepra artistike është rezultat i krijimtarisë individuale, por njëkohësisht edhe pasqyrim i kontekstit kulturor, historik dhe shoqëror në të cilin është krijuar.

NOCIONET KYÇE

veprë artistike, strukturë, temë, formë, përmbajtje, tërësi organike

Vepra artistike ka disa **role** të ndërlidhura:

- i mundëson artistit të **shprehë** emocionet, idetë, përvojat personale dhe identitetin e tij;
- **komunikon** me publikun nëpërmjet mesazheve, rrëfimeve dhe simboleve;
- vepron si **pasqyrë e shoqërisë**, duke reflektuar vlera kulturore, çështje shoqërore dhe momente historike;
- ofron **përjetim estetik**, duke dhënë kënaqësi vizuale ose estetike;
- mund të ketë **rol kritik**, duke vënë në diskutim normat shoqërore, duke kritikuar realitetin dhe duke nxitur reflektim e debat;
- ka funksion **edukativ dhe arsimor**, duke ndihmuar në të kuptuarit e historisë, të kulturës dhe të krijimtarisë njerëzore;
- ka **rol simbolik**, duke përdorur simbole dhe metafora për të përcjellë kuptime më të thella;
- mund të ketë **rol transformues**, duke ndikuar në perceptimet, ndjenjat dhe qëndrimet e individit dhe të shoqërisë;
- ka edhe **rol funksional**, veçanërisht në arkitekturë, dizajn grafik dhe në artet e aplikuara në përgjithësi, ku përveç vlerës estetike, arti ka edhe qëllimin e qartë, praktik dhe funksional, duke e lehtësuar jetën e përditshme.


Vepra artistike është tërësi e ndërlikuar e përbërë nga elemente të shumta të ndërlidhura. **Struktura** e saj na ndihmon ta kuptojmë më mirë veprën, mesazhin e artistit dhe mënyrën se si ndikon te publiku.

Tema, forma dhe përmbajtja kanë qenë gjithmonë tri elementet themelore përbërëse të veprës artistike, ndonëse janë të pranishme në shkallë të ndryshme në kultura dhe praktika të ndryshme artistike.

Kjo vazhdon të vlejë edhe sot, megjithëse vitet e fundit, në disa vepra të artit bashkëkohor, këto elemente përbërëse bëhen më të vështira për t'u identifikuar, dalluar dhe përkufizuar qartë.

NOCIONET KYÇE

material dhe teknika artistike,
shtresëzim, kontekst, kuptim,
interpretim



Tema e veprës artistike i referohet **asaj që është paraqitur ose për çfarë flet vepra**. Tradicionalisht, tema nënkupton: person, ngjarje, objekt, motiv natyre, ide, emocion ose simbol.

Ajo edhe më tej mund t'u referohet atyre, por me shfaqjen e artit abstrakt, tema mund t'i referohet edhe një konfigurimi të caktuar të elementeve figurative. Kjo, nga ana tjetër, mund të lidhet me konceptin e formës, e cila zakonisht kuptohet si mënyra e përdorimit dhe e organizimit të elementeve dhe të parimeve figurative në ndërtimin e veprës artistike. Tema mund të jetë realiste, simbolike ose abstrakte.

Forma është mënyra e shprehjes së temës, pra gjuha vizuale me anë të së cilës vepra artistike e transmeton përmbajtjen e vet. Forma e veprës artistike përfaqëson **gërshetimin e elementeve dhe të parimeve figurative** nëpërmjet të cilave organizohet dhe formësohet shprehja vizuale. Ajo i përgjigjet pyetjes: **si është realizuar vepra**.

Përmbajtja i përgjigjet pyetjes **pse është krijuar vepra**, cilat janë **mesazhi, kuptimi, ideja** ose **qëllimi** i vet. Ajo rrjedh nga marrëdhënia midis temës, formës, kontekstit dhe interpretimit dhe shpesh përfshin shtresa emocionale, simbolike, sociale ose konceptuale.

Sot, përmbajtja shpesh ndryshon ose nuk dallohet lehtësisht. Zakonisht konsiderohet si mesazhi i përgjithshëm i veprës artistike që krijohet nga artisti dhe interpretohet nga shikuesi. Megjithatë, në disa vepra bashkëkohore, përmbajtja rrjedh nga përvoja shumë personale të artistit, prandaj ndonjëherë është e vështirë të kuptohet plotësisht nga shikuesi, nëse nuk ka përvoja të ngjashme.

Këto përkufizime të temës, të formës dhe të përmbajtjes janë tradicionale.

Në artin bashkëkohor, kufijtë midis tyre shpesh ndërthuren dhe nuk mund të ndahen qartë, prandaj vepra artistike e shpreh mesazhin dhe kuptimin nëpërmjet mediave dhe teknikave eksperimentale, nëpërmjet materialit ose strukturës së veprës.

Mediat dhe teknikat janë një pjesë e rëndësishme e strukturës së veprës artistike, sepse e formësojnë veprën dhe i ndihmojnë artistit t'i përcjellë idetë dhe ndjenjat e veta te publiku.

Mediat janë materialet që artisti i përdor për të krijuar veprën, si: ngjyra, lapsi, balta, metali, tekstili, mjetet digjitale ose gërshtimi i materialeve të ndryshme. Këto ndikojnë në pamjen, teksturën dhe qëndrueshmërinë e veprës.

Teknikat artistike janë metoda dhe qasje të ndryshme që artisti i përdor për të realizuar veprën, për të arritur efekte të caktuara dhe për të shprehur idenë e vet krijuese. Këto përfshijnë teknika të pikturës, vizatimit, skulpturës, grafikës, tekstilit, dekorit, si dhe forma moderne dhe eksperimentale si arti digjital, video-arti, performanca dhe arti konceptual.

Konteksti si pjesë e strukturës u referohet kushteve, mjedisit dhe rrethanave historike, kulturore, shoqërore e personale në të cilat është krijuar vepra.

Interpretimi i veprës artistike është mënyra se si shikuesi e kupton, e përjeton dhe e shpjegon kuptimin e saj. Interpretimi nuk është i njëjtë për të gjithë dhe secili mund të shohë diçka ndryshe, gjë që është pjesë e bukurisë së artit.

Interpretimi është i lidhur ngushtë me **shtresëzimin e veprës artistike**, i cili nënkupton ekzistencën e disa niveleve të kuptimit. Përveç **shtresës vizuale** dhe **formale**, që përfshin elementet e dukshme dhe materialin, vepra përmban **shtresën përmbajtësore, simbolike** dhe **kontekstuale** që lidhen me temën, motivet dhe mesazhin, si dhe një **shtresë interpretuese** që varet nga shikuesi dhe njohuritë e përvojat e tij. Këto shtresa i japin veprës thellësi dhe mundësojnë interpretime dhe kuptime të ndryshme në periudha të ndryshme kohore.

Si përfundim, struktura e veprës artistike nuk është vetëm fizike ose vizuale, por është rrjet i integruar elementesh të ndërlydhura, si: tema, forma, përmbajtja, mediat, teknikat, konteksti dhe interpretimi. Së bashku krijojnë tërësinë e ndërlikuar, domethënëse, estetike dhe të shtresëzuar, ku secili element ka rolin dhe kuptimin e vet. Kjo strukturë e bën të mundur që vepra artistike, jo vetëm të përjetohej vizualisht, por edhe të kuptohej dhe të interpretohej më thellë. Me anë të analizës së strukturës së veprës artistike, nxënësit zhvillojnë mendimin kritik, edukimin vizual dhe një kuptim më të thellë për artin dhe rolin e tij në shoqëri.

AKTIVITET

Ndahuni në grupe prej 3–5 nxënësish dhe zgjidhni një vepër arti modern ose bashkëkohor. Përpiquni ta analizoni nga disa aspekte: çfarë paraqet vepra, si është shprehur tema nëpërmjet ngjyrës, vijës, formës ose materialit, cili është mesazhi ose kuptimi i saj, me çfarë teknikash dhe materialesh është realizuar, si dhe nëse përmban simbolikë ose mesazhe të fshehura që ju nxisin të ndjeni ose të mendoni për diçka.

AKTIVITET

Krijoni një vepër artistike personale. Zgjidhni një temë për veprën tënde: mund të jetë portret, peizazh, natyrë e qetë ose temë abstrakte. Mendo për formën (ngjyrën, vijën, kompozicionin). Vendos cilin medium dhe teknikë do të përdorësh. Reflekto mbi përmbajtjen dhe kuptimin e veprës tënde. Në fund, përgatit një shpjegim të shkurtër për klasën.



► A e dini se...

“Nata me yje” është një nga veprat më të njohura të Van Gogut dhe të postimpresionizmit. Vepra paraqet peizazh nate me një fshat dhe qiell me hënë dhe vorbull yjesh. Tema është peizazhi i natës, forma shprehet nëpërmjet vijave të theksuara, ngjyrave të fuqishme dhe goditjeve dinamike të penelit, ndërsa përmbajtja përcjell gjendjen emocionale të brendshme të artistit – shqetësim, ndjeshmëri dhe thellësi shpirtërore.



Vinsent van Gog, “Nata me yje”, 1889



► A e dini se...

“Qeni prej balone” është një nga veprat më të njohura të Xhef Kunsit dhe shpesh përdoret si simbol i pop-artit bashkëkohor dhe artit të komercializuar. Vepra shfaq disa nga rolet e artit: shpreh gëzimin dhe lojën (rol ekspresiv), tërheq vëmendjen dhe nxit diskutime për kulturën pop (rol komunikues), si dhe është mbresëlënëse vizualisht për shkak të madhësisë dhe ngjyrës (rol estetik). Gjithashtu, vepra ngre pyetje për vlerën e artit dhe ndikimin e kulturës masive (rol kritik), funksionon si shtysë vizuale në hapësirën publike (rol funksional) dhe simbolizon fëmijërinë dhe gëzimin nëpërmjet formës së thjeshtë të qenit balonë (rol simbolik).

▲ Xhef Kuns, “Qeni prej balone”, seri skulpturash të krijuara gjatë viteve 1994–2000, secila në ngjyra të ndryshme: e kaltër, e purpurt, e verdhë, e portokalltë dhe e kuqe.

Pyetje

1. Çfarë është vepra artistike dhe cilat janë rolet themelore të saj?
2. Cilat janë elementet kryesore të strukturës së veprës artistike?
3. Çfarë kuptojmë me temë, formë dhe përmbajtje të veprës artistike?
4. Pse janë të rëndësishme mediat, teknikat dhe konteksti për të kuptuarit e veprës artistike?
5. Çfarë nënkupton shtresëzimi i veprës artistike?

FILLIMET E ARTIT MODERN

Arti modern filloi në mesin e shekullit XIX, kur artistët u larguan nga rregullat e rrepta akademike dhe kërkuan mënyra të reja shprehjeje.

Nën ndikimin e ndryshimeve të mëdha shoqërore dhe industriale, ata u përqendruan në paraqitjen e jetës reale dhe të përditshme.

Një pikë kthese simbolike ishte “Salloni i të refuzuarve” në Paris në vitin 1863. Veprat e refuzuara nga salloni zyrtar, ndër to edhe “Dreka në bar” e Eduard Manetit, vunë në pikëpyetje estetikën tradicionale dhe nxitën debat publik.

Ky çlirim nga tradita krijoi kushte për eksperimente të mëtejshme në art dhe solli lindjen e impresionizmit dhe postimpresionizmit, me ç’rast përqendrimi u zhvendos drejt dritës, ngjyrës, përshtypjeve vizuale kalimtare, shprehjes personale, emocioneve dhe dimensionit shpirtëror.

IMPRESIONIZMI

Arti i kapjes së dritës

Konteksti historik dhe shoqëror

Impresionizmi u shfaq në Francë në fund të shekullit XIX. Kjo lëvizje kryesisht piktorike përfaqësoi largimin e madh nga rregullat akademike, pasi impresionistët dëshironin të paraqisnin momentin ashtu siç është, veçanërisht dritën dhe atmosferën. Ata shpesh pikturonin në natyrë (en plein air) për të paraqitur skena bashkëkohore, peizazhe dhe pjesë të jetës urbane.

NOCIONET KYÇE

impresionizëm, en plein air, dritë dhe ngjyrë, Mone, Renuar, Dega

► A e dini se...

en plein air është një term nga gjuha frënge që do të thotë “**pikturim në natyrë, në mjedis të hapur**”, drejtpërdrejt në mjedisin natyror, në vend të studios. Pikturimi **en plein air** u mundësoi impresionistëve të studiojnë me kujdes dritën natyrore dhe mënyrën se si ndikon në ngjyrat që përdorin.

Veçoritë kryesore të impresionizmit

Impresionizmi ishte lëvizje artistike që u karakterizua nga një ndryshim radikal në mënyrën e krijimit dhe të përjetimit të artit, nëpërmjet zhvendosjes së përqendrimin në dritën dhe ngjyrën, kapjen e përshtypjeve vizuale kalimtare dhe të atmosferës, përdorimin e lirë dhe të dukshëm të penelitet, si dhe paraqitjen e skenave të përditshme dhe të peizazheve. Veçori është edhe pikturimi në natyrë, pranimi i papërsosmërisë dhe i dinamizmit, si dhe përdorimi i kompozicioneve asimetrike.

AKTIVITET

Dilni jashtë ose shikoni një fotografi dhe përpikuni të kapni dritën, hijet, ngjyrat dhe atmosferën e momentit ashtu siç i shihni. Përdorni letër ose kanavacë, ngjyra (akualet ose vaj), penela, lapsa ose pastel. Përdorni goditje të lira të penelitet dhe ngjyra të gjalla për të paraqitur dritën, ngjyrën dhe atmosferën. Pas përfundimit, prezantoni punën tuaj dhe shpjegoni cilat elemente të impresionizmit i keni përdorur.

Përfaqësuesit dhe veprat kryesore të impresionizmit

Përfaqësuesit kryesorë janë: **Klod Mone, Pjer - Ogyst Renuar dhe Edgar Dega**. Mone njihet për veprën “Përshtypje, lindja e diellit” dhe për peizazhet me zambakë uji; Renuari për “Ballo në Mulin de la Galet” dhe portretet e jetës moderne; ndërsa Dega për pikturat e balerinave dhe skenat e baletit. Përfaqësuesit e tjerë të rëndësishëm janë: **Kamil Pisaro, Bert Moriso, Meri Kasati dhe Alfred Sisli**.



▲ Klod Mone, “Përshtypje, lindja e diellit”, 1872



▲ Pjer-Ogyst Renuar, “Ballo në Mulin de la Galet”, rreth vitit 1876



▲ Edgar Dega, “Ora e baletit”, midis viteve 1874 dhe 1876



▲ Bert Moriso, “Djepi”, 1873

Impresionizmi në mediat tjera

Edhe pse lidhet kryesisht me pikturën, impresionizmi ndikoi edhe në format e tjera artistike. Në **skulpturë**, artistët si **Ogyst Rodeni** përdorën forma dinamike dhe lojën e dritës dhe të hijes, duke krijuar figura “të gjalla”.

Në **grafikë** dhe **litografi**, **Eduard Maneti** dhe **Edgar Dega** paraqitën skena bashkëkohore nëpërmjet teknikave të shtypit.

► A e dini se...

Edhe pse Ogyst Rodeni nuk ishte impresionist, në skulpturën e tij “Balzaku” u vërejt ndikimi nga impresionizmi. Në vend të përpunimit të hollësishëm dhe të saktë, Rodeni përdori modelimin e lirë të formës dhe sipërfaqe të ashpër, duke theksuar kështu përshtypjen e përgjithshme dhe shprehjen, dhe jo ngjashmërinë e saktë fizike. Ashtu si te impresionistët, qëllimi nuk ishte paraqitja realiste, por transmetimi i ndjesisë dhe i perceptimit momental, gjë që e bën këtë vepër të rëndësishme për zhvillimin e skulpturës moderne.



▲ Ogyst Roden, “Balzaku”, 1892–1897

AKTIVITET

Organizoni një ekspozitë të vogël në klasë me të gjitha pikturat tuaja. Shikoni punimet e nxënësve të tjerë dhe diskutoni për qasjet e ndryshme, teknikat dhe mënyrat e përdorimit të ngjyrës dhe të dritës. Ndani përshtypjet tuaja dhe shpjegoni si i keni përdorur veçoritë e impresionizmit.

Pyetje

1. Çfarë është arti modern dhe kur filloi?
2. Cilat janë veçoritë kryesore të impresionizmit?
3. Emërto të paktën tri vepra të njohura të impresionizmit dhe autorët e tyre.
4. Çfarë do të thotë termi “en plein air”?
5. Cili impresionist është i njohur për pikturat me balerina?

POSTIMPRESIONIZMI

Arti i ngjyrës dhe i ndjenjës

Konteksti historik dhe shoqëror

NOCIONET KYÇE

postimpresionizëm, ngjyrë, emocion, formë, simbolikë, subjektivitet, pointilizëm, simbolizëm, Sezan, Syra, Gogen, Van Gog, Munk, art nouveau, Klimt

Postimpresionizmi u shfaq si vazhdim dhe reagim ndaj impresionizmit. Në këtë periudhë, Parisi dhe qytetet e tjera europiane përjetuan ndryshime të mëdha shoqërore, ekonomike dhe kulturore – urbanizim, revolucion industrial dhe zhvillim të klasave të reja shoqërore. Mjedisi urban, kafenetë, parqet, peizazhi rural dhe jeta e përditshme u bënë burime kryesore frymëzimi.

Artistët u orientuan gjithnjë e më shumë drejt shprehjes personale, emocioneve dhe dimensionit shpirtëror sesa vetëm drejt përshtypjes vizuale të dritës dhe ngjyrës.

► A e dini se...

Pol Gogeni u largua nga Franca dhe shkoi në Tahiti në kërkim të një mjedisi të qetë dhe ekzotik, duke besuar se atje do të gjente një mënyrë më të pastër dhe më autentike jetese.

Kjo përvojë e frymëzoi fuqishëm artin e tij. Atje krijoi vepra me ngjyra të forta dhe motive simbolike, i frymëzuar nga natyra dhe jeta lokale.

Veçoritë kryesore të postimpresionizmit

Postimpresionizmi vazhdoi drejtimin e impresionizmit në përdorimin e ngjyrës dhe dritës, por artistët u përqendruan edhe në simbolikë, strukturë dhe shprehje emocionale. Ata përdorën ngjyra të guximshme, kontraste dhe kompozicione dinamike, duke theksuar më shumë shprehjen personale. Në këtë periudhë u shfaqën teknika si pointilizmi dhe eksplorimi i primitivizmit, të cilat e pasuruan gjuhën vizuale të artit dhe trasuan rrugën për artin modern, abstraksionin dhe simbolizmin.

Përfaqësuesit dhe veprat kryesore të postimpresionizmit

Në postimpresionizëm u zhvilluan dy drejtime kryesore. **Pol Sezani** dhe **Zhorzh Syra** u përqendruan në formën, strukturën dhe teknikën e pointilizmit, ndërsa **Pol Gogeni** dhe **Vinsent van Gogu** eksploruan emocionet dhe temat shpirtërore me ngjyra ekspresive.

Anri Ruso pikturoi peizazhe fantastike me konture të qarta dhe ngjyra të forta.

Vepra të rëndësishme janë “Natyrë e qetë me mollë” nga Sezani dhe “Dhoma” nga Van Gogu, si dhe “Një të diel pasdite në ishullin La Grand Zhat” nga Syra dhe “Gratë e Tahitit në plazh” nga Gogeni, të cilat tregojnë qasje të ndryshme ndaj ngjyrës, formës dhe shprehjes emocionale.

AKTIVITET

Vëzhgoni natyra të qeta nga Sezani dhe vini re ngjyrën, formën dhe kompozicionin. Krijoni një kompozicion të vogël të frymëzuar nga stili i tij. Prezantoni dhe shpjegoni se cilët elemente të Sezanit i keni përdorur.



Vinsent van Gog, "Dhoma",
1889



Pol Sezan, "Natyre e qetë me mollë",
1875-1877



Zhorzh Syra, "Një të diel pasdite në ishullin La Grand Zhat",
1884-1886



Pol Gogen, "Gratë e Tahitit në plazh",
1891



▲ Anri de Tuluz-Lотреку, "La guly në Mullen Ruzh (La Goulue në Moulin Rouge)", 1891

Postimpresionizmi në mediat e tjera

Anri de Tuluz-Lотреку ishte postimpresionist francez që pikturoi skena nga kafenetë, kabaretë dhe teatrot e Parisit. Ai u bë i njohur për posterat ikonikë për kabarenë "Mullen Ruzh".

Midis postimpresionizmit dhe fovizmit nuk kishte kufi të qartë, por një periudhë tranzicioni me mbivendosje idesh dhe stilesh që çoi drejt artit modern të shekullit XX. Në këtë periudhë u zhvillua edhe **simbolizmi**, i cili u përqendrua në ndjenjat e brendshme dhe idetë nëpërmjet simboleve dhe motiveve mitologjike, me përfaqësues **Gustav Moronë, Odilon Redonin** dhe **Edvard Munkun**. Më tej u shfaq **Art Nouveau**, stil dekorativ me forma organike të frymëzuara nga natyra, me figurë kryesore **Gustav Klimtin**.



▲ Gustav Klimt, "Puthja", 1908



▲ Edvard Munk, "Klithma", 1893

Pyetje

1. Çfarë është postimpresionizmi?
2. Cilat janë veçoritë kryesore të artit të postimpresionizmit?
3. Cilët artistë postimpresionistë njihen për strukturë dhe formë, dhe cilët për emocione?
4. Përmend një vepër të njohur nga Pol Sezani, Vinsent van Gogu, Pol Gogeni ose Zhorzh Syra.
5. Cilat drejtime artistike u shfaqën pas postimpresionizmit?

NË PRAG TË SHEKULLIT TË RI: FOVIZMI, EKSPRESIONIZMI DHE KUBIZMI

Konteksti historik dhe shoqëror

Në fund të shekullit XIX dhe në fillim të shekullit XX u zhvilluan fovizmi, ekspresionizmi dhe kubizmi si pjesë të artit modern. Këto lëvizje sollën një qasje të re ndaj ngjyrës, formës dhe shprehjes artistike.

Larmia, ndryshimet e shpejta dhe numri i madh i “izmave” e formësuan artin e shekullit XX.

Ndonjëherë është e vështirë të klasifikohen artistët sipas këtyre “izmave”, sepse shumë prej tyre nuk janë kufizuar në një stil të vetëm dhe nuk kanë punuar në të njëjtën mënyrë gjatë gjithë karrierës së tyre.

Në këtë periudhë, Europa përjetoi ndryshime të mëdha teknologjike, shoqërore dhe kulturore, të cilat e ndryshuan perceptimin e realitetit dhe ndikuan tek artistët që të kërkojnë mënyra të reja të paraqitjes së botës. Në Francë u shfaq fovizmi, i frymëzuar nga postimpresionizmi, simbolizmi dhe nga arti i Afrikës dhe i Oqeanisë, me ngjyra intensive, kompozicione të lira dhe forma të ekzagjeruara. Emri fovizëm vjen nga shprehja franceze “les fauves”, që do të thotë “bisha të egra”.

Nën ndikimin e industrializimit dhe të teorive psikologjike të Frojdit, në Gjermani u zhvillua ekspresionizmi, i cili u përqendrua në botën e brendshme dhe emocionet. U shfaq në pikturë, skulpturë, teatër dhe film.

Paralelisht, kubizmi me Pikason dhe Brakun zbërtheu objektet në forma gjeometrike dhe perspektiva të shumëfishta, duke krijuar kompozicione të abstraktuara dhe duke ndikuar në skulpturë, arkitekturë dhe dizajn grafik.

FOVIZMI

Arti i “bishave të egra”

Veçoritë kryesore të fovizmit

NOCIONET KYÇE

fovizëm, “bisha të egra”, ngjyrë, ekspresion, dekorativitet, liri, Matis, Deren, Vlamink

Fovizmi si lëvizje artistike u karakterizua nga përdorimi i guximshëm dhe jorealit i ngjyrës, si dhe nga kompozicionet dinamike e të stilizuara që largohen nga piktura tradicionale. Në veprat e artistëve shpesh mungoi perspektiva klasike, ndërsa hapësira u paraqit e rrafshët dhe dekorative. Ata iu qasën realitetit në mënyrë subjektive, duke e paraqitur sipas ndjenjës personale dhe jo sipas saktësisë vizuale. Ata u frymëzuan edhe nga arti primitiv dhe ai popullor, e që kontribuoi në shprehje të fortë artistike dhe mesazh të qartë vizual.

Përfaqësuesit dhe veprat kryesore të fovizmit

► A e dini se...

Kritiku francez Lui Voksëll i përshkroi veprat e fovistëve si “bisha të egra” kur i pa në ekspozitën “Salloni i vjeshtës” në Paris në vitin 1905. Ky term më vonë u pranua si emërtim i lëvizjes artistike dhe mbeti në përdorim në historinë e artit.

Fovizmi ishte lëvizje revolucionare artistike, përfaqësuesit kryesorë të së cilës ishin **Anri Matisi**, së bashku me **Andre Derenin** dhe **Moris de Vlaminkun**.

Anri Matisi është figura më e rëndësishme e fovizmit dhe njihet për ngjyra intensive e të pastra, forma të thjeshtuara dhe kompozime dekorative e të rrafshëta. Ngjyra ishte mjeti kryesor i shprehjes së tij artistike. Andre Dereni krijoi kompozime dinamike me ngjyra të forta, të frymëzuara nga arti primitiv, ku emocioni ka përparësi ndaj realizmit. Moris de Vlaminku përdori penelata ekspresive dhe kontraste të forta për të paraqitur peizazhe energjike dhe skena nga jeta e përditshme. Vepra të rëndësishme janë “Vallëzimi” nga Matisi, “Vallëzimi” nga Dereni dhe “Lumi Sena në Shatu” nga Vlaminku, të cilat theksuan gëzimin, dekorativitetin dhe shprehjen emocionale.

AKTIVITET

Ndahuni në grupe të vogla dhe zgjidhni një temë për kolazh, për shembull peizazh, skenë nga jeta e përditshme ose figura në lëvizje. Përdorni letër me ngjyra, revista, lapsa me ngjyra dhe flomasterë për të krijuar një kolazh të frymëzuar nga fovizmi, me ngjyra intensive, forma të thjeshtuara dhe stil dekorativ. Kur të përfundoni, prezantoni kolazhin tuaj para klasës dhe shpjegoni se cilët elemente foviste i keni përdorur dhe si i keni gërshtuar në punën në grup.



▲ Anri Matis, “Vallëzimi”, 1910



André Derain, "Vallëzimi", 1906



Moris de Vlamink, "Lumi Sena në Shatu", 1906

Fovizmi në mediat e tjera

Edhe pse fovizmi është më i njohur në pikturë, idetë e tij u shfaqën edhe në mediat e tjera artistike. **Matisi, Dereni** dhe **Vlaminku**, krahas pikturës, krijuan vepra edhe në mediat e tjera, si: **vizatimi, grafika, akuareli** dhe **arti dekorativ**.

Pyetje

1. Kur, ku dhe nën çfarë ndikimesh u shfaq fovizmi?
2. Çfarë do të thotë emri "fovizëm" dhe nga e ka origjinën?
3. Cilat janë veçoritë kryesore të fovizmit në pikturë?
4. Cilët artistë konsiderohen përfaqësuesit kryesorë të fovizmit?
5. Përmend një vepër të njohur të fovizmit dhe shpjego pse është e rëndësishme.

EKSPRESIONIZMI

Arti i shpirtit njerëzor

Veçoritë kryesore të ekspresionizmit

NOCIONET KYÇE

ekspresionizëm, subjektivitet, grupe artistike, Kirchner, Kandinski, Diks, Barlah, Lembruk, Kolvic

Ekspresionizmi u karakterizua nga shprehja e fuqishme e emocioneve dhe e përjetimit subjektiv të botës. Ai theksoi interpretimin personal, ndjenjat e sinqerta dhe gjendjet psikologjike të artistit dhe të shikuesit. Ekspresionistët përdornin forma të shtrembëruara, vija të theksuara dhe ngjyra të forta për të paraqitur ndjenjat e tyre, frikën, si dhe pyetjet ekzistenciale dhe ankthin e botës moderne.

Përfaqësuesit dhe veprat kryesore të ekspresionizmit

► A e dini se...

Vasili Kandinski konsiderohet artisti i parë që krijoi piktura abstrakte, ku ngjyra dhe forma përcjellin ndjesi pa paraqitur objekte konkrete.

Artistët gjermanë, në fillim të shekullit XX, e konsideronin veten si bartës të vlerave të reja artistike dhe synonin të kapërcenin rregullat tradicionale që kufizonin artin e kohës së tyre. Në këtë kontekst u shfaqën tri grupe të rëndësishme artistike me ndikim të madh në pikturën europiane.

Grupi **“Ura”**, i themeluar në vitin 1905, synoi një shprehje të drejtpërdrejtë dhe ekspresive me ngjyra të forta. Përfaqësuesit kryesorë të saj ishin **Ernest Ludvig Kirchneri** dhe **Emil Nolde**.

“Kalorësi i kaltër”, i formuar në vitin 1911, u përqendrua në shpirtëroren, simbolikën dhe abstraksionin, me **Vasili Kandinskin** si përfaqësues kryesor.

Pas Luftës së Parë Botërore u shfaq grupi **“Objektiviteti i ri”**, i cili solli një qasje më realiste dhe kritike ndaj shoqërisë, me përfaqësuesit **Oto Diks** dhe **Xhorxh Gros** si më të njohurit.

Ndër veprat e rëndësishme ekspresioniste janë **“Rruga, Drezden”** nga Kirchneri, **“Kalorësi i kaltër”** nga Kandinski dhe **“Lufta”** nga Oto Diksi, të cilat ilustruan shumëllojshmërinë e shprehjes, temave dhe ndikimin e ekspresionizmit në artin modern



▲ Ernest Ludvig Kirchner, “Rruga, Drezden”, 1907



▲ Vasili Kandinski, “Kalorësi i kaltër”, 1903



▲ Oto Diks, "Lufta", 1932

Ekspresionizmi në mediat e tjera

Ekspresionizmi nuk u zhvillua vetëm në pikturë, por edhe në **skulpturë** dhe në **grafikë**. Në skulpturë, artistët si **Ernest Barlahu** dhe **Vilhelm Lembruku** përdorën figura të deformuara dhe forma dramatike për të shprehur emocionet njerëzore dhe gjendjet psikologjike. Në **grafikë**, **Kete Kolvici** paraqiti dhimbjen dhe padrejtësinë shoqërore me anë të vijave të forta dhe të kontrasteve, duke theksuar thelbin e ekspresionizmit: shprehjen e botës së brendshme të njeriut.



◀ Kete Kolvic,
"Qethja e flokëve", 1905

Pyetje

1. Çfarë është ekspresionizmi dhe kur u shfaq?
2. Cilat janë veçoritë kryesore të ekspresionizmit?
3. Cilat janë grupet kryesore të ekspresionizmit?
4. Ku u përqendrua grupi "Kalorësi i kaltër" dhe kush e udhëhoqi atë?
5. Si kanë ndikuar këto grupe në zhvillimin e pikturës moderne europiane?

AKTIVITET

Zgjidh një kompozim muzikor dhe shndërroje tingullin në pikturë abstrakte. Përdor vija, ngjyra dhe forma për të paraqitur atë që dëgjon. Mund të punosh individualisht ose në grup, në letër ose në një aplikacion digjital. Kur të përfundosh, shpjego se si vijat dhe ngjyrat e tua e përfaqësojnë muzikën dhe emocionet që ke përjetuar. Mëso se si ngjyra dhe forma mund të transmetojnë tingullin dhe emocionet, ashtu si te Kandinski.



▲ Vilhelm Lembruk,
"I riu në këmbë", 1913

AKTIVITET

Zgjidh një emocion: gëzim, trishtim ose frikë dhe përmes ngjyrës dhe formës paraqite në letër ose në telajo. Mos vizato objekte konkrete, por lejo që ngjyrat dhe vijat të shprehin ndjenjat e tua. Kur të përfundosh, shpjego pse i zgjedhe ngjyrat dhe format që përdore dhe si e transmetojnë botën tënde të brendshme, ashtu si te ekspresionistët.

KUBIZMI

Arti i gjeometrisë dhe i strukturës

Veçoritë kryesore të kubizmit

NOCIONET KYÇE

kubizëm, forma gjeometrike, kubizëm analitik dhe sintetik, Pikaso, Brak, kolazh dhe asambrazh

Kubizmi u zhvillua në dy drejtime: **kubizmi analitik** dhe **kubizmi sintetik**.

Kubizmi analitik i zbërthen objektet në forma gjeometrike dhe i paraqet nga këndvështrime të ndryshme njëkohësisht, me ngjyra të zbehta dhe strukturë të theksuar.

Kubizmi sintetik sjell forma më të thjeshtuara, ngjyra më të ndritshme dhe kolazhe me materiale të ndryshme, si letra dhe gazeta, duke krijuar kompozicione të reja dhe eksperimentale.

Përfaqësuesit dhe veprat kryesore të kubizmit

► A e dini se...

Emri “kubizëm” rrjedh nga një koment i kritikut francez të artit Lui Voksëll, i cili vuri re se Pikaso i paraqiste objektet si kube. Ky emër iu dha më pas të gjithë lëvizjes, pasi kubistët përdornin forma gjeometrike për të paraqitur objektet nga kënde të ndryshme njëkohësisht.

Përfaqësues kryesorë të kubizmit analitik janë **Pablo Pikaso** dhe **Zhorzh Braku**. Në veprën “Vajzat e Avinjonit”, Pikaso eksperimentoi me forma gjeometrike dhe perspektiva të shumëfishta, duke paraqitur figurat në mënyrë frontale dhe me ndikim nga arti afrikan. Zhorzh Braku krijoi vepra si “Violina dhe kandili” me ngjyra të zbehta dhe kompozime të ndërlikuara.

Më vonë, Pikaso dhe Braku zhvilluan kubizmin sintetik me forma më të thjeshtuara, me më shumë ngjyra dhe me përdorimin e teknikës së kolazhit, si në veprën e Pikasos “Njeriu me kapelë”.

Në veprën monumentale “Guernika”, Pikaso gërshetoi forma të kubizmit analitik dhe sintetik me motive tradicionale, duke i paraqitur në një mënyrë të re, joreale. Ky gërshetim forcoi mesazhin politik të veprës si protestë të fuqishme kundër brutalitetit të luftës dhe të tiranisë.

Huan Grisi është gjithashtu një përfaqësues i rëndësishëm i kubizmit sintetik.



Pablo Pikaso,
“Vajzat e Avinjonit”, 1907



► Maskë nga rajoni Etumbi,
Republika Popullore e Kongos



▲ Zhorzh Brak, "Violina dhe kandili", 1910



▲ Pablo Pikaso, "Njeriu me kapelë", 1912



◀ Pablo Pikaso, "Guernika", 1937

Kubizmi në mediat e tjera

Kubizmi u shfaq jo vetëm në pikturë, por edhe në **skulpturë, grafikë, kolazh** dhe **asamblazh**, duke përdorur materiale të ndryshme për të krijuar forma të reja, struktura dhe eksplorim të hapësirës, duke trasuar rrugën drejt artit modern.

Në vitin 1909, **Pikaso** krijoi **skulpturën e parë kubiste** prej bronzi, "Koka e një gruaje", me forma gjeometrike në vend të atyre organike. Në kubizmin sintetik u përdorën **kolazhe** dhe **asamblazhe**, kompozime tridimensionale të krijuara nga druri, metali, letra dhe objekte të tjera të jetës së përditshme. "Koka e demit" e Pikasos është një shembull i asamblazhit, i krijuar me pjesë biçiklete që formojnë kokën e demit.



Pablo Pikaso,
"Koka e një gruaje", 1909

AKTIVITET

Ndahuni në grupe të vogla dhe zgjidhni një objekt të përditshëm (p.sh. instrument muzikor, gotë, portret ose karrige). Analizoni objektin dhe vizatoni duke përdorur qasjen kubiste dhe duke e paraqitur me forma gjeometrike nga kënde të ndryshme njëkohësisht. Nëse dëshironi, mund të përfshini edhe kolazh me letër ose me gazeta. Në fund, çdo grup të prezantojë shkurt veprën e tij dhe të shpjegojë nëse ka përdorur kubizëm analitik apo sintetik.



▲ Pablo Pikaso, "Koka e demit", 1943

Pas kubizmit, artistët vazhduan të eksploronin abstraksionin, lëvizjen dhe mënyrat e reja të paraqitjes së realitetit. **Futurizmi**, me përfaqësues **Umberto Boçoni**, u përqendrua në shpejtësinë, teknologjinë dhe lëvizjen.

Pyetje

1. Në cilën periudhë dhe në cilin qytet u shfaq kubizmi?
2. Si i paraqesin kubistët objektet dhe format në veprat e tyre?
3. Cilat janë dy drejtimet kryesore të kubizmit?
4. Cilët artistë janë përfaqësuesit kryesorë të kubizmit?
5. Jep një shembull se si kubizmi shfaqet edhe në mediat e tjera përveç pikturës.

EKSPERIMENTET NË ARTIN MODERN

Eksperimentet në artin modern tregojnë se artistët u larguan nga realizmi. Ata përdorën abstraksionin, simbolet, teknikën gjestuale dhe efektet optike, eksploruan botën e brendshme, vetëdijen dhe nënvetëdijen dhe trasuan rrugën drejt artit vizual bashkëkohor.

DADAIZMI DHE SURREALIZMI

Konteksti historik dhe shoqëror

Pas Luftës së Parë Botërore, Europa u trondit nga dhuna, krizat politike dhe ndryshimet shoqërore. Në këtë kontekst u shfaq dadaizmi, një lëvizje pararojë që kritikoi racionalen, traditën dhe shoqërinë e goditur nga lufta, duke përdorur absurditetin, ironinë dhe eksperimentimin me media të ndryshme.

Në vitet 1920 në Francë u zhvillua surrealizmi, i frymëzuar nga psikanaliza e Frojdit, me synimin për të paraqitur botën e ëndrrave, nënvetëdijen dhe impulset irracionale nëpërmjet formave vizuale dhe letrare.

DADAIZMI

Arti i absurdit

Veçoritë kryesore të dadaizmit

Dadaizmi përdori absurditetin, ironinë dhe mediat e ndryshme si kolazhin, fotomontazhin, objektet e gatshme (ready-mades), performancën dhe poezinë për të kritikuar racionalen, traditën dhe shoqërinë e goditur nga lufta.

NOCIONET KYÇE

dadaizëm, Dyshamp, Arp, Rej, absurditet, irracionalizëm, objekte të gatshme

Përfaqësuesit dhe veprat kryesore të dadaizmit

Përfaqësuesit kryesorë të dadaizmit janë **Marsel Dyshampi**, **Zhan Arpi** dhe **Man Reji**.

Marsel Dyshampi ishte i njohur për objektet e gatshme, si “Shatërvani” – një pisuar i paraqitur si vepër arti me të cilin ironizoi artin tradicional.

Zhan Arpi krijoi skulptura abstrakte dhe kolazhe me forma organike, si vepra “Kërcimtari”, me anë të së cilave eksploroji rastësinë dhe absurditetin.

Man Reji realizoi fotografi eksperimentale, kolazhe dhe objekte artistike, si për shembull vepra “Objekti i pathyeshëm”, me anë të së cilave sfidoi rregullat klasike të artit dhe eksperimentoi me efektet dhe teknikat e reja vizuale.



▲ Marsel Dyshamp, “Shatërvani”, 1917

► A e dini se...

Në kabarenë “Volteri” në Cyrih, në vitin 1916, lindi dadaizmi. I themeluar nga Hugo Bali dhe Emi Heningsi, ky ishte një klub nate dhe vend performancash ku artistët dhe poetët eksperimentonin me performanca absurde, poezi zanore dhe ide kundër artit tradicional, duke sfiduar drejtpërdrejt konventat e shoqërisë dhe të artit.

AKTIVITET

Zgjidhni një objekt të përditshëm dhe shndërroni në një vepër arti dadaiste. Mund t’i ndryshoni formën ose pozicionin e objektit, të shtoni elemente absurde ose të përdorni kolazh, vizatim ose ngjyra. Pas përfundimit, prezantoni veprën tuaj para klasës dhe shpjegoni cilat veçori të dadaizmit keni përdorur.



▲ Man Rej, “Objekti i pathyeshëm”, 1964

Pyetje

1. Cilat janë veçoritë kryesore të dadaizmit?
2. Cilët artistë dhe cilat media janë më të njohura në dadaizëm?
3. Për çfarë është i njohur Marsel Dyshampi?

SURREALIZMI

Arti i ëndrrave dhe i nënvetëdijes

Veçoritë kryesore të surrealizmit

Surrealizmi u përpoq të çlirojë nënvetëdijen dhe të eksplorojë ëndrrat, fantazitë dhe imazhet irracionale, duke sfiduar realitetin dhe logjikën.

Nën ndikimin e psikanalizës së Frojdit, artistët përdornin vizatimin automatik dhe teknikat që nxisnin intuitën dhe rastësinë për të krijuar shprehje origjinale vizuale.

Përfaqësuesit dhe veprat kryesore të surrealizmit

Përfaqësuesit kryesorë të surrealizmit janë **Salvador Dali**, **Rene Magriti**, **Maks Ernsti** dhe **Huan Miro**. Veprat surrealistike shpesh kombinojnë detaje realiste me elemente të çuditshme dhe fantastike, duke krijuar një përshtypje ëndërrimtare që e zbeh kufirin ndërmjet imagjinatës dhe realitetit, si te Dali dhe Magriti, ose në mënyrë më ekspresive dhe abstrakte, si te Miro dhe Ernsti. Dali është i njohur për vizionet e tij piktorike të ëndrrave dhe halucinacioneve, si në veprën "Qëndrueshmëria e kujtesës", me orët e shkrira, të dallueshme për stilin e tij. Magriti krijoi piktura me forma të qarta dhe realiste, por me kombinime të papritura dhe paradoksale, si në veprën "Tradhtia e imazheve". Ernsti eksperimentoi me automatizmin, kolazhin dhe teknikat e reja artistike, ndërsa ndër veprat e tij më të rëndësishme është "Europa pas shiut I, II". Miroja zhvilloi një gjuhë vizuale poetike dhe simbolike me forma abstrakte dhe ngjyra të gjalla, e dukshme në veprën "Karnavali i Harlekinit".

NOCIONET KYÇE

surrealizëm, Dali, Magrit, Ernst, Miro, ëndërr, fantazi, nënvetëdije, automatizëm, Xhakometi



Salvador Dali, "Qëndrueshmëria e kujtesës", 1931

► **A e dini se...**

Automatizmi është teknikë dhe parim artistik, veçanërisht karakteristik për surrealizmin, në të cilin artisti krijon pa kontroll të vetëdijshëm dhe pa planifikim paraprak.

Në vend të mendimit racional, dora lihet të vizatojë, të shkruajë ose të modelojë vetvetiu, që të shprehen mendime, imazhe dhe ndjenja që burojnë nga nënvetëdija.

► **A e dini se...**

Xhorxho de Kiriko është themeluesi i pikturës metafizike.

Skenat e tij misterioze dhe ëndërrimtare ushtruan ndikim të madh mbi surrealistët, veçanërisht mbi Salvador Dalin dhe Rene Magritin edhe pse ai nuk i përkiste surrealizmit.

▼ Maks Ernst, "Evropa pas shiut II", 1942



▲ Rene Magrit, "Tradhtia e imazheve", 1929



▲ Huan Miro, "Karnavali i Harlekinit", 1924–1925

Surrealizmi në mediat e tjera

Surrealizmi nuk u kufizua vetëm në pikturë, por ndikoi fuqishëm edhe në **skulpturë, fotografi, film dhe dizajn grafik**. Në skulpturë, artistët si **Alberto Xhakometi** dhe **Maks Ernsti** krijuan forma ëndërrimtare dhe simbolike të frymëzuara nga nënvetëdija. Fotografia surrealistë, veçanërisht në veprat e **Man Rejit**, përdorte teknika si fotomontazhin dhe solarizimin për të krijuar imazhe të pazakonta dhe irracionale.



▲ Maks Ernst,
"Mbreti që luan me
mbretëreshën", 1944



▲ Man Rej,
"Violina e Ingresit", 1924



▲ Alberto Xhakometi,
"Gruaja e madhe në këmbë
IV", 1960

Pas surrealizmit, jashtë Europës, **arti meksikan** vazhdoi të zhvillonte tema të fuqishme narrative dhe shoqërore. Artistët si **Frida Kalo** dhe **Diego Rivera** krijuan vepra që eksploronin kulturën, identitetin dhe historinë e Meksikës, shpesh në formën e muraleve dhe kompozimeve figurative. Kjo lëvizje përfaqësoi fazën e rëndësishme para shfaqjes së artit abstrakt, kur përqendrimi u zhvendos nga narracioni dhe figuracioni drejt abstraksionit dhe shprehjes ekspresive vizuale.

AKTIVITET

Ndahuni në grupe me nga 3–4 nxënës. Zgjidhni një vepër surrealistë nga Dali, Magriti, Ernsti ose Miro dhe përgjigjuni pyetjeve: Çfarë paraqet vepra? Cilat pjesë janë reale dhe cilat joreale? Si e shprehin ngjyrat dhe format fantazinë ose ëndrrat? A është përdorur teknika e automatizmit? Më pas ndani përfundimet tuaja me klasën.

Pyetje

1. Çfarë eksploron surrealizmi dhe cilat tema janë në qendër të këtij drejtimi artistik?
2. Cilët janë përfaqësuesit kryesorë të surrealizmit?
3. Çfarë do të thotë "automatizëm" në artin surrealist?
4. Përmend një vepër të njohur të surrealizmit.

ARTI ABSTRAKT

Arti i vijave, i formave dhe i ngjyrave

Konteksti historik dhe shoqëror

NOCIONE KYÇE

art abstrakt, ngjyrë, vijë, formë, Kandinski, Mondrian, Brankushi, Maleviç, Mur, Bauhaus

Arti abstrakt u shfaq në fillim të shekullit XX si reagim ndaj pikturës realiste dhe impresioniste. Artistët filluan të eksplorojnë ngjyrën, formën dhe vijën si elemente të pavarura, të ndara nga paraqitja e drejtpërdrejtë e natyrës. Ky ndryshim u frymëzua pjesërisht nga zbulimet teknologjike dhe shkencore, si dhe nga dëshira për të shprehur botën e brendshme të artistit.

Veçoritë kryesore të artit abstrakt

► A e dini se...

Xhorxhia O'Kif është figurë e rëndësishme e artit abstrakt amerikan. Me anë të motiveve të stilizuara të natyrës, si lule dhe peizazhe, ajo krijoi kompozicione abstrakte dhe ndikoi në zhvillimin e ekspresionizmit abstrakt në ShBA.

Arti abstrakt karakterizohet nga mungesa e objekteve ose figurave të identifikueshme dhe nga zhvendosja e përqendrimit në ngjyrë, vijë, formë dhe teksturë. Artistët eksperimentojnë me kompozicionin dhe hapësirën duke përdorur elementet vizuale për të nxitur emocione dhe reflektim të shikuesi.

Përfaqësuesit dhe veprat kryesore të artit abstrakt

Përfaqësuesit kryesorë të artit abstrakt janë **Vasili Kandinski** dhe **Pit Mondriani**. Kandinski, shpesh i quajtur babai i artit abstrakt, në veprën "Kompozicioni VIII" përdori vija, ngjyra dhe forma për të shprehur emocione pa paraqitur objekte reale.


Mondriani, pionier i neoplasticizmit, në veprën "Kompozicioni me të kuqe, të kaltër dhe të verdhë" e reduktoi artin në forma gjeometrike dhe ngjyra primare, duke krijuar një kompozicion harmonik dhe abstrakt.

Kazimir Maleviçi, themeluesi i **suprematizmit**, në veprën "Katrori i zi" paraqiti një formë radikale të abstraksionit që eksploron formën e pastër vizuale dhe energjinë, duke synuar abstraksionin absolut.

Pol Kle lidhet me ekspresionizmin, kubizmin dhe surrealizmin, por shpesh konsiderohet si figurë e rëndësishme e artit abstrakt. Në veprën "Anije në paqe" ai paraqiti anijen nëpërmjet formave dhe ngjyrave abstrakte, duke krijuar një kompozicion të qetë dhe ritmik që eksploron perceptimin vizual dhe efektin emocional.

AKTIVITET


Krijoni posterin tuaj abstrakt të frymëzuar nga arti abstrakt. Përdorni ngjyra, vija dhe forma për të shprehur emocionin ose idenë tuaj, pa paraqitur objekte reale. Mund të punoni individualisht ose në grupe. Diskutoni se si elementet e ndryshme – ngjyra, vija dhe forma – krijojnë ndjesi dhe ndikojnë te shikuesi.



Vasili Kandinski,
"Kompozicioni VIII", 1923



Pit Mondrian,
"Kompozicioni me të kuqe, të kaltër dhe të
verdhë", 1930



Kazimir Maleviç,
"Katrori i zi", 1915



Pol Kle, "Anije në paqe", 1927

Arti abstrakt në mediat e tjera

Arti abstrakt nuk u kufizua vetëm në pikturë, por ndikoi edhe në forma të tjera të arteve vizuale. Në **skulpturë**, **Kostantin Brankushi** krijoi veprën "Zogu në hapësirë", në të cilën eksperimentoi me formën dhe vëllimin pa paraqitje realiste, ndërsa **Henri Mur** në skulpturën "Figura e shtrirë" përdori forma të thjeshtuara abstrakte për të paraqitur trupin e njeriut në mënyrë të re dhe dinamike.

Në dizajnin grafik, **Vasili Kandinski** realizoi posterin "Poster për ekspozitën Bauhaus", duke përdorur linja dhe ngjyra për të krijuar një kompozicion vizual abstrakt. **Bauhaus** është shkollë gjermane për art, dizajn dhe arkitekturë që shpesh zbatoi estetikën abstrakte në artin vizual, arkitekturë dhe dizajn.

Alfred Shtiglici, në fotografi, në serinë "Ekuivalentët", krijoi kompozime abstrakte nga retë, duke eksploruar dritën dhe formën pa objekte konkrete.

Vasili Kandinski, "Poster për ekspozitën Bauhaus", 1923

▼ Kostantin Brankushi, "Zogu në hapësirë", 1923



▲ Alfred Shtiglic, shembull nga seria fotografike "Ekuivalentët", 1925–1934

▼ Henri Mur, "Figura e shtrirë", 1938



▲ Valter Gropiusi, "Ndërtesa Bauhaus në Dessau", 1925–1926

Pyetje

1. Çfarë e frymëzoi zhvillimin e artit abstrakt në fillim të shekullit XX?
2. Cilat ishin veçoritë kryesore të artit abstrakt?
3. Cila vepër e Vasili Kandinskit përfaqëson artin e tij abstrakt?
4. Si e përdori Mondriani ngjyrën dhe formën në veprat e tij?
5. Përveç pikturës, në cilat media të tjera vizuale ndikoi arti abstrakt?

EKSPRESIONIZMI ABSTRAKT

Arti i emocioneve dhe i shprehjes së lirë

Konteksti historik dhe shoqëror

Ekspresionizmi abstrakt u shfaq në ShBA pas Luftës së Dytë Botërore, në një periudhë ndryshimesh të mëdha shoqërore dhe kulturore. Pas luftës, shumë artistë dhe intelektualë europianë emigruan në ShBA, gjë që ndihmoi Nju-Jorkun të bëhet qendra e re e artit bashkëkohor, në vend të Parisit.

Nën ndikimin e psikanalizës dhe ideve të Karl Jungut, artistët eksploruan nënvetëdijen dhe emocionet personale. Ky drejtim shënoi shkëputjen nga traditat artistike europiane dhe e pozicionoi ShBA-në si qendër të re të artit avangard në gjysmën e dytë të shekullit XX.

Veçoritë kryesore të ekspresionizmit abstrakt

Ekspresionizmi abstrakt karakterizohet nga abstraksioni dhe mungesa e formave të njohura. Artistët përdorin shprehje spontane dhe gjestuale për të transmetuar emocionet dhe gjendjet e tyre psikologjike.

Procesi i krijimit ka të njëjtën rëndësi si vepra, ndërsa artisti është fizikisht i përfshirë në aktin e pikturimit. Nën ndikimin e psikanalizës dhe ideve të Karl Jungut, veprat shpesh eksplorojnë nënvetëdijen.

Karakteristikë janë përmasat e mëdha dhe efekti i fortë vizual i tyre. Kjo lëvizje u zhvillua në dy drejtime kryesore: **piktura gjestuale dhe aksionale**, si dhe **piktura me fusha ngjyrash**, e cila me anë të sipërfaqeve të mëdha me ngjyra krijon reagim emocional te publiku.

NOCIONE KYÇE

ekspresionizëm abstrakt, gjest, pikturë aksionale, pikturë me fusha ngjyrash, nënvetëdije, ekspresion, përmasa të mëdha, akt fizik i pikturimit, Pollok, Klajn, Rotko, Njuman

► A e dini se...

Xhekson Polloku, një nga ekspresionistët abstraktë më të njohur, nuk përdori kavalet tradicional, por vendosi kanavacat në dyshe dhe pikturoi duke derdhur dhe spërkatur ngjyrë. Ky proces thekson energjinë fizike dhe gjestin si pjesë të veprës.

Përfaqësuesit dhe veprat kryesore të ekspresionizmit abstrakt



▲ Xhekson Pollok, "Reflektimi i Arushës së Madhe", 1947

Ekspresionizmi abstrakt, me artistët si **Xhekson Polloku**, **Franc Klajni**, **Vilem de Kuningu**, **Mark Rotko** dhe **Barnet Njuman**, ishte lëvizja e parë e rëndësishme artistike amerikane që fitoi njohje ndërkombëtare.

Ekspresionizmi abstrakt përfshiu dy qasje kryesore: pikturën gjestuale dhe aksionale të Xhekson Pollokut, Franc Klajnit dhe Vilem de Kuningut, e cila thekson dinamikën dhe aktin fizik të pikturimit, si dhe pikturën me fusha ngjyrash të Mark Rotkos dhe Barnet Njumanit, e cila përdor sipërfaqe të mëdha dhe të rrafshëta ngjyrash për të shkaktuar reagime emocionale dhe psikologjike te publiku.

Në pikturën gjestuale dhe aksionale, Xhekson Polloku krijoi veprat "Nr. 5, 1948" dhe "Reflektimi i Arushës së Madhe", Franc Klajni pikturoi veprën "Shefi", ndërsa Vilem de Kuningu realizoi veprën "Gruaja I".

Në pikturën me fusha ngjyrash, Mark Rotko pikturoi veprën "Pa titull, 1961", ndërsa Barnet Njuman krijoi veprën "Burri heroik dhe sublim".

Përfaqësuesit e tjerë të rëndësishëm të ekspresionizmit abstrakt janë: Arshile Gorki, Li Krasneri, Kliford Stilli dhe Ad Reinhardi.



▲ Vilem de Kuning, "Gruaja I", 1950-1952



▲ Mark Rotko, "Pa titull, 1961", 1961



▲ Franc Klajn, "Shefi", 1950



▲ Barnet Njuman, "Burri heroik dhe sublim", 1950-1951

Ekspresionizmi abstrakt në mediat e tjera

Ekspresionizmi abstrakt nuk u kufizua vetëm në pikturë, por ndikoi edhe në mediat e tjera vizuale, veçanërisht në **skulpturë**. Artistët si **Dejvid Smithi**, **Aleksandër Kalderi** dhe **Isamu Noguçi** eksperimentuan me formën, materialet dhe hapësirën, duke krijuar objekte organike, ekspresive ose kinetike që e vazhdojnë estetikën e artit abstrakt përtej kanavacës.

Minor Uajti ishte fotograf amerikan dhe një nga përfaqësuesit kryesorë të fotografisë abstrakte dhe moderne në ShBA, i njohur për fotografitë bardh e zi me kompozicion abstrakt.



▲ Dejvid Smith,
"Kubet VII", 1963



▲ Aleksandër Kalder,
"E kuqja e madhe", 1959



▲ Isamu Noguçi,
"Kuros", 1944–1945

AKTIVITET

Krijoni një skulpturë tuajën të frymëzuar nga ekspresionizmi abstrakt duke përdorur materiale të ndryshme – tel, letër, dru, argjilë ose materiale të ricikluara. Eksperimentoni me formën, vëllimin dhe hapësirën dhe përpikuni të shprehni energjinë, lëvizjen ose emocionin, pa paraqitur objekte konkrete. Më pas prezantoni veprat tuaja para klasës dhe diskutoni se si linjat, teksturat dhe kompozicioni ndikojnë në perceptimin e shikuesit.

Pyetje

1. Në cilin kontekst historik u shfaq ekspresionizmi abstrakt?
2. Cilat ishin veçoritë kryesore të ekspresionizmit abstrakt?
3. Cili është ndryshimi midis pikturës gjestuale dhe pikturës me fusha ngjyrash?
4. Çfarë roli kanë nënvetëdija dhe psikanaliza në këtë lëvizje artistike?
5. Si ndikoi ekspresionizmi abstrakt në mediat e tjera vizuale si skulptura?

OP-ARTI

Arti i iluzioneve optike

Konteksti historik dhe shoqëror

NOCIONE KYÇE
op-art, iluzion optik,
abstraksion gjeometrik,
Vasareli, Rajli,
perceptim vizual


Op-arti është një lëvizje artistike që u zhvillua në vitet 1960 dhe i përket artit të vonë modern, së bashku me ekspresionizmin abstrakt, minimalizmin dhe pop-artin. Kjo lëvizje bazohet në perceptimin vizual dhe efektet optike, ndërsa parimet e saj vazhdojnë të ndikojnë në artin bashkëkohor dhe në stilet e mëvonshme artistike.

Veçoritë kryesore të op-artit

► A e dini se...

Artistët e op-artit shpesh janë frymëzuar nga shkenca e optikës dhe nga studimet për perceptimin vizual, duke përdorur parimet matematikore dhe gjeometrike për të krijuar efekte “magjike” vizuale.

Termi “op” është shkurtim i fjalës “optik” dhe tregon përqendrimin në perceptimin vizual dhe mënyrën se si syri e përjeton veprën artistike. Op-arti eliminon objektet e dallueshme në favor të abstraksionit gjeometrik, me ç’rast përvoja është tërësisht vizuale dhe varet nga perceptimi i shikuesit. Artistët përdorin forma gjeometrike, vija dhe ngjyra me kontrast të fortë për të krijuar iluzione optike të lëvizjes, të vibrimit ose të thellësisë.




►
Viktor Vasarely,
“Zebra”, 1980

Përfaqësuesit dhe veprat kryesore të op-artit

Përfaqësuesit kryesorë të op-artit janë **Viktor Vasareli** dhe **Brixhit Rajli**. Vasareli, një nga themeluesit e kësaj lëvizjeje, krijoi veprat si “Zebra” dhe “Vega”, ku format gjeometrike dhe vijat krijojnë përshtypjen e lëvizjes dhe të vibrimit. Brixhit Rajli njihet për veprat “Lëvizje në katrorë” dhe “Bardh e zi”, ku kontrastet e vijave dhe të formave aktivizojnë perceptimin vizual dhe krijojnë ndjesinë e ritmit dhe të dinamikës.

Op-arti, me format gjeometrike dhe efektet vizuale, ndikoi edhe në dizajn, arkitekturë dhe modë, duke e zgjeruar estetikën e iluzioneve optike përtej pikturës.



▲ Brixhit Rajli, “Lëvizje në katrorë”, 1961

AKTIVITET

Krijoni një kompozicion tuajin të frymëzuar nga op-arti. Përdorni letër dhe ngjyra ose mjete digjitale. Realizoni një abstraksion gjeometrik me vija, rrathë dhe katrorë duke përdorur ngjyra me kontrast të fortë. Synimi është të krijoni një iluzion vizual të lëvizjes, të vibrimit ose të thellësisë. Pasi ta përfundoni punimin, shpjegoni se si vepra juaj aktivizon perceptimin e shikuesit.



▲ Stefan Knap, Op-art në arkitekturën moderne si mozaik, vepër e realizuar me bojë smalti mbi çelik, Universiteti i Torunit, Poloni, 1972

Pyetje

1. Çfarë është op-arti?
2. Cilat forma dhe ngjyra përdoren në op-art?
3. Si e krijon op-arti iluzionin e lëvizjes ose të thellësisë?
4. Cilët artistë janë më të njohur për op-artin?

POSTMODERNIZMI DHE ARTI BASHKËKOHOR

Konteksti historik dhe shoqëror

NOCIONE KYÇE

postmodernizëm, art bashkëkohor, neo-dada, pop-art, Uorhol, Lihtenshtajn, Oldenburg, Hamilton, kulturë masive

► A e dini se...

Endi Uorhol kishte një studio të quajtur “Fabrika”, ku krijoi vepra arti dhe organizoi ngjarje artistike. Ajo u bë pikë takimi për artistët, muzikantët dhe figurat e njohura, duke u shndërruar në një nga qendrat më të rëndësishme të skenës së pop-artit në vitet 1960.

AKTIVITET

Krijoni një vepër tuajën në formën e një stripi, të frymëzuar nga stili i Roi Lihtenshtajnit. Zgjidhni një skenë ose situatë nga jeta e përditshme. Vizatoni duke përdorur konture të qarta, ngjyra primare dhe pika karakteristike për të imituar efektin e stripeve komike. Shtoni dialogë në balona, si në strip. Përqendrohuni te emocionet e theksuara dhe momentet dramatike. Në fund, shpjegoni se si vepra juaj paraqet ose kritikon kulturën e përditshme ose jetën bashkëkohore.

Nëse arti modern u distancua nga shoqëria, postmodernizmi dhe arti bashkëkohor iu rikthye trajtimit të çështjeve sociale dhe politike.

Postmodernizmi u shfaq në fund të viteve 1950 dhe gjatë viteve 1960 si reagim ndaj modernizmit. Ai përdori ironinë, gërshetoi kulturën “e lartë” me kulturën masive dhe ndërthuri stile e media të ndryshme.

Arti bashkëkohor është term më i gjerë që përfshin artin që krijohet në ditët e sotme. Ai eksploron kufijtë e artit, përdor imazhe dhe objekte ekzistuese, eksperimenton me videon, performancën dhe instalacionin, ndërsa shpesh kritikon edhe institucionet artistike. Këto qasje pasqyrojnë ndërlikueshmërinë e botës së sotme të globalizuar.

POP-ARTI

Arti i kulturës masive

Veçoritë kryesore të pop-artit

Në fund të viteve 1950 dhe në fillim të viteve 1960, në ShBA dhe në Britaninë e Madhe u shfaq një reagim ndaj ekspresionizmit abstrakt, i cili kishte dominuar pas Luftës së Dytë Botërore. Artistët u drejtuan imazheve të njohura të botës reale dhe gjuhës vizuale të kulturës masive, duke sjellë “rikthimin e objektit” dhe figuracionit.

Para pop-artit u shfaq **neo-dada** me artistët si **Robert Rauschenbergu** dhe **Xhasper Xhonsi**, të cilët përdorën objekte të gatshme, motive të përditshme dhe ironi për të vënë në diskutim kufijtë e artit.

Pop-arti i viteve 1960 u përqendrua te kultura masive, reklamat, stripet komike, televizioni, filmi dhe objektet e përditshme, duke fshirë kufijtë ndërmjet kulturës “së lartë” dhe kulturës “masive”.



◀ Roy Lihtenshtajn, “Bum!”, 1963

Përfaqësuesit dhe veprat kryesore të pop-artit

Ndër përfaqësuesit më të rëndësishëm të pop-artit amerikan janë: **Endi Uorholi**, i njohur për seritë “Kanaçet e supës Campbell” dhe portretet e personazheve të famshme, **Roi Lihtenshtajni**, i cili përdori gjuhën vizuale të stripit si në “Bum!”, si dhe **Klas Oldenburgu**, i cili krijoi skulptura të frymëzuara nga objektet e përditshme, si “Kapëse rrobash”.

Në Britani, format e hershme të pop-artit lidhen me artistët si **Riçard Hamiltoni** dhe **Eduardo Paoloci**. Hamiltoni, në veprën “Çfarë i bën shtëpitë e sotme kaq të ndryshme dhe kaq tërheqëse?”, kritikon kulturën e konsumit dhe ndikimin e medieve në jetën e përditshme. Disa artistë e paraqesin jetën moderne me ironi, ndërsa të tjerë kritikojnë materializmin dhe konsumin masiv, duke e bërë pop-artin një pasqyrim të ndërlikuar të kohës së tij.



▲ Riçard Hamilton, “Çfarë i bën shtëpitë e sotme kaq të ndryshme dhe kaq tërheqëse?”, 1956



▲ Endi Uorhol, “Kanaçet e supës Campbell”, 1962



▲ Klas Oldenburg, “Kapëse rrobash”, 1976

AKTIVITET

Analizoni seritë e Endi Uorholit, si “Marilyn Monroe” dhe “Kanaçet e supës Campbell”. Përpiquni të kuptoni ngjyrat, format dhe përsëritjen e motiveve. Më pas krijoni versionin tuaj të një serie të ngjashme duke përdorur një portret, një simbol bashkëkohor ose një objekt që është i rëndësishëm për ju. Mund të përdorni ngjyra, markerë ose mjete digjitale. Në fund, shpjegoni pse e keni zgjedhur këtë motiv dhe si zgjedhja juaj pasqyron kulturën bashkëkohore.

Pyetje

1. Çfarë është arti postmodern?
2. Si ndryshon arti bashkëkohor nga arti modern?
3. Cilat janë veçoritë kryesore të pop-artit?
4. Cilët artistë lidhen me pop-artin?

ARTI KONCEPTUAL

Arti i ideve

Veçoritë kryesore të artit konceptual

NOCIONE KYÇE

art konceptual, ide ose koncept, tekst, Kosuth, Luit, Uajner

Arti konceptual u shfaq në vitet 1960 dhe e vendosi idenë ose konceptin në plan të parë, përpara pamjes dhe materialit të veprës. Ai u zhvillua si reagim ndaj institucioneve artistike dhe komercializimit të artit. Kjo qasje revolucionare, e zhvilluar nga artistë si Xhozef Kosuthi, Sol Luiti dhe Lorenc Uajneri, e zhvendosi përqendrimin nga forma vizuale, te përmbajtja intelektuale e veprës, duke vënë në pikëpyetje se çfarë është arti dhe çfarë mund të jetë.

Veprat konceptuale shpesh përfshijnë tekste, diagrame, udhëzime ose performanca të përkohshme. Qëllimi i artistit është më i rëndësishëm se objekti i përfunduar. Ky drejtim trajton çështjet e autorësisë, komercializimit dhe natyrës së veprës artistike.

Përfaqësuesit dhe veprat kryesore të artit konceptual

► A e dini se...

Sol Luiti mendoi se ideja është më e rëndësishme se vepra, prandaj të tjerët mund ta realizonin veprën e tij sipas udhëzimeve të tij.

Përfaqësuesit e artit konceptual janë **Xhozef Kosuthi**, **Sol Luiti** dhe **Lorenc Uajneri**, të cilët e vendosën idenë dhe konceptin mbi formën materiale të veprës.

Në veprën e tij “Një karrige dhe tri karrige”, Kosuthi eksploroj natyrën e artit me anë të një karrigeje si objekt fizik, një fotografie të saj dhe përkufizimit të fjalës “karrige” të shkruar në tabelë.

Luiti krijoi vizatime dhe udhëzime që theksojnë rëndësinë e idesë për realizimin, ndërsa Uajneri përdori tekstin si vepër arti, duke i dhënë përparësi mbi objektin material. Së bashku, ata rishqyrtuan natyrën tradicionale të veprës artistike dhe në qendër të krijimit vendosën konceptin.



▲ Xhozef Kosuth, "Një karrige dhe tri karrige", 1965

chair (chār), *n.* [OF. *chaire* (F. *chaire*), < L. *cathedra*: see *cathedra*.] A seat with a back, and often arms, usually for one person; a seat of office or authority, or the office itself; the person occupying the seat or office, esp. the chairman of a meeting; a sedan-chair; a chaise†; a metal block or clutch to support and secure a rail in a railroad.

▲ Tekst në mur: "Një karrige dhe tri karrige"

Pyetje

1. Çfarë është arti konceptual?
2. Pse ideja është më e rëndësishme se materiali në këtë art?
3. Çfarë bëri Xhozef Kosuthi në veprën "Një karrige dhe tri karrige"?
4. Si e përdori Sol Luiti idenë në vizatimet dhe udhëzimet e tij?
5. Në çfarë mënyre Lorens Uajneri përdori tekstin në vend të objektit material?

AKTIVITET

Zgjidhni një objekt nga klasa, për shembull një bankë shkollore, një libër ose një stilolaps dhe përpiquni ta paraqisni në tri mënyra të ndryshme.

Mënyra e parë është me anë të objektit fizik, duke përdorur sendin; mënyra e dytë është me anë të një fotografie ose vizatimi; ndërsa mënyra e tretë është me anë të një teksti ku përshkruani çfarë është objekti dhe çfarë do të thotë për ju. Më pas prezantoni punën tuaj dhe shpjegoni pse e zgjodhët këtë objekt dhe si teksti, imazhi dhe objekti fizik së bashku e shprehin idenë tuaj.

FLUKSUSI DHE PERFORMANCA ARTISTIKE

Arti i procesit dhe i shfaqjes

Veçoritë kryesore të fluksusit dhe të performancës artistike

NOCIONE KYÇE

fluksus, proces, performancë
artistike, përkohshmëri,
ndërveprim, Bojs, Abramoviç,
Makiunas, Ono, Akonçi

Fluksusi është lëvizje avangarde që u shfaq në vitet 1960 dhe i zhvendosi kufijtë e artit nëpërmjet performancave, aktiviteteve dhe ndërhyrjeve artistike.

Artistë si Xhorxh Makiunasi, Jozef Bojsi dhe Joko Ono e vendosën procesin e krijimit përpara veprës së përfunduar, duke pranuar spontanitetin, humorin dhe rastësinë. Ky drejtim është ndërdisiplinor dhe i shkrin kufijtë tradicionalë midis artistit dhe publikut.

Performanca artistike e zhvilluar gjithashtu në vitet 1960 përdori trupin e artistit si medium kryesor dhe u përqendrua në veprimet e gjalla dhe të përkohshme. Artistët si Marina Abramoviçi, Vito Akonçi dhe Karoli Shnimani përdorën performancën për të trajtuar drejtpërdrejt çështjet sociale dhe kulturore, ndërsa videoja dhe fotografia shërbyen për dokumentimin e këtyre veprave.



Jozef Bojs,
"Unë e dua Amerikën dhe Amerika më do
mua", 1974

Përfaqësuesit kryesorë dhe veprat e fluksusit dhe të performancës artistike

Disa nga artistët kryesorë të fluksusit dhe të performancës artistike janë **Xhorxh Makiunasi, Jozef Bojsi, Joko Ono, Marina Abramoviçi dhe Vito Akonçi**.

Ndër veprat më të njohura është “Unë e dua Amerikën dhe Amerika më do mua” nga Jozef Bojsi. Artisti kalon disa ditë i mbyllur në një galeri me një ujk, duke eksploruar simbolikën, raportin me natyrën dhe çështje sociale.

Një tjetër vepër e rëndësishme është “Artisti është i pranishëm” nga Marina Abramoviçi, një performancë e gjatë në Muzeun MoMA, ku artistja qëndroi në heshtje përballë vizitorëve, duke krijuar një lidhje të fortë emocionale me publikun.



▲ Marina Abramoviçi, “Artisti është i pranishëm”, 2010

Pyetje

1. Çfarë është fluksusi dhe cilat janë veçoritë kryesore?
2. Çfarë është performanca artistike dhe si ndryshon nga fluksusi?
3. Cilat janë veprat më të njohura të Jozef Bojsit dhe Marina Abramoviçit, dhe çfarë i bën të veçanta?
4. Si i ndryshon fluksusi dhe performanca artistike rolet tradicionale të artistit dhe të publikut?
5. Pse videoja dhe fotografia janë të rëndësishme për dokumentimin e këtyre lëvizjeve artistike?

► A e dini se...

Xhorxh Makiunasi organizoi shpesh ngjarje artistike të quajtura “Happenings”, ku publiku bëhej pjesë aktive e veprës artistike, duke u shndërruar në bashkëkrijues të veprës së artit.

► A e dini se...

Në performancën “Artisti është i pranishëm”, Marina Abramoviçi qëndroi në heshtje për rreth tetë orë në ditë përballë publikut, dhe shumë vizitorë përjetonin emocione të forta vetëm nga prania e saj, pa asnjë komunikim verbal.

AKTIVITET

Zgjidhni një fjalë të shkurtër, një fjalë ose një mesazh që dëshironi ta shprehni dhe krijoni një performancë të shkurtër prej 1–2 minutash, në të cilën përdorni praninë tuaj trupore dhe objektet që keni zgjedhur. Prezantoni para klasës dhe më pas shpjegoni se si trupi juaj, objektet dhe teksti e transmetojnë së bashku mesazhin ose emocionin që dëshironi të shprehni.

VIDEO-ARTI

Arti i imazheve në lëvizje

Veçoritë kryesore të video-artit

NOCIONE KYÇE
video art, instalacion, kohë,
ndërdisciplinaritet, Pajk,
Viola, Rist

Video-arti, i zhvilluar nga artistët si Nam Xhun Pajku, Bill Viola dhe Pipiloti Rist, përdor imazhet në lëvizje si medium kryesor. Ai u mundëson artistëve të eksplorojnë tema si koha, identiteti, teknologjia dhe ndryshimet shoqërore.

Përfaqësuesit dhe veprat kryesore të video-artit

► A e dini se...

Nam Xhun Paiku, i konsideruar shpesh si “babai i video-artit”, e përdori televizorin si medium artistik që në vitin 1963. Me instalacionet e tij inovative, ai parashikoi epokën e mediave digjitale dhe të imazheve interaktive shumë më përpara se të bëheshin pjesë e përditshmërisë.

Disa nga veprat më të rëndësishme të video-artit janë: “Buda në televizor” nga **Nam Xhun Pajku**, ku një statujë e Budës shikon një ekran televiziv, duke eksploruar marrëdhënien mes teknologjisë dhe spiritualitetit; “Prerja” nga **Bill Viola**, një video-projeksion i madh ku një njeri është i zhytur në ujë dhe në efekte zjarri, duke trajtuar kështu gjendjen njerëzore dhe transformimin; dhe “Gjithmonë është mbi gjithçka” nga **Pipiloti Rist**, një video-performancë me një grua që thyen xhamin e një makine duke përdorur lojë me imazhe, tingull dhe mesazhe sublimë.



◀ Nam Xhun Pajk,
“Buda në televizor”, 1974

AKTIVITET

Zgjidhni një ide të shkurtër, një emocion ose një mesazh dhe regjistroni një video të shkurtër (15–30 sekonda) me telefon, duke përdorur objekte, trupin tuaj ose hapësirën përreth. Shtoni tinguj, dritë ose efekte të thjeshta nëse dëshironi, më pas prezantoni videon para klasës duke shpjeguar se si lëvizja, tingulli dhe elementet vizuale e transmetojnë mesazhin tuaj.



▲ Bill Viola, “Prerja”, 1996



▲ Pipiloti Rist,
“Gjithmonë është mbi gjithçka”, 1997



Pyetje

1. Cilët janë artistët kryesorë të video-artit?
2. Si ndryshon video-arti nga filmi?
3. Çfarë temash trajtojnë videot e Nam Xhun Pajkut, Bill Violës dhe Pipiloti Ristit?
4. Si ndikojnë tingulli dhe imazhet te shikuesi?

ARTI DIGJITAL DHE IMERSIV

Arti në epokën e inteligjencës së makinës

Veçoritë kryesore dhe përfaqësuesit e artit digjital dhe imersiv

Arti digjital filloi të zhvillohet nga mesi i viteve 1960 dhe vazhdon deri më sot, duke përdorur teknologjinë digjitale si mjet krijues dhe si medium artistik. Artistët si **Refik Anadoli**, **Xhon Rafmani** dhe **Luiza Klementi** krijojnë vepra që përfshijnë imazhe të gjeneruara nga kompjuteri, instalacione digjitale, realitet virtual dhe të shtuar, si dhe media interaktive.

Ky drejtim eksploron tema si teknologjia, identiteti dhe marrëdhënia mes botës fizike dhe asaj virtuale, duke reflektuar ndikimin e epokës digjitale në shoqërinë bashkëkohore.

Arti imersiv, i zhvilluar paralelisht, krijon përvoja ku shikuesi bëhet pjesë e veprës artistike. Artistët si **Jajoi Kusama**, **Olafur Eliasoni** dhe **Xhejms Tureli** krijojnë hapësira që gërshetojnë dritën, tingullin dhe teknologjinë, si dhe ndonjëherë edhe elemente fizike si aromën ose prekjën. Arti imersiv nuk është gjithmonë digjital. Ai mund të jetë edhe fizik, hapësinor, performues ose sensor, pa përdorur teknologji kompjuterike.

Vepra të njohura të artit digjital dhe imersiv

“Halucinacione makinerike: ëndërrime të natyrës” është vepër digjitale e Refik Anadolit, e cila përdor inteligjencën artificiale për të krijuar peizazhe vizuale imersive nga fotografi të natyrës. Vepra eksploron marrëdhënien mes teknologjisë, njeriut dhe natyrës, duke paraqitur peizazhe efemere që pasqyrojnë simbiozën midis njeriut dhe makinës në epokën digjitale.

“Salla me pasqyra të pafundme” është një instalacion imersiv i Jajoi Kusamës, ku hapësira mbushet me reflektime të pafundme dhe dritë, duke krijuar ndjesinë e pafundësisë dhe një përvojë ndërvepruese për publikun.

NOCIONE KYÇE

art digjital, art imersiv, realitet virtual (VR), realitet i shtuar (AR), media interaktive, video-projeksion, instalacion hapësinor, Anadol, Kusama

► A e dini se...

Olafur Eliasoni krijon instalacione imersive me pasqyra që zgjerojnë hapësirën dhe krijojnë iluzionin e reflektimeve të pafundme, duke bërë që publiku të mos jetë vetëm vëzhgues, por pjesë aktive e veprës.

AKTIVITET

Shikoni videon “Arti në epokën e inteligjencës së makinave | Refik Anadol”. Më pas mendoni dhe diskutoni në grup se si teknologjia dhe inteligjenca artificiale e ndryshojnë krijimin dhe përjetimin e artit.



▲ Refik Anadol, “Halucinacione makinerike: ëndërrime të natyrës”, 2021



▲ Jajoi Kusama, “Salla me pasqyra të pafundme”, 2013

Pyetje

1. Çfarë është arti digjital dhe cilat media i përdor?
2. Cilët artistë janë të njohur në artin digjital?
3. Cilët artistë janë të njohur në artin imersiv?
4. Si merr pjesë shikuesi në veprat imersive?
5. A është arti imersiv gjithmonë digjital?

INOVACION DHE VAZHDIMËSI: LËVIZJE SHITESË ARTISTIKE NGA FUNDVITET 1960 DHE GJATË VITEVE 1970

Në fund të viteve 1960 dhe gjatë viteve 1970, bota e artit vazhdoi të transformohej. U shfaqën drejtime të reja që bashkonin traditën me inovacionin. Minimalizmi, fotorealizmi, arte povera, arti feminist, land arti (arti i tokës) dhe street arti (arti i rrugës) eksploronin rolin e mediumit, hapësirës dhe shoqërisë në krijimin e veprës artistike. Njëkohësisht, neoabstraksioni, neoekspresionizmi dhe piktura e re europiane theksonin eksperimentimin me formën, ngjyrën dhe shprehjen, duke hapur perspektiva të reja në nivel global.

Këto lëvizje theksuan ndërlikueshmërinë e viteve 1970 si një dekadë kërkimi, ndryshimesh shoqërore dhe dialogu midis së kaluarës dhe së ardhmes së artit.

Kur e shqyrtojmë artin bashkëkohor, shpesh nuk kemi distancë të mjaftueshme historike. Sa më i ri të jetë një stil artistik, aq më shumë kohë nevojitet për të vlerësuar rëndësinë e tij dhe nëse do të mbijetojë. Prandaj, ky kapitull është më i hapur ndaj ndryshimeve dhe plotësimeve.

Minimalizmi thekson thjeshtësinë dhe përdorimin e formave bazë gjeometrike. Përfaqësues kryesorë të minimalizmit janë **Donald Xhadi**, **Frank Stella**, **Dan Flavin** dhe **Daniel Buren**, të cilët krijuan vepra me linja të pastra dhe elemente vizuale minimale.

Fotorealizmi synon të paraqesë realitetin si një fotografi. Artistët si **Çak Klosi**, **Riçard Estes** dhe **Odri Flak** paraqitën skena dhe objekte të përditshme me një saktësi të madhe, duke theksuar mjeshtërinë dhe bukurinë e të zakonshmes.

Arte Povera lindi në Itali si një kritikë ndaj industrializimit dhe shoqërisë konsumatore. Artistët si **Mikelanxhelo Pistoletto**, **Janis Kunelisi** dhe **Mario Merc** përdorën materiale të thjeshta dhe të përditshme për të rishqyrtuar vlerën artistike, qëndrueshmërinë dhe marrëdhënien mes njeriut dhe natyrës.

NOCIONE KYÇE

inovacion, vazhdimësi, fotorealizëm, Klos, arte povera, Kunelisi, arti feminist, Kruger, land art, Smithson, street art, Benksi, neoabstraksion, Skalli, neoekspresionizëm, Baskijat, art i ri evropian, Kifer, shkolla lokale, Bejkon, Frojd, Emin, Hërst, transformim



▲ Donald Xhadi,
"Pa titull", 1988



▲ Çak Klos,
"Autoportret i madh",
1967–1968



▲ Barbara Kruger, "Pa titull (Trupi yt është fushëbetejë)", 1989

AKTIVITET

Ndahuni në grupe të vogla dhe krijoni një "hartë artistike" – një vijë kohore me shembuj vizualë të drejtimeve artistike nga fundi i viteve 1960 dhe gjatë viteve 1970. Përdorni postera ose aplikacione digjitale (p.sh. Canva) për të paraqitur artistët dhe veprat e tyre.

Më pas prezantoni hartën dhe shpjegoni se si lidhen drejtimet e ndryshme dhe si e bashkojnë traditën me inovacionin.

▲ Mikelanxhelo Pistoletto, "Afërdita e leckave", 1967



Arti feminist u shfaq si reagim ndaj pabarazisë gjinore në art dhe në shoqëri. Artistët si **Xhudi Çikago**, **Barbara Krugeri** dhe **Sindi Shermani**, eksploruan nëpërmjet veprave të tyre temat e identitetit, të trupit dhe rolit të gruas në shoqëri.

Land Art (ose arti i tokës) e ripërcakton marrëdhënien midis artit dhe natyrës. Artistë si **Robert Smithsoni**, **Riçard Longi**, **Valter de Maria**, **Nensi Holti**, si dhe dyshja **Kristo** dhe **Zhan-Klodi** krijuan ndërhyrje të mëdha arkitektonike në natyrë, shpesh të përkohshme, duke eksploruar kohën, ekologjinë dhe kreativitetin njerëzor.



▲ Robert Smithson, "Digë spirale", 1970

Street art (arti i rrugës) përfshin murale, grafite dhe ndërhyrje urbane që i transformojnë hapësirat publike në kanavacë për shprehje artistike. Artistët si **Benksi**, **Kith Haringu** dhe **Xhej Ar** krijuan vepra me mesazhe sociale dhe politike, duke sfiduar hapësirat tradicionale të artit.



▲ Banksy, "Vajza e vogël me balonë", 2002

Neoabstraksioni u shfaq si reagim ndaj minimalizmit dhe artit konceptual. Artistë si **Shon Skalli**, **Georg Bazelici** dhe **Anselm Kiferi** eksploruan kompozime abstrakte me referenca personale dhe shoqërore, duke rikthyer ekspresivitetin, ngjyrën dhe formën në pikturën abstrakte.

Neoekspresionizmi e ktheu emocionin dhe energjinë në pikturë. Artistët si **Zhan-Mishel Baskia**, **Anselm Kiferi** dhe **Georg Bazelici** përdorën ngjyra të guximshme, goditje të fuqishme dhe skena dramatike për të transmetuar tema personale, historike dhe kulturore, duke bashkuar traditën me bashkëkohoren.

Piktura e re europiane bashkoi abstraksionin dhe figuracionin, shpesh me ngjyra intensive dhe forma ekspresive. Piktoret si **Gerhard Rihteri**, **Anselm Kiferi**, **Georg Bazelici**, **Luk Tujmansi**, **Neo Rauh** e zhvilluan abstraksionin duke e lidhur me kontekst historik dhe social si dhe duke eksploruar teknika e ndikime të ndryshme të fundit të shekullit XX.



▲ Anselm Kiferi,
"Reshtat e natës", 1996

► A e dini se...

Shumë artistë, si Banksy, kanë filluar të punojnë në mënyrë anonime, në mënyrë që publiku të zbulojë mesazhin dhe stilin e tyre pa e ditur kush i ka krijuar veprat.



▲ Shon Skalli,
"Dhoma e gjumit në Venecia", 1988



▲ Zhan-Mishel Baskia,
"Cabeza", 1982



▲ Lucian Frojd, "Njeri i zhveshur, pamje nga mbrapa", 1991–1992

Përveç lëvizjeve të mëdha ndërkombëtare, u shfaqën edhe shkolla dhe grupe lokale. Disa artistë kanë punuar dhe ekspozuar së bashku, si **KOBRA** (Kopenhagë – Bruksel – Amsterdam) me **Karel Apelin** dhe **Pjer Aleshinskin**. Të tjerë lidhen me anë të stilit të ngjashëm, si **Shkolla e Londrës** me **Frensis Bejkonin** dhe **Lusian Frojdin**. Ekzistojnë edhe "Artistët e rinj britanikë" (Young British Artists), ndër ta **Demien Hërsti** dhe **Trejsi Emin**.

Artivizmi nuk është një lëvizje formale artistike, por një qasje bashkëkohore në art që përdoret për të nxitur reflektimin, dialogun dhe ndikimin në shoqëri. Artistë si **Ai Ueiuei**, **Benksi**, **Xhej Ar**, **Tania Brugera** dhe **Vajzat Guerile** theksuan rolin e artit si mjet për rritjen e vetëdijes dhe për ndryshime shoqërore.



▲ Frensis Bejkon, "Triptihu, gusht 1972", 1972



▲ Demien Hërsti, "Pamundësia fizike e vdekjes në mendjen e një njeriu të gjallë", 1991



▲ Trejsi Emin, "Shtrati im", 1998

Sot, ekzistojnë disa lëvizje “neo” dhe “post”, si neokonceptualizmi, postabstraksioni ose neodada. Këto e zhvillojnë më tej idenë e lëvizjeve historike, por nuk i përkasin kësaj lëvizjeje, nuk janë të përkohshme dhe nuk e përjashtojnë njëra-tjetrën, bashkëjetojnë dhe formojnë vazhdimësi në artin bashkëkohor.

Me hyrjen në shekullin XXI, u shfaqën stile dhe mënyra të reja të shikimit të artit. Teknologjia dhe mediat krijojnë ide dhe stile me një shpejtësi të madhe, ndërsa shija ndryshon vazhdimisht. Artistët gjithmonë tërhiqen nga format, teknikat dhe konceptet e reja. Gjeneratat e ardhshme do të duhet të dallojnë artin e qëndrueshëm nga ai i përkohshëm.

Si përfundim, arti bashkëkohor nuk përfaqëson një lëvizje të vetme artistike, as një “-izëm” të vetëm, por një periudhë të gjerë dhe të vazhdueshme të shënuar nga pluralizmi, globalizimi dhe ndryshimet teknologjike që rishqyrtojnë format tradicionale të artit.

Arti është pasqyrë e botës dhe e jetës. Bota ndryshon, arti ndryshon dhe historia e artit vazhdon t’i ndjekë dhe t’i dokumentojë këto ndryshime.

► A e dini se...

Demien Hërsti, në veprën “Pamundësia fizike e vdekjes në mendjen e një njeriu të gjallë”, paraqiti një peshkaqen të zhytur plotësisht në formaldehyd brenda një akuariumi të madh prej xhami. Kjo vepër synon t’i shtyjë shikuesit të mendojnë për vdekjen, frikën dhe perceptimin njerëzor të jetës.



▲ Ai Ueiuei, “Farat e luledielliit”, 2010



Pyetje

1. Çfarë do të thotë inovacioni dhe vazhdimësia në art?
2. Cilat lëvizje u shfaqën në fund të viteve 1960 dhe gjatë viteve 1970?
3. Ku krijohet land arti?
4. Çfarë është karakteristike për street artin?
5. Përmend disa artistë dhe vepra nga shkollat dhe grupet lokale të kësaj periudhe.

ARTI MODERN NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT

NOCIONE KYÇE

art modern, art sakral dhe art laik, figuracion, abstraksion, enformel, art postmodern



▲ Dimitar Pandilov Avramovski, "Korrëset", 1935



▲ Nikola Martinoski, "Në kafene", 1932

Arti modern në Republikën e Maqedonisë së Veriut lindi më vonë se në qendrat e mëdha europiane, por jo si dukuri e izoluar. Ai lindi si rezultat i kushteve historike dhe i hapjes graduale ndaj ndikimeve artistike europiane. Deri në fillim të shekullit XX, arti në Maqedoni lidhej kryesisht me ikonografinë dhe afreskun, ku piktura kishte një rol fetar.

Ndryshimet filluan kur zografët e fundit, si **Dimitar Andonov Papradishki**, **Kosta Vangelov-Vangeloviq** dhe **Gjorgji Zografski** nisën të paraqesin hapësirën, vëllimin dhe skena nga jeta e përditshme. Kështu u trasua rruga drejt pikturës laike dhe artit si shprehje personale dhe krijuese.

Modernizmi i hershëm

Artistët e parë modernë në Republikën e Maqedonisë së Veriut kanë arsimim akademik. Ndër ta është **Dimitar Pandilov Avramovski**, ndërsa autorët kyç të modernizmit të hershëm janë: **Nikola Martinoski**, **Lazar Liçenoski** dhe **Dimo Todorovski**.

Në pikturë u ndjenë ndikimet e impresionizmit dhe ekspresionizmit. Liçenoski krijoi vepra me ngjyra të fuqishme dhe forma të qarta, Martinoski paraqiti njerëz dhe skena të mbushura me emocione të forta dhe tema shoqërore, ndërsa Pandilovi pikturoi peizazhe poetike dhe skena nga jeta e përditshme.

Në të njëjtën kohë, **Dimo Todorovski** vendosi themelet e skulpturës moderne në Republikën e Maqedonisë së Veriut duke përdorur format e thjeshtuara dhe ekspresive. Menjëherë pas tij u shfaq edhe **Borka Avramova**, skulptorja e parë grua në Maqedoni, e cila me ekspozitën e saj në vitin 1954 e pasuroi shprehjen moderne në skulpturë.



◀ Lazar Liçenoski,
"Gratë që lahen", 1930



▲ Dima Todorovski,
"Gropa", 1956

Pas Luftës së Dytë Botërore

Pas Luftës së Dytë Botërore, arti fitoi mbështetje më të madhe dhe u bë pjesë e dukshme e hapësirës publike. Autorët si **Tomo Vladimirski**, **Vangel Koxhoman** dhe **Borko Lazeski** krijuan vepra që kanë të bëjnë me arkitekturën dhe objektet publike. Arti u bë më i afërt me jetën e përditshme.

Në vitet 1950 dhe 1960 u shfaq një brez i ri artistësh, si **Dimitar Kondovski**, **Mile Korubini** dhe **Petar Mazevi**, si dhe skulptorët **Boro Mitriqeski** dhe **Petar Haxhi Boshkov**. Veprat e tyre tregojnë liri më të madhe dhe larmi stilistike.

Nga artistët shqiptarë që kanë jetuar dhe krijuar në Maqedoni në periudhën e pasluftës, veçohet piktori **Adem Kastrati**, i njohur për motivet e tij kryesisht sociale dhe etnofolklorike.



▲ Mile Korubini,
"Portreti i Slavko Janevskit",
1955



▶ Vangel Koxhomani,
"Motiv nga rajoni i
Prilepit I", 1956



▲ Borko Lazeski, "Partizani i
plagosur", 1954



▲ Adem Kastrati,
"Vajtimi i Rexhës", 1978



▲ Omer Kaleshi,
"Kokë në litar", 2002



▲ Petar Mazevi,
"Kompozicioni 12", 1989



▲ Dimitar Kondovski,
"Mëngjes vjeshte", 1962

Modernizmi i zhvilluar (1950 – 1980)

Gjatë kësaj periudhe artistët eksperimentuan gjithnjë e më shumë. U themeluan grupe artistike si **DENES** dhe **MUGRI**, të cilat organizuan ekspozita të përbashkëta dhe e afruan artin me publikun e gjerë.

U shfaq edhe arti abstrakt, ku objektet nuk paraqiten drejtpërdrejt, por nëpërmjet ngjyrës, vijës dhe ritmit. **Petar Mazevi** dhe **Dimitar Kondovski** krijuan vepra abstrakte të fuqishme dhe emocionale.

Një dukuri e rëndësishme është edhe enformeli, ku artistët punojnë me materie të ashpra dhe me gjeeste të fuqishme. Te **Rodoljub Anastasovi** dhe **Ordan Petlevski** vepra nuk paraqet një skenë, por shpreh ndjenja dhe gjendje të brendshme.

Në vitet 1970 u rikthye figuracioni, por në një mënyrë tjetër. Autorët si **Tanas Lulovski**, **Rodoljub Anastasovi**, **Nove Frangovski** dhe **Ana Temkova** e përdorën figurën njerëzore si simbol dhe jo si paraqitje realiste. Në këtë linjë bën pjesë edhe **Omer Kaleshi**, i cili jetoi dhe punoi në Paris dhe është i njohur për portretet e tij ekspresive.

Paralelisht u zhvillua edhe arti i bazuar në gjeometri të qartë dhe rend, veçanërisht te **Dushan Perçinkovi**, veprat e të cilit shpesh lidhen me arkitekturën dhe hapësirën publike.

Kalimi drejt artit postmodern dhe bashkëkohor

Në fund të viteve 1970 artistët filluan të gërshetojnë qasjet dhe stilet e ndryshme. Kjo çoi drejt shfaqjes së artit postmodern, i cili nuk ndoqi një rregull ose një stil të vetëm.

U shfaqën autorët e brezit të ri, si **Aneta Svetieva, Zhaneta Vangeli, Jovan Shumkovski, Stanko Pavleski** dhe **grupi Zero**. Gjithnjë e më shpesh u përdorën instalacionet, aksionet në hapësirë dhe performancat.



▲ Dushan Perçinkovi,
"Peizazh në të verdhë", 1971



▲ Aneta Svetieva, "Grua që lahet me dorë të vizatuar", 1987



▲ Gligor Stefanovi,
"Alegoria e dritës (Serafimë dhe kerubinë)", 1993



▲ Shemov Fidanovski,
"Lëmsh i shthurur", 1983



▲ Zhaneta Vangeli,
nga cikli "Dëshira e përhershme për përjetësi", 1998

AKTIVITET

Vëzhgoni një riprodhim të veprës së Nikola Martinoskit, Petar Mazevit dhe Rodoljub Anastasovit dhe përshkruani nëse vepra është figurative ose abstrakte, çfarë emocionesh përcjell dhe cilët elemente (ngjyra, forma, gjesti) janë më të theksuara.

Në grup diskutoni pse artistët në vitet 1960 largohen nga paraqitja e drejtpërdrejtë e objekteve dhe nëse arti abstrakt mund të përcjellë mesazhe të forta pa figura.



▲ Miftar Memeti, „100-vjetori i lindjes së Nënë Terezës“, 2010

► A e dini se...

Arti modern në Republikën e Maqedonisë së Veriut u zhvillua paralelisht me artin modern jugosllav dhe evropian, e jo në izolim. Artistët e parë modernë nga Maqedonia arsimin e tyre artistik e fituan jashtë vendit, duke sjellë në atdhe përvoja dhe ndikime të reja artistike. Enformeli maqedonas i viteve 1960 është pjesë e një procesi më të gjerë artistik evropian, por njëkohësisht ka veçoritë dhe karakteristikat e veta dalluese. Disa artistë nga Maqedonia e Veriut, si Omer Kaleshi, kanë jetuar dhe punuar në qendra të rëndësishme kulturore evropiane, por në krijimtarinë e tyre kanë mbetur të lidhur ngushtë me temat, traditën dhe identitetin kulturor të vendlindjes së tyre.

Kontribut të rëndësishëm në zhvillimin e artit në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhanë edhe artistët shqiptarë, ndër ta **Miftar Memeti**, një pjesë e krijimtarisë së të cilit është e lidhur me figurën e Nënë Terezës; **Nevzat Bejtuli-Kica**, i njohur për figuracionin ekspresiv; **Nehat Beqiri**, i cili lëvizi nga figuracioni, në forma abstrakte dhe simbolike; si dhe **Reshat Ameti**, i njohur për temat e traditës dhe shpirtërores.



▲ Nevzat Bejtuli - Kica, „Qetësi“, 2000



▲ Reshat Ameti, „Kompozicion i lirë 11“, 2019



▲ Nehat Beqiri, „Syri“, 2009

Pyetje

1. Pse arti modern në Republikën e Maqedonisë së Veriut zhvillohet më vonë në krahasim me qendrat evropiane?
2. Çfarë roli kanë pasur zografët e fundit në kalimin nga arti sakral në artin modern?
3. Si ndryshon abstraksioni nga enformeli?
4. Pse figura u kthye sërish në vitet 1970?
5. Si ndryshon raporti me stilin me shfaqjen e artit postmodern?

ARTI BASHKËKOHOR NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT

(nga pavarësimi deri më sot)

Arti bashkëkohor në Republikën e Maqedonisë së Veriut filloi në gjysmën e dytë të viteve 1990, pas pavarësimit të shtetit në vitin 1991. Kjo periudhë u karakterizua nga ndryshimet e mëdha shoqërore dhe politike, si dhe nga hapja ndaj botës. Ndryshe nga periudhat e mëparshme, artistët nuk punuan më në një stil të përbashkët, por secili autor zgjodhi mënyrën e vet të shprehjes.

Vepra në artin bashkëkohor nuk duhet të jetë domosdoshmërisht pikturë ose skulpturë. Artistët përdorën forma të ndryshme, si instalacionet, videot, fotografitë, performancën dhe ndërhyrjet në hapësirë. E rëndësishme është ajo çfarë duan të shprehin, dhe jo vetëm pamja e veprës.

Media të reja dhe kushte të reja

Rol të madh në zhvillimin e artit bashkëkohor luajti Qendra Soros për art bashkëkohor në Shkup, e themeluar në vitin 1993. Kjo qendër u mundësoi artistëve të eksperimentonin me mediat e reja dhe të ecnin në hap me skenën artistike botërore.

Temat e artit bashkëkohor

Artistët bashkëkohorë në Republikën e Maqedonisë së Veriut më së shpeshti trajtuan temat që lidhen me:

- identitetin personal dhe kulturor
- kujtesën dhe të kaluarën
- trupin dhe gjininë
- ndryshimet shoqërore dhe politike
- marrëdhënien ndërmjet lokale dhe globale

NOCIONE KYÇE

art bashkëkohor, media e re, instalacion, performancë, identitet, globalizëm, arkitekturë, mozaik

► A e dini se...

Vepra e artit bashkëkohor nuk duhet të jetë domosdoshmërisht e përhershme – ajo mund të ekzistojë vetëm gjatë një aksioni ose ekspozite. Shumë artistë bashkëkohorë nga Republika e Maqedonisë së Veriut i ekspozuan veprat e tyre edhe jashtë vendit. Arti bashkëkohor shpesh shtron pyetje, në vend që të ofrojë përgjigje të gatshme.

Artistët dhe qasjet

AKTIVITET

Zgjidh një vepër të një artisti bashkëkohor nga Republika e Maqedonisë së Veriut (fotografi, video ose instalacion). Përpiqu të përgjigjesh: Për çfarë flet vepra? Cili medium është përdorur? Çfarë ndjenje ngjall? Mendo dhe diskuto: A duhet një vepër arti të jetë domosdoshmërisht e bukur për të qenë e rëndësishme?

Ndër autorët më të rëndësishëm janë: **Sllavica Janeshlieva**, e cila punoi me media të ndryshme dhe hulumtoi kujtimet personale dhe kolektive; **Oliver Musoviqi**, i cili nëpërmjet performancave dhe instalacioneve trajtoi tema shoqërore; **Robert Jankuloski**, i cili përdori fotografinë për të hulumtuar hapësirën dhe kujtesën; **Monika Moteska**, e cila krijoi vepra poetike, të ndjeshme me video dhe instalacion, si dhe shumë të tjerë.

Rol të rëndësishëm luajtën edhe **Jane Çalovski** dhe **Hristina Ivanovska**, të cilët punuan me arkiva, tekste dhe histori, duke e lidhur artin me gjuhën dhe me të kaluarën.

Përveç tyre, skenën bashkëkohore e përbëjnë edhe autorë dhe grupe të tjera, si **Igor Toshevski**, **Nada Përlja**, grupi **OPA**, **Elpida Haxhi-Vasileva** e cila krijon vepra me mbetje organike, si dhe shumë artistë të tjerë të rinj. Kjo tregon se arti bashkëkohor në Republikën e Maqedonisë së Veriut është i larmishëm dhe vazhdimisht në zhvillim.

▼ Robert Jankuloski, "Si ju si mi - See you see me", 1998–2001



▲ Monika Moteska, "Themra e Akilit", 1998



▼ Sllavica Janeshlieva, "Klithma", 2002



▲ Jane Çalovski, "Të padisiplinuarit", 2021

▼ Hristina Ivanovska, "Emërtimi i urës: Rosa Plaveva dhe Nakie Bajram", 2006



▼ Igor Toshevski, "Territor i lirë", 2004-2010



▲ Nada Përlja, "Muri i paqes", 2012



▲ Elpida Haxhi-Vasileva, "Haruspex", 2015

Arti bashkëkohor sot

Artistët në Republikën e Maqedonisë së Veriut sot marrin pjesë në mënyrë aktive në ekspozita ndërkombëtare, bienale dhe programe artistike jashtë vendit.

Edhe pse disa prej tyre jetojnë dhe punojnë jashtë, ata shpesh mbeten të lidhur me kontekstin dhe temat e vendit të tyre.

Pas vitit 2000, arti bashkëkohor në Republikën e Maqedonisë së Veriut nuk mund të përkufizohet me një stil ose drejtim të vetëm. Ai karakterizohet nga liria, eksperimentimi dhe mendimi kritik, ndërsa arti gjithnjë e më shpesh përdoret si mjet për dialog dhe për ngritjen e çështjeve të rëndësishme shoqërore.

Pyetje

1. Si ndryshon arti bashkëkohor nga arti modern?
2. Cilat media përdoren më shpesh nga artistët bashkëkohorë?
3. Cilat tema trajtohen më shpesh në artin bashkëkohor në Republikën e Maqedonisë së Veriut?
4. Pse arti bashkëkohor shpesh shkakton reagime të ndryshme te publiku?
5. Si ndikon globalizimi në punën e artistëve bashkëkohorë?

Koncepte arkitekture dhe arti i mozaikut në Republikën e Maqedonisë së Veriut

Arkitektura në Republikën e Maqedonisë së Veriut gjatë shekullit XX u zhvillua me ngritjen e ndërtesave të hershme urbane dhe përfaqësuese në Shkup (modernizmi i hershëm dhe neoklasikja), si Shtëpia e Oficerëve, Pallati i Ristiçit dhe ndërtesa e Teatrit Popullor Maqedonas, të cilat pasqyruan kontekstin e vonë osman dhe atë evropian të periudhës ndërmjet dy luftërave. Më pas ajo u zhvillua nëpërmjet modernizmit socialist pas Luftës së Dytë Botërore, deri te brutalizmi i theksuar pas tërmetit të vitit 1963, duke kulmuar me rindërtimin pas tërmetit sipas planit “Master” të **Kenzo Tanges**, me konceptet “Porta e qytetit”, “Stacioni hekurudhor” dhe “Muri i qytetit”. Ky plan u realizua nëpërmjet veprave të arkitektëve si **Georgi Konstantinovski** (Konvikti i studentëve “Goce Dellçev”), **Janko Konstantinovi** (Posta kryesore e Shkupit) dhe **Boris Çipani** (ndërtesa e ASHAM), si dhe **Zhivko Popovski** me ekipin e arkitektëve dhe urbanistëve (Qendra tregtare e qytetit – GTC).

▶ Kenzo Tange – Plani urbanistik për zonën qendrore të Shkupit (“Porta e qytetit” dhe “Muri i qytetit”), 1965



▶ Kenzo Tange – Stacioni hekurudhor i Shkupit, 1965–1981

▶ A e dini se...

Kenzo Tange është arkitekt japonez i cili hartoi planin urbanistik për rindërtimin e Shkupit pas tërmetit të vitit 1963. Plani i tij modernist e riorganizoi strukturën e qytetit dhe pati ndikim të madh në zhvillimin e tij bashkëkohor.



▶ Janko Konstantinovi – Ndërtesa e Postës së Maqedonisë në Shkup, 1974–1982

Mozaiku në Maqedoni ka një traditë të gjatë, që nga ata antikë dhe paleokristianë në Heraklea dhe Stobi, deri te mozaikët monumentale bashkëkohore në hapësirat publike, institucionet dhe objektet kulturore. Ndër autorët më të rëndësishëm të mozaikut dhe artit monumental bashkëkohor në Maqedoninë e Veriut janë **Gligor Çemerski** dhe **Gazanfer Bajram**.



▲ Gligor Çemerski – Mozaik në Monumentin e lirisë, Koçan, 1981

► A e dini se...

Mozaiku monumental i Gligor Çemerskit, i vendosur si pjesë e Monumentit të lirisë në Koçan, përfaqëson kompozim vizual ekspresiv me figura dinamike, forma simbolike dhe ritëm të fortë koloristik, me anë të të cilave interpretohen idetë e luftës, të lirisë dhe të kujtesës kolektive në artin monumental bashkëkohor të Maqedonisë së Veriut.



▲ Monumenti i lirisë, Koçan



▲ Gazanfer Bajram, "Orfeu maqedonas / Bariu – Luftëtari", 1999



▲ Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut

Pyetje

1. Cilat janë stilet më të rëndësishme në arkitekturë në Maqedoni në shekullin XX?
2. Çfarë bëri Kenzo Tange për Shkupin pas tërmetit të vitit 1963?
3. Cilët janë artistët më të njohur bashkëkohorë të mozaikut në Maqedoni?

TEMA 2: SHPREHJA PAMORE

Bota e artit pamor ka gjuhën e vet, pra mënyrën e vet të shprehjes pamore. Shprehja pamore nënkupton procesin e përcjelljes së mendimeve, ndjenjave dhe mesazheve nëpërmjet formave dhe mjeteve vizuale, përkatësisht vizatimit, pikturës, grafikës, dizajnit grafik, skulpturës, fotografisë, mediave digjitale, madje edhe nëpërmjet arkitekturës. Me anë të këtyre formave, artistët dhe dizajnerët ndajnë ide që ndonjëherë nuk mund të shprehen me fjalë. Ata përdorin elemente, si: vijat, ngjyrat, format, teksturat dhe hapësirat.

Që nga kohët më të hershme, njeriu është shprehur nëpërmjet imazheve. Shprehja pamore, si një nga format më të vjetra të komunikimit, u ka mundësuar njerëzve të përcjellin mendimet dhe ndjenjat e tyre me anë të gjurmëve vizuale, shumë kohë përpara shfaqjes së fjalës së shkruar.

Me kalimin e kohës, artistët zbuluan teknika dhe materiale të reja për të zhvilluar krijimtarinë e tyre. Ky zhvillim në artin bashkëkohor vazhdon me anë të eksperimentimit me media, teknologji dhe koncepte të reja.

Shprehja pamore realizohet nëpërmjet gërshetimit të mediave, mjeteve dhe teknikave. Mediumi është materiali që përdoret për krijimin e veprës artistike, e që mund të jetë: lapsi, ngjyra e tushit, ngjyra, argjila, metali ose mjetet digjitale. Teknika është mënyra se si artisti e përpunon materialin për të arritur efekte të caktuara, si: hijezimi, shtresëzimi, gdhendja, modelimi ose shtypja.

Pavarësisht sa shumë zhvillohen mjetet dhe teknikat, thelbi i artit mbetet i njëjtë. Piktura e shpellave, e krijuar mijëra vjet më parë, ose vepra digjitale bashkëkohore e sotme kanë të njëjtin qëllim: të pasqyrojnë dhe të shprehin bukurinë, ndërlíkueshmërinë dhe larmishmërinë e botës që na rrethon. Për sa kohë që do të vazhdojmë të krijojmë dhe të vlerësojmë artin, do të gjejmë mënyra të reja dhe novatore të shprehjes.

Përdorimi i mediave dhe i teknikave të ndryshme nxit eksperimentimin dhe krijimtarinë. Duke hulumtuar materialet dhe teknikat, mund të zhvillojmë aftësitë teknike, stilin personal dhe gjuhën vizuale për shprehjen e ideve dhe emocioneve, si dhe të njohim e të dallojmë teknikat e ndryshme në veprat artistike. Shprehja pamore mbetet mjet i fuqishëm i krijimtarisë dhe i reflektimit, si në histori ashtu edhe në artin bashkëkohor.

Qëllimet e temës

- Të hulumtoni dhe eksperimentoni me teknikat e vizatimit, pikturës dhe grafikës, si dhe kombinimet e tyre.
- Të modeloni forma tredimensionale duke përdorur teknika skulpturore.
- Të njihni, t'i krahasoni dhe analizoni teknikat e ndryshme figurative në veprat artistike.
- Të krijoni vepra personale duke ndërthurur teknikat e ndryshme figurative.
- Të zhvilloni aftësitë teknike për punë me media dhe mjete të ndryshme artistike.
- Të zhvilloni qasjen krijuese dhe eksperimentuese gjatë përzgjedhjes dhe zbatimit të teknikave.

TEKNIKAT E VIZATIMIT

Hyrje

NOCIONET KYÇE

vijë, laps, lapsa me ngjyra, thëngjill vizatimi, tush me penë/dru/furçë, flomasterë, markerë, materiale dhe teknika tradicionale dhe jokonvencionale të vizatimit, vijëzim (shrafurë), iluzion i vëllimit, plasticitet, vijë konturore, vijë strukturore, vijë teksturore

Vizatimi është një nga format më të vjetra dhe themelore të shprehjes vizuale.


Nga vizatimet parahistorike në shpella, deri te veprat bashkëkohore digjitale, vizatimi mbetet baza e të gjitha arteve pamore, duke përfshirë pikturën, skulpturën, arkitekturën dhe dizajnin.

Në kuptimin më të gjerë, vizatimi është krijimi i paraqitjeve vizuale me anë të vijave, gjurmëve dhe toneve mbi një sipërfaqe të caktuar. Vizatimi nuk është vetëm një paraqitje teknike e realitetit; ai mund të jetë ekspresiv, simbolik, konceptual ose eksperimental. Shpesh përdoret për skicim, hulumtim dhe planifikim, por mund të ekzistojë edhe si vepër artistike e pavarur.

Artistët shpesh gërshetojnë mënyra realiste, simbolike dhe ekspresive të vizatimit gjatë krijimit të kompozimeve të tyre. Nga diagramet dhe skemat, nëpërmjet natyrës së qetë dhe ilustrimeve, deri te vizatimet figurative dhe abstrakte, ata mund të paraqesin një gamë të gjerë temash dhe idesh.

Në historinë e artit, Leonardo da Vinçi e përdori vizatimin për kërkime shkencore dhe anatomike. Në artin modern dhe bashkëkohor, vizatimi bëhet bartës i drejtpërdrejtë i emocioneve dhe ideve, si te Pablo Pikaso, Egon Shile dhe Saj Tuombli.

▼ Leonardo da Vinçi, "Njeriu i Vitruvit", rreth vitit 1490



▲ Pablo Pikaso, "Koka e një gruaje", fillimi i viteve 1950, pjesë e serisë „Lufta dhe Paqja“



▲ Saj Tuombli, "Pa titull (Bakus)", viti 2005

Mjetet dhe materialet për vizatim

Materialet tradicionale për vizatim përbëjnë themelin e edukimit artistik dhe përdoren ende gjerësisht, si:

- lapsat e grafitit (nga të fortë deri te të butë)
- lapsat me ngjyra
- thëngjilli i vizatimit
- tushi me penë, dru ose furçë
- shkumësi dhe konté
- lloje të ndryshme letre dhe pëlhurash

Këto materiale mundësojnë kontrollin e vijës, tonit dhe teksturës. Për shembull, Rembrand van Rajni përdori tush dhe penë për të krijuar kontraste dramatike, ndërsa Albreht Dyreri realizoi vizatime jashtëzakonisht të sakta duke përdorur vija të holla.



▲ Rembrandt van Rajn, "Natani duke qortuar Davidin", 1650–1655



▲ Albreht Dyrer, "Studime të dorës së majtë të artistit", 1493–1494 (detaj)

Materialet bashkëkohore dhe jokonvencionale

Me zhvillimin e artit bashkëkohor, artistët eksperimentuan me materiale dhe media të reja:

- flomasterë dhe markerë
- kolazh dhe materiale të gjetura
- materiale industriale
- mjete digjitale (tableta grafike, programe kompjuterike)
- vizatim në mure, dyshe me ose në hapësira publike

Artistë bashkëkohorë, si Uiliam Kentrixhi, gërshetuan vizatimin klasik me animacionin, duke treguar se vizatimi është medium i gjallë dhe i ndryshueshëm që zhvillohet dhe përshtatet vazhdimisht me teknikat dhe teknologjitë e reja.



Uiliam Kentrixh,
"Vizatim nga stereoskopi",
1998–1999

Teknikat e vizatimit

Teknikat e vizatimit përfshijnë mënyra të ndryshme të krijimit të një vizatimi me anë të vijës, tonit dhe teksturës, varësisht nga qëllimi, materiali dhe shprehja e artistit. Ato mundësojnë krijimin e strukturës, lëvizjes dhe shprehjes vizuale.

Ndër këto teknika bëjnë pjesë: vizatimi linear dhe konturor, hijezimi, vizatimi ekspresiv, si dhe përdorimi i mediave të kombinuara për të theksuar formën, teksturën, vëllimin dhe atmosferën.

Vija dhe vizatimi konturor


► A e dini se...

Vija në kaligrafi ka po aq rëndësi sa edhe në vizatim. Me anë të trashësisë, drejtimit dhe formës së vijave, kaligrafi mund të përcjellë ritëm, lëvizje dhe emocion, ngjashëm siç artisti e përdor vizatimin për të krijuar vëllim, teksturë ose dinamikë.

Vija është elementi themelor vizual i vizatimit. Ajo mund të jetë konturore, strukturore, teksturore ose ekspresive dhe nëpërmjet saj shprehen forma, lëvizja dhe emocion.

Me anë të vijave përcaktohen format, konturet dhe struktura e objektit, pa përdorimin e tonit ose hijes. Vizatimi konturor zakonisht është linear.

Ekzistojnë lloje të ndryshme të vizatimit konturor, siç janë vizatimi konturor i verbër, vizatimi me vijë të pandërprerë, etj. Shumë artistë bashkëkohorë kanë krijuar vepra të fuqishme vizuale duke përdorur një vijë minimale, por të sigurt.



▲ Ellsuorth Kelli, "Mollë", 1949




► Suzan Rothenberg,
"ShBA", 1975

Hijezimi dhe vizatimi tonal


Hijezimi përdoret për të paraqitur dritën dhe hijen, duke krijuar iluzionin e thellësisë dhe vëllimit. Vizatimi tonal bazohet në gradacionet e tonit nga e çelëta drejt së errëtës.

Teknikat më të zakonshme të hijezimit janë:

- **Shrafura dhe shrafura e kryqëzuar** – teknikë për ndërtimin e tonit me anë të vijave paralele ose të kryqëzuara. Dendësia dhe drejtimi i vijave e përcaktojnë intensitetin e hijes.



▲ Shrafurë



▲ Shrafurë e kryqëzuar

AKTIVITET

Bëni një studim konturor: zgjidhni një objekt të përditshëm dhe vizatoni me vijë të vazhdueshme, pa e ngritur lapsin nga letra. Përqendrohuni te forma dhe konturet e objektit. Më pas bëni një eksperiment tonal duke përdorur thëngjill vizatimi ose laps: krijoni një shkallë tonale nga më e çelëta deri te më e errëta dhe zbatoni atë në një vizatim të sferës për të hulumtuar se si drita dhe hija krijojnë vëllim.

Vepra “Bodleri” e Zhak Vilon ilustron përdorimin e shrafurës dhe të shrafurës së kryqëzuar për krijimin e vlerave të ndryshme tonale. Vijat përdoren për të ndërtuar vëllimin, thellësinë dhe kontrastin, duke e bërë vizatimin të pasur dhe të saktë vizualisht.

- **Pointilizmi** – teknikë në të cilën format, vëllimi dhe vlerat tonale krijohen me ndihmën e pikave të vogla, në vend të vijave të pandërprera ose hijezimit me shrafurë. Vizatimi “Heroi” është një shembull hiperrealist i pointilizmit, i realizuar me miliona pika të imëta të shkruara me stilolaps. Nëpërmjet dendësisë dhe shpërndarjes së pikave, artisti arrin kalime të qarta tonale nga e çelëta drejt së errëtës, duke krijuar një përshtypje të fortë të vëllimit, thellësisë dhe realizmit. Kjo vepër është një nga shembujt më të njohur bashkëkohorë të pointilizmit dhe tregon qartë se si vija dhe pika mund të krijojnë formë të ndërlikuar vizuale.



▲ Zhak Vilon, “Bodleri”, 1920



- **Kalimi i butë tonal** – teknikë e kalimit gradual nga e errëta drejt së çelëtës ose nga një ngjyrë në tjetrën, pa kontraste të forta ose vija të theksuara.

▲ Migel Endara, "Herói", 2011



Tekstura, vëllimi dhe plasticiteti në vizatim

Në vizatim, tekstura i referohet përshtypjes vizuale ose taktile të sipërfaqes së objektit të paraqitur. Ajo mund të jetë reale ose e sugjeruar vizualisht me anë të vijave, pikave, shrafurës dhe kalimeve tonale, duke krijuar përshtypjen e lëmueshmërisë, ashpërsisë, butësisë ose fortësisë.

Vëllimi dhe plasticiteti krijojnë iluzionin e tredimensionalitetit të formës brenda një sipërfaqeje dydimensionale. Këto efekte në vizatim arrihen me anë të teknikave të ndryshme të vizatimit, si:

- **drita dhe hija** – nëpërmjet modelimit tonal, shrafurës, shrafurës së kryqëzuar ose kalimit të butë tonal;
- **drejtimi dhe dendësia e vijës** – vijat mund të ndjekin formën (shrafurë konturore) ose të krijojnë teksturën e sipërfaqes;
- **kontrasti dhe mbivendosja** – kontraste të qarta ndërmjet toneve të çelëta dhe të errëta ose mbivendosje vijash dhe shtresash që krijojnë përshtypjen e thellësisë dhe formës.

Për shembull, Henri Muri në studimet e tij të deleve, formën e kokës së një deleje e paraqet nëpërmjet vijave dhe trajtimit tonal, duke krijuar vëllim dhe tredimensionalitet. Vijat ndjekin formën e deles dhe paraqesin strukturën e leshit të saj.

Forma në artin bashkëkohor shpesh thjeshtësohet ose shtrembërohet për qëllime shprehëse, ndërsa vija përdoret si element themelor i shprehjes. Në pikturën/kolazhin "Rrethi i figurave", Zhan Dybyfeja përdor lloje të ndryshme vijash për të krijuar tekstura të ndryshme.



▲ Zhan Dybyfe, "Rrethi i figurave", 1977

Teknikat ekspresive dhe eksperimentale

Vizatimi ekspresiv thekson gjestin emocional dhe personal, në vend të saktësisë. Egon Shile përdori vija të shtrembëruara për të paraqitur tendosjen e brendshme dhe shprehjen subjektive vizuale.

Vizatimi eksperimental përfshin media të përziera, formate të mëdha, qasje konceptuale dhe procese performuese. Sol Luiti e zgjeroi vizatimin në një sistem konceptual, ndërsa artistët bashkëkohorë si Xhuli Mehretu ndërthurën elemente arkitekturore dhe abstrakte, duke treguar se vizatimi mund të jetë një medium dinamik dhe inovativ.



▲ Egon Shile,
"Autoportret si Shën Sebastiani", 1914



▲ Xhuli Mehretu, "Ndërtim empirik", 2003

Pyetje

1. Pse vizatimi konsiderohet si bazë e arteve pamore?
2. Cili është dallimi ndërmjet vizatimit konturor dhe vizatimit tonal?
3. Cilat janë teknikat më të zakonshme të hijezimit në vizatim dhe si përdoren për krijimin e thellësisë dhe vëllimit?
4. Si ndikon zgjedhja e materialit në shprehjen e vizatimit?
5. Në çfarë mënyre artistët bashkëkohorë i zgjerojnë kufijtë e vizatimit?

TEKNIKAT E PIKTURËS

Hyrje

NOCIONET KYÇE

teknika dhe procese pikturimi, pigment, vaj, akrilik, akualet, guash, tempera, pastel, media të përziera, pikturë digjitale, teknikë e lagësht dhe e thatë, lazurë, transparencë

Piktura është formë e artit pamor ku artisti përdor ngjyra dhe materiale të tjera për të krijuar imazhe në sipërfaqe të caktuar, si kanavacë, letër, dru ose hapësirë publike. Ajo mundëson paraqitje ekspresive, simbolike, realiste ose abstrakte të botës dhe ideve të artistit. Piktura paraqet mënyrën themelore të shprehjes vizuale që lejon hulumtimin e ngjyrës, formës, dritës dhe hapësirës. Ajo shërben si vepër e pavarur artistike ose si bazë për forma të tjera të artit pamor.

Mjetet dhe materialet e pikturës

AKTIVITET

Ndahuni në grupe dhe zgjidhni nëse do të punoni në sipërfaqe të lagësht ose të thatë. Bëni një vizatim me laps duke përdorur konture, hijezime dhe shrafurë për të krijuar vëllim. Në sipërfaqe të lagësht përdorni akualet ose guash për kalime të buta dhe efekte transparente. Në sipërfaqe të thatë krijoni një skenë urbane me tush. Mund të realizoni edhe kompozicion abstrakt me ngjyra akrilike ose tempera duke përdorur mjete të ndryshme për teksturë dhe shtresëzim.

Piktorët përdorin materiale dhe mjete të ndryshme tradicionale dhe bashkëkohore:

- materiale tradicionale: ngjyra vaji, akualet, tempera dhe akrilik; pastel dhe shkumës; tush; kanavacë, letër dhe dërrasë druri,
- mjete: penela me forma dhe madhësi të ndryshme, paleta për përzierjen e ngjyrave, spatula dhe thika pikturë, sfungjerë për teksturë, tableta digjitale dhe stilusë (lapsa digjitale),
- materiale bashkëkohore dhe eksperimentale: materiale të gjetura, materiale industriale dhe të ricikluara, media të përziera dhe teknika digjitale.

Teknikat e pikturës

Teknikat e pikturës janë mënyra se si artisti e aplikon ngjyrën për të krijuar formë, vëllim dhe teksturë. Ato ndihmojnë në paraqitjen e dritës, hijes dhe efekteve të ndryshme në vepër.

Ngjyra për pikturim përbëhet prej tri elementeve bazë: **pigmenti**, që jep ngjyrën dhe nuancën; **lidhësi**, që e mban ngjyrën së bashku dhe e fikson në sipërfaqe; dhe **holluesi**, që e hollon ngjyrën dhe lehtëson aplikimin.

Gërshetimi i këtyre elementeve krijon lloje të ndryshme ngjyrash dhe efektesh, si për shembull ngjyra vaji, ngjyra akrilike, tempera ose akualet.

Teknikat e pikturës janë:

- **Pikturim me ngjyra vaji** – teknikë në të cilën ngjyra përzihet me vaj (zakonisht vaj liri) dhe aplikohet në kanavacë, dru ose sipërfaqe tjetër. Me këtë teknikë mund të krijohen shtresa ngjyrash, vëllim dhe kalime graduale tonale, sepse vaji mundëson tharje të ngadaltë dhe përzierje të lehtë të ngjyrave. Përdoret për realizëm, për krijimin e dritëhijes dhe thellësisë.
- **Pikturim me ngjyra akrilike** – teknikë në të cilën përdoret ngjyrë e përbërë nga pigmenti dhe lidhësi akrilik, e cila zakonisht hollohet me ujë. Thahet shpejt, mundëson aplikim në shtresa dhe mund të përdoret si transparente dhe jo transparente, duke e bërë të përshtatshme për eksperimentim me teksturë, ngjyrë dhe formë.

► **A e dini se...**

Në historinë e artit, Leonardo da Vinci zhvilloi teknikën e kalimit të butë të toneve dhe ngjyrave pa konture të forta, të quajtur sfumato, ndërsa Karavaxho përdori kontraste të forta drite, teknikë e njohur si tenebrizëm.



► Dejvid Hokni, "Një spërkatje më e madhe", 1967

◀ Leonardo da Vinci, "Mona Lisa", 1503–1519

- **Akuarel** – teknikë pikturë ku ngjyra hollohet me ujë dhe aplikohet zakonisht në letër. Karakterizohet nga shtresa transparente, tone të lehta dhe kalime të buta, duke krijuar ndjesi lehtësie dhe drite.



▲ Pol Kle,
"Kolona të zeza në peizazh", 1919

- **Tempera** – teknikë në të cilën pigmenti përziehet me një lidhës me bazë uji dhe veze. Aplikohet në shtresa të holla dhe mundëson ngjyra të pastra, forma të sakta dhe detaje, prandaj është përdorur gjerësisht në pikturën mesjetare dhe në ikonografi.



▲ Sandro Botiçeli,
"Lindja e Venusit", rreth 1484–1486

- **Freska** – teknikë pikturimi në të cilën ngjyra aplikohet mbi suva të lagur. Pigmentet depërtojnë në sipërfaqen e murit, duke e bërë veprën të qëndrueshme dhe afatgjatë, prandaj përdoret për pikturë murale.



▲ Mikelanxhelo,
"Krijimi i Adamit", rreth 1508–1512

- **Enkaustikë** – teknikë pikturimi ku pigmenti përziehet me dyll blete të ngrohur dhe aplikohet në sipërfaqe sa është i nxehtë. Mundëson teksturë të pasur, thellësi dhe efekt shkëlqimi, ndërsa ngjyra është e qëndrueshme dhe rezistente ndaj kohës.
- **Guash** – teknikë në të cilën ngjyra hollohet me ujë, por për dallim nga akuareli, është jotransparente. Jep ngjyra të forta që nuk shkëlqejnë (mat) dhe sipërfaqe të rrafshëta, prandaj përdoret shpesh në ilustrim, dizajn dhe në skicë studimore.
- **Pasteli** – teknikë pikturimi në të cilën ngjyra është në formë shkopinjsh të përbërë prej pigmenti dhe lidhësi. Aplikohet drejtpërdrejt në letër dhe mundëson tone intensive, kalime të buta dhe teksturë të pasur. Mund të jetë pastel i thatë ose pastel me vaj dhe përdoret për efekte ekspresive dhe të gjalla.
- **Media të përziera (mixed media)** – teknikë bashkëkohore në të cilën gërshetohen materialet dhe teknikat e ndryshme artistike, duke mundësuar eksperimentimin me teksturën, formën dhe shprehjen. Përdoret shpesh në artin bashkëkohor.



▲ Portret i lashtë funeralor me teknikë enkaustike, Muzeu i artit "Metropolitan"



▲ Anri Matis, "Gruaja me kapelë", 1905



▲ Alberto Burri, "Vepër e madhe prej thesi", 1952




▲ Edgar Dega, "Baleti / Ylli / Valltarja në skenë", 1876-1877

- **Piktura digjitale** – teknikë në të cilën vepra krijohet me kompjuter, tablet ose softuer digjital. Mundëson përzierjen e lehtë të ngjyrave, punën me shtresa, korrigjimin e shpejtë dhe eksperimentimin me stile dhe tekstura.

AKTIVITET

Hulumtoni në internet vepra përfaqësuese të periudhave dhe lëvizjeve të ndryshme artistike. Analizoni teknikat që kanë përdorur artistët dhe përgjigjuni individualisht pyetjeve lidhur me veçoritë teknike të veprave të zgjedhura.



Dejvid Hokni, "Pranvera në Uollgejt, Jorkshiri Lindor", 2011

Procedurat e pikturimit

Procedurat e pikturimit janë mënyra të ndryshme të aplikimit dhe përpunimit të ngjyrës për të krijuar formë, vëllim dhe efekte, si:

- **teknika e lagësht** – ngjyra aplikohet mbi sipërfaqe ende të lagësht, duke mundësuar përzierjen dhe kalimet e buta të toneve,
- **teknika e thatë** – aplikim pothuajse i thatë i ngjyrës për të krijuar efekte teksturore dhe hollësi,
- **lazurë** – shtresa të holla dhe transparente të aplikuara mbi bojë të thatë për thellësi dhe efekte drite,
- **transparencë** – përdorimi i ngjyrës së tejdukshme për të lejuar që të shihet shtresa poshtë saj, duke krijuar efekte drite dhe ndjesi hapësinore,
- **aplikim me shtresa** – ndërtimi i ngjyrës me disa shtresa për më shumë thellësi, vëllim dhe teksturë.

Këto procedura mund të gërshetohen për të arritur efekte të ndryshme vizuale dhe shprehëse në pikturë.

Pyetje

1. Cilat janë tri elementet bazë të ngjyrës në pikturë?
2. Çfarë është pikturimi me ngjyra vaji dhe çfarë është pikturimi me ngjyra akrilike?
3. Cili është dallimi midis akuarelit dhe guashit?
4. Cilat teknika përdoren për vëllim dhe teksturë në pikturë?
5. Çfarë është sfumato dhe çfarë është tenebrizmi?

TEKNIKAT E GRAFIKËS

Hyrje

Grafika artistike është formë e artit pamor në të cilën artisti krijon vepra me anë të teknikës së shtypjes nga një matricë e përgatitur më parë. Kjo teknikë mundëson realizimin e disa kopjeve nga një vepër origjinale dhe secila kopje e shtypur konsiderohet po ashtu origjinale. Grafika përdoret për qëllime artistike, ilustruese dhe dekoruese, dhe më së shpeshti realizohet në letër ose tekstil, me anë të teknikave të ndryshme, si gdhendje në dru, në pllakë bakri, litografi ose serigrafi.

NOCIONET KYÇE

teknika grafike, shtypje e lartë dhe e thellë, litografi, monotipi, serigrafi, kolagrafi, shtypje digjitale, skicë, matricë, tirazh, print (gjurmë e shtypur)

Mjetet dhe materialet e grafikës

Mjetet:

- mjete dore: daltë, mjete për gravurë, gjilpërë për pllakë bakri ose metali, mjete për linogdhendje
- furça dhe rule (në trajtë cilindri) për aplikimin e ngjyrës
- sfungjerë për krijimin e teksturës dhe hijezimit
- instrumente manuale dhe digjitale për litografi dhe grafikë digjitale

Materialet:

- letër (me dendësi dhe tekstura të ndryshme)
- bojë grafike (e zezë, me ngjyra, e papërshkueshme nga uji)
- pllaka për shtypje (dru, metal, gur, plastikë, linoleum)
- agjentë kimikë për shtypje në thellësi
- pigmente dhe bojë për serigrafi
- tablete digjitale dhe softuer për grafikë kompjuterike

Këto mjete dhe materiale mundësojnë kontrollin mbi vijën, teksturën, tonin dhe riprodhueshmërinë e veprës grafike.

Teknikat grafike

Teknikat grafike janë metoda për krijimin e kopjeve të shtypura artistike nga një matricë e përgatitur më parë, zakonisht në letër ose në materiale të tjera. Çdo teknikë ofron efekte vizuale dhe mënyra të ndryshme shprehjeje.

AKTIVITET

Punoni në grupe ose individualisht dhe krijoni një vepër sipas idesë suaj, duke gërshtuar të paktën dy teknika figurative – për shembull, vizatim me tush dhe kolazh, akualet dhe laps, monotipi dhe pikturë. Eksperimentoni me materiale dhe tekstura, hulumtoni ngjyrat dhe format dhe në fund prezantoni punën tuaj para grupit, duke shpjeguar zgjedhjen e teknikave dhe konceptin e veprës.

Termet bazë në grafikë janë:

- skicë – vizatim paraprak ose ide për një vepër grafike
- matricë – pllaka ose sipërfaqja nga e cila bëhen shtypjet
- print (gjurmë e shtypur) – kopje e imazhit e transferuar nga matrica në letër ose material tjetër përmes procesit të shtypjes
- seri grafike ose tirazh – numri i përgjithshëm i kopjeve të shtypura nga e njëjta matricë
- pozitiv/negativ – mënyra e paraqitjes së ngjyrës; pozitiv është pjesa me ngjyrë, negativ është pjesa bosh

Teknikat kryesore grafike janë: shtypja e lartë (reliev), shtypja e thellë (intaglio), shtypja e rrafshët (litografi), shtypja nëpërmjet rrjetës (serigrafi), monotipia (print i vetëm), kolagrafia (shtypje nga pllaka me materiale të ngjitura) dhe shtypja digjitale (me kompjuter ose softuer digjital).

- **Relievi** (shtypje e lartë) – ngjyra aplikohet në pjesët e ngritura të pllakës, të cilat i transferojnë gjurmët në letër. Më shpesh përdoren drugdhendja dhe linogdhendja; gjurma e gishtit është gjithashtu shembull i kësaj teknike.




▲ Albrecht Dyrer, "Melankolia I", 1514



▲ Katsushika Hokusai, "Vala e madhe në Kanagava", 1831

- **Intaglio** (shtypje e thellë) – vizatimi gdhendet në pllakë. Ngjyra mbetet në vijat ose sipërfaqet e gdhendura dhe shtypja realizohet me trysni. Shembuj: bakërgdhendja, oforti, gjilpëra e thatë dhe akuatinta. Pllaka zakonisht është prej bakri, zinku ose metali tjetër. Mundëson tone të pasura, thellësi dhe linja precize.



▲ Teofil Shtajnen, "Macja e zezë", 1896



▲ Endi Uorhol, "Diptihu Marilyn", 1962

- **Litografi** – imazhi vizatohet në një sipërfaqe të sheshtë guri ose metali, ndërsa ngjyra transferohet vetëm në pjesët e vizatimit. Mundëson linja të sakta, efekte tonale, tekstura dinamike dhe riprodhim të përsëritur.
- **Serigrafi** – ngjyra kalon në zona të caktuara nëpërmjet një rrjete tekstili ose metali, duke lënë gjurmë. Mundëson ngjyra të pastra, riprodhim të përsëritur dhe punë me sipërfaqe të mëdha. Shpesh përdoret në veprat pop-art të Andi Uorholit.
- **Monotipi** – print unik i krijuar duke transferuar ngjyrën nga pllaka në letër; çdo print është i vetëm dhe i papërsëritshëm. Mundëson linja të lira, ekspresive, nuanca të pasura dhe tekstura unike.

► A e dini se...

Grafikat me tirazh nënshkruhen në mënyrë standarde për të shënuar autorësinë dhe numrin e printit. Nënshkrimi dhe viti vendosen zakonisht poshtë djathtas, ndërsa numri i serisë (tirazhi) poshtë majtas, p.sh. "3/50", që do të thotë printi i tretë nga 50 gjithsej. Kjo praktikë bën që çdo print të konsiderohet origjinal dhe të identifikohet brenda serisë.



▲ Edgar Dega, "Tre balerina", 1878

- **Kolagrafi** – shtypje nga një pllakë e ndërtuar me materiale të ngjitura që krijojnë relief dhe teksturë.
- **Shtypje digjitale** – përdorimi i kompjuterit ose softuerit digjital për krijimin dhe shtypjen e veprave grafike.



▲ Uejd Gajton, "Seria X", nga viti 2005



▲ Meri Franç, "Hëna e korres", 2011

Këto teknika përdoren në grafikën artistike, në dizajn dhe ilustrim, duke mundësuar kontroll më të madh mbi vijën, tonin, teksturën dhe procesin e riprodhimit të veprave.

Pyetje

1. Cilat janë teknikat grafike bazë?
2. Cili është dallimi midis shtypjes së lartë dhe asaj të thellë?
3. Cilat materiale përdoren për litografi?
4. Çfarë është monotipia dhe si ndryshon nga teknikat e tjera?
5. Çfarë efektsh mundëson serigrafia?
6. Çfarë është seria grafike ose tirazhi?

TEKNIKAT E SKULPTURËS

Hyrje

Skulptura është formë e artit pamor në të cilën artisti krijon vepra tredimensionale, pra skulptura, duke përdorur materiale të ndryshme si gur, dru, metal, baltë, si dhe materiale bashkëkohore – rrëshirë dhe plastikë.

Veprat skulpturore mund të jenë të lira në hapësirë, që qëndrojnë të pavarura në mjedis, si “Mendimtari” i Rodenit.

Skulpturat në relief ngrihen mbi sipërfaqen e sfondit dhe ndahen në relief të ulët, të mesëm dhe të lartë, ku figurat ose motivet janë të dukshme nga një kënd ose krijojnë përshtypjen e thellësisë. Skulpturat monumentale janë vepra të mëdha publike, si “Statuja e Lirisë”, ndërsa skulpturat miniaturale ose bustet paraqesin portrete ose kompozime dekoruese.

Skulptura bashkëkohore shpesh përdor instalacione dhe materiale eksperimentale, duke e integruar skulpturën me hapësirën dhe konceptet bashkëkohore, si në veprat e Xhef Kunsit.

Skulptura synon të shprehë formën, vëllimin, lëvizjen, teksturën dhe emocionin në hapësirën tredimensionale.

Mjetet dhe materialet e skulpturës

Skulptura përdor mjete dhe materiale të ndryshme tradicionale dhe bashkëkohore për krijimin e formave tredimensionale.

Mjetet tradicionale përfshijnë: daltën, çekiçin, gjilpërën dhe spatulën, ndërsa ato bashkëkohore përfshijnë mjete elektrike dhe digjitale, si edhe teknologjitë 3D.

Si materiale përdoren: guri, druri, balta, bronzi dhe gjipsi, por edhe materialet bashkëkohore, si: plastika, rrëshira, silikonin dhe modelet digjitale 3D, të cilat mundësojnë liri më të madhe në shprehje dhe eksperimentim me formën dhe teksturën.

Teknikat e skulpturës

Teknikat e skulpturës janë mënyra të krijimit dhe formësimit të skulpturave në hapësirën tredimensionale. Teknikat më të zakonshme janë:

- **modelimi**, forma ndërtohet duke shtuar material, si balta ose dylli;
- **gdhendja**, forma krijohet duke hequr material, më së shpeshti gur ose dru;

NOCIONE KYÇE

skulpturë, mjete dhe materiale të skulpturës, relief, skulpturë monumentale, bust, vëllim dhe masë, modelim, gdhendje, derdhje, montazh, statikë, kinetikë, ndërhyrje në hapësirë

► A e dini se...

Konstantin Brankushi, skulptori i njohur rumun, përdori shpesh teknikën e stilizimit dhe të thjeshtimit të formave, duke i shndërruar objektet e ndërlikuara në linja dhe vëllime të pastra minimaliste, duke krijuar skulptura që edhe sot duken plotësisht bashkëkohore.



▲ Ogyst Roden, “Mendimtari”, 1904
(Paraqet formë të modeluar që më vonë është derdhur në bronz.)



▲ Mikelanxhelo, “Davidi”, 1501–1504
(Paraqet formë të krijuar përmes heqjes së materialit.)



▲ “Nike e Samotrakës”,
skulpturë e lashtë greke

- **derdhja**, materiali i lëngshëm hidhet në kallëp (bronzi, gjipsi, rrëshire);
- **montazhi** (asamblazhi), materialet e ndryshme gërshetohen në një tërësi skulpturore.

AKTIVITET

Modeloni një skulpturë abstrakte prej balte, të frymëzuar nga format organike të Henri Murit ose Konstantin Brankushit. Përqendrohuni te stilizimi, format e thjeshta, vëllimi dhe masa. Më pas diskutoni në grup për zgjedhjen e formave, sipërfaqeve dhe efektin e vëllimit dhe të masës në veprat tuaja.



▲ Anselm Kifer, “Gjuha e zogjve”, 2014

Këto teknika mundësojnë krijimin e vëllimit, masës, teksturës, lëvizjes dhe shprehjes në skulpturë. Skulpturat mund të jenë **statike** – kur vepra është e qetë dhe e fiksuar në hapësirë ose të shfaqin **dinamizëm** dhe **lëvizshmëri** – kur format krijojnë përshtypjen e lëvizjes. Skulpturat kinetike, pra veprat me **kinetikë**, lëvizin dhe reagojnë ndaj forcave të jashtme si era ose sistemet mekanike. Skulptorët bashkëkohorë shpesh krijojnë **instalacione** ose realizojnë **ndërhyrje në hapësirë**, duke e bërë skulpturën pjesë të mjedisit dhe duke ndryshuar perceptimin e hapësirës.

AKTIVITET

Hulumtoni në internet vepra përfaqësuese artistike të periudhave dhe lëvizjeve të ndryshme artistike. Analizoni teknikat që kanë përdorur artistët dhe përgjigjuni pyetjeve rreth veçorive teknike të secilës vepër.



▲ Aleksandër Kalder, "Pa titull", 1942



▲ Isamu Noguçi, "Kubi i kuq", 1968

AKTIVITET

Organizoni një ekspozitë të vogël në klasë ose në hollin e shkollës ku do të prezantoni të gjitha veprat tuaja të krijuara me teknika të ndryshme. Diskutoni për sfidat teknike, ndani përvojat nga puna me materialet dhe mjetet dhe analizoni zgjidhjet e suksesshme të nxënësve të klasës. Më pas organizoni një demonstrim praktik duke paraqitur një teknikë para të tjerëve dhe duke shpjeguar hapat, materialet dhe procedurat.

Pyetje

1. Çfarë paraqet skulptura dhe cilat forma të skulpturave ekzistojnë?
2. Cilat janë dallimet ndërmjet skulpturave të lira në hapësirë dhe skulpturave në reliev?
3. Cilat teknika përdoren për krijimin e veprave skulpturore dhe si dallohen ato?
4. Çfarë e bën një skulpturë të jetë statike, dinamike ose kinetike?
5. Cilat materiale dhe mjete përdoren në skulpturën tradicionale dhe në atë bashkëkohore?

TEMA 3: ARTI NË HAPËSIRË

Arti në hapësirë, nëpërmjet arkitekturës dhe urbanizmit, artit urban dhe ndërhyrjeve të ndryshme artistike, ka ndikim të fuqishëm në mënyrën se si e përjetojmë botën që na rrethon. Ai nuk kufizohet vetëm në krijimin e strukturave funksionale, por merr pjesë aktive në formësimin e përvojave kulturore, shoqërore dhe emocionale të shoqërisë.

Hapësira bëhet bartëse aktive e kuptimit, ndërsa arkitektura, së bashku me ndërhyrjet artistike, përfaqëson formën e shprehjes vizuale që e lidh njeriun me mjedisin dhe me jetën e përditshme. Ato e formësojnë mjedisin e përditshëm duke i shtuar vlerë estetike, funksion dhe mesazh kulturor. Në këtë mënyrë hapësira bëhet vend i përjetimit dhe i ndërveprimit me artin.

Në këtë temë do të mësoni se si arkitektura, urbanizmi dhe arti në hapësirën publike e formësojnë mjedisin në të cilin jetojmë. Do të njiheni me konceptet themelore si forma, funksioni, vëllimi, proporcioni, fasada dhe konstruksioni, si dhe me llojet e ndryshme të objekteve – banesore, publike, sakrale dhe industriale. Do të hulumtoni shembuj të arkitekturës së gjelbër dhe të qëndrueshme, si dhe mënyrat e rregullimit estetik dhe njerëzor të hapësirës. Gjithashtu, do të analizoni artin urban dhe rolin e tij në komunikimin vizual dhe në angazhimin shoqëror. Me anë të analizës, diskutimit dhe punës praktike do të zhvilloni ide, skica dhe propozime vizuale për hapësirat arkitekturore, urbane ose publike, duke zbatuar parimet themelore të dizajnit dhe praktikat bashkëkohore artistike.

Me anë të vëzhgimit dhe analizës së hapësirës zhvillohet ndjenja për estetikën dhe për përdorimin e përgjegjshëm të sipërfaqeve publike. Ndërhyrjet artistike nxisin dialogun dhe mendimin kritik për shoqërinë dhe mjedisin. Kështu, hapësira bëhet skenë aktive për shprehjen bashkëkohore vizuale.

Qëllimet e temës

- Të dalloni format e ndryshme të artit hapësinor.
- Të kuptoni marrëdhënien ndërmjet hapësirës, funksionit dhe estetikës në artin bashkëkohor dhe në arkitekturë.
- Të identifikoni shembuj të arkitekturës bashkëkohore dhe të qëndrueshme, të zhvilloni ndjenjën për organizimin dhe ekuilibrin hapësinor.
- Të konceptoni dhe të paraqisni vizualisht idetë e juaja për një vepër arti në një hapësirë publike ose të imagjinuar, duke përdorur teknikat dhe materialet e ndryshme.
- Të zhvilloni respektin për hapësirën publike dhe format e shprehjes artistike në të, si pjesë të mjedisit kulturor dhe shoqëror.

ARKITEKTURA DHE URBANIZMI

Hapësira, forma dhe funksioni

Arkitektura është arti dhe shkenca e formësimit të hapësirës. **Hapësira** paraqet kategorinë themelore në arkitekturë dhe mund të jetë e hapur ose e mbyllur, publike ose private.

Forma i referohet pamjes vizuale dhe strukturës së objektit, ndërsa **funksioni** përcakton qëllimin dhe përdorimin e tij. Arkitektura e suksesshme vendos ekuilibër ndërmjet formës dhe funksionit, ku zgjidhjet estetike harmonizohen me nevojat praktike të përdoruesve. Arkitektura nuk përjetohet vetëm vizualisht, por edhe nëpërmjet lëvizjes në kohë dhe hapësirë. Prandaj, kuptimi i plotë i hapësirës arkitekturore është i mundur vetëm me përjetim të drejtpërdrejtë fizik, e jo vetëm nëpërmjet imazheve dhe tekstit.

NOCIONET KYÇE

arkitekturë, urbanizëm, hapësirë, formë, funksion, vëllim, proporcion, objekt banesor, objekt publik, objekt sakral, objekt industrial, konstruksion, fasadë, rregullim urban, plan, projekt, eksterier, enterier, arkitekturë e gjelbër, arkitekturë e qëndrueshme



◀ Zaha Hadid,
MAXXI – Muzeu Kombëtar
i Arteve të Shekullit XXI,
Romë, Itali, 2010

Vëllimi dhe proporcioni

Vëllimi përcakton tredimensionalitetin e objektit arkitekturor, ndërsa **proporcioni** rregullon marrëdhëniet ndërmjet pjesëve të tij. Me përdorimin e drejtë të proporcioneve, arkitektura mund të krijojë ndjenjë harmonie, qëndrueshmërie ose dinamizmi. Historikisht, proporcionet kanë qenë të lidhura me parimet matematikore dhe gjeometrike, por në arkitekturën bashkëkohore shpesh janë eksperimentale dhe konceptuale.

▶ A e dini se...

Zaha Hadidi është një nga arkitektet më të rëndësishme bashkëkohore, e njohur për format e saj fluide, dinamike dhe për qasjen eksperimentale ndaj hapësirës. Arkitektura e saj e zbeh kufirin ndërmjet enterierit dhe eksterierit, duke krijuar përshtypjen e lëvizjes dhe të vazhdimësisë.



◀ Partenoni,
Athinë, Greqi, shek. V p.e.s.



◀ Frank Gehry,
Muzeu Guggenheim Bilbao,
Bilbao, Spanjë, 1997

Objektet arkitekturore

Llojet e objekteve

Në arkitekturë, objektet mund të klasifikohen sipas funksionit të tyre. Llojet më të zakonshme janë:

- **Objektet banesore** – objekte të paracaktuara për banim, si: shtëpitë, ndërtesat e banimit, vilat dhe apartamentet.
- **Objektet publike** – objekte për përdorim publik, si: shkollat, bibliotekat, muzetë, galeritë e artit, teatrot, sallat e koncerteve, sallat e sporteve, stadiumet, institucionet shëndetësore dhe ndërtesat administrative.
- **Objektet sakrale** – objekte me funksion fetar ose shpirtëror, si: katedralet, kishat, xhamitë, manastiret dhe tempujt.



▲ Xhamia e Larmë, Tetovë, Maqedoni e Veriut, fundi i shek. XV (e rinovuar në vitin 1833 nga Abdurrahman Pasha)



▲ Kisha e "Shën Gjon Teologut" ("Shën Jovan Kanoe"), Ohër, Maqedoni e Veriut, të dhënat arkeologjike sugjerojnë se kisha është ndërtuar në shekullin XIII, para ardhjes së Perandorisë Osmane (periudhë para vitit 1447)

- **Objektet industriale** – objekte për prodhim dhe industri, si: fabrikat, depot dhe komplekset prodhuese.
- **Hapësirat publike dhe elementet urbane** – parqet, sheshet, rrugët dhe skulpturat urbane që kanë funksion arkitekturor dhe estetik.

Çdo lloj objekti ka kërkesa të posaçme hapësinore, funksionale dhe estetike.



▲ Anish Kapur, Porta e Reve, Çikago, ShBA, 2006



▲ "Porta e Reve" është element ikonë i Parkut Milenium në Çikago dhe një shembull i rëndësishëm i skulpturës urbane bashkëkohore me vlerë arkitekturore dhe estetike.

Konstruksioni dhe fasada

Konstruksioni përfaqëson strukturën mbajtëse të objektit dhe është baza e stabilitetit dhe e sigurisë së tij. Ai mund të bëhet prej betoni, çeliku, druri ose materialeve të kombinuara.

Fasada është "lëkura" e jashtme e objektit dhe ka një rol të rëndësishëm vizual dhe simbolik. Ajo komunikon me mjedisin përreth dhe shpesh pasqyron stilin, kohën dhe kontekstin kulturor në të cilin është krijuar objekti.

Instituti i Botës Arabe është objekt publik modern i projektuar nga Zhan Nuveli. Fasada e ndërtesës është mbresëlënëse dhe e pashoqe, e përbërë prej 240 paneleve mekanike me ornamente gjeometrike arabe të cilat rregullojnë automatikisht sasinë e dritës që hyn në enterier. Objekti gërsheton motivet tradicionale me teknologjinë bashkëkohore, ku fasada nuk është vetëm element dekorues, por ka edhe rolin e kontrollit të dritës së diellit dhe të temperaturës.



▲ Zhan Nuvel,
Institut i Botës Arabe, Paris, Francë, 1987

Hapësira publike dhe rregullimi urban

Hapësira publike përfshin sheshet, rrugët, parqet dhe sipërfaqet e hapura, të qasshme për të gjithë. Ajo është vend për ndërveprim shoqëror, ngjarje kulturore dhe aktivitete të përditshme. Arti në hapësirë e pasuron mjedisin urban dhe nxit ndjenjën e bashkësisë nëpërmjet skulpturave, instalacioneve dhe zgjidhjeve arkitekturore.

AKTIVITET

Hulumtoni shembuj të ndërtimeve moderne dhe bashkëkohore arkitekturore në botë dhe në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Zgjidhni një objekt arkitekturor që ju duket interesant dhe bëni një hulumtim të shkurtër në internet: cili është autori, kur është ndërtuar dhe cila është ideja që qëndron pas dizajnit të tij.

Paraqitini rezultatet e hulumtimit me fotografi dhe/ose skica, pastaj diskutoni se si ky objekt ndikon te njerëzit dhe në hapësirën përreth.

Rregullimi urban i referohet planifikimit dhe organizimit të hapësirës së qytetit. Ai përfshin qarkullimin rrugor, sipërfaqet e gjelbra, infrastrukturën dhe shpërndarjen e objekteve. Një hapësirë urbane e rregulluar mirë mundëson një jetë funksionale, të sigurt dhe të këndshme në aspekt estetik.

Plani, projekti, eksterieri dhe enterieri

Plani dhe **projekti** janë baza e çdo vepre arkitekturore. Plani paraqet organizimin e hapësirës, ndërsa projekti përfshin idenë e përgjithshme, konstruksionin dhe zgjidhjen vizuale.

Eksterieri i referohet pamjes së jashtme të objektit dhe marrëdhënies së tij me mjedisin përreth, ndërsa **enterieri** formëson hapësirën e brendshme, duke ndikuar në komoditetin, atmosferën dhe funksionalitetin e saj.



▲ Lë Korbizje dhe Pjer Zhanere, "Vila Savoye", Paris, Francë, 1928–1931



Arkitektura e gjelbër dhe e qëndrueshme

Arkitektura e gjelbër synon të zvogëlojë ndikimin negativ në mjedis duke përdorur zgjidhje energjetike efikase, materiale natyrore dhe burime të ripërtëritshme të energjisë.

Arkitektura e qëndrueshme mendon në afat të gjatë, duke krijuar objekte që janë të përshtatshme, ekologjike dhe të arsyeshme në aspekt ekonomik. Ajo lidh artin, teknologjinë dhe përgjegjësinë ndaj natyrës.



Studio Boeri, "Pylli vertikal", Milano, Itali, 2014

AKTIVITET

Krijoni një vizatim ose një skicë digjitale për instalacionin tuaj artistik në një hapësirë publike. Zgjidhni vendin e duhur në qytetin tuaj (shesh, park, rrugë ose oborr) dhe mendoni se si do ta transformoni me ndihmën e ngjyrës, formës ose një materiali të pazakontë. Mund të punoni me teknika të kombinuara artistike sipas zgjedhjes suaj ose me një aplikacion digjital.

Pyetje

1. Çfarë paraqet arkitektura?
2. Si mund të klasifikohet hapësira në arkitekturë?
3. Çfarë nënkupton funksioni i një objekti arkitekturor?
4. Cilat janë llojet më të zakonshme të objekteve arkitekturore?
5. Çfarë është hapësira publike dhe pse është e rëndësishme për qytetin?

ARTI URBAN

NOCIONET KYÇE

art urban, grafitë, murale, art i rrugës (street art), shabllon, simbol, kompozim, ngjyrë, ritëm, hapësirë publike, mesazh, vandalizëm

Arti urban është një formë dinamike dhe inovative e shprehjes vizuale që lidh artin, hapësirën dhe shoqërinë. Ky art ekziston që nga Roma e lashtë dhe u popularizua përsëri në vitet 1960 në Nju-Jork.

Ai përfshin format e ndryshme si grafitet, muralet dhe llojet e tjera të artit të rrugës. Arti urban nuk është vetëm një dukuri estetike, por shpesh bart edhe angazhimin shoqëror, simbolikën dhe identitetin personal ose të përbashkët. Me anë të grafitëve, muraleve dhe artit të rrugës, artistët krijojnë vepra që ndikojnë në perceptimin e hapësirës publike dhe nxisin reflektimin e kalimtarëve.

Grafitet, muralet dhe arti i rrugës

► A e dini se...

Shumë artistë të artit të rrugës mbeten anonimë, ndërsa veprat e tyre njihen ndërkombëtarisht dhe vlerësohen shumë. Shembulli më i njohur është Banksi, identiteti i të cilit nuk është konfirmuar zyrtarisht, por veprat e tij shiten për miliona dhe shpesh mbajnë mesazhe të forta sociale dhe politike.

Ky fakt tregon se në artin urban, mesazhi dhe ndikimi në hapësirën publike janë më të rëndësishme se autorësia dhe njohja institucionale, duke e bërë këtë art veçanërisht të fuqishëm dhe të drejtpërdrejtë.

Grafitet janë formë e shprehjes vizuale në hapësirën publike, zakonisht të realizuara me sprej, markerë ose ngjyrë në mure, objekte dhe sipërfaqe urbane. Ato mund të përmbajnë tekst, simbole, nënshkrime (tage) ose imazhe dhe përcjellin mesazh vizual. Bëhet fjalë për krijimtari individuale ose grupe.

Edhe pse tradicionalisht konsiderohen si formë e paligjshme e shprehjes e realizuar jashtë kornizave institucionale, grafitet kanë një rol të rëndësishëm në zhvillimin e kulturës bashkëkohore urbane dhe të komunikimit vizual.



▲ Banksi, "Vajza me tullumbace", 2002

Muralet janë vepra të mëdha piktorike në mure dhe fasada në hapësirën publike. Ato zakonisht porositen nga institucionet, organizatat ose komunitetet, për të zbukuruar hapësirën ose për të përcjellë një porosi. Muralet mund të trajtojnë tema kulturore, historike, sociale ose mjedisore. Me përdorimin e ngjyrës, formës dhe kompozicionit, ato ndryshojnë pamjen dhe përjetimin e mjedisit urban dhe nxisin reflektimin e publikut.



◀ Kith Haring,
"Ne, të rinjtë", 1987

Arti i rrugës (street art) është term më i gjerë që përfshin grafitet, muralet, ngjitëset (stickers), shabllonet (stencils) dhe ndërhyrjet e tjera vizuale në hapësirën publike. Ai shpesh i tejkalon kufijtë e artit tradicional dhe dialogon me njerëzit dhe mjedisin. Zakonisht vendoset qëllimisht në hapësirën urbane për të komunikuar me kalimtarët.



◀ Xhej Ar, "Gratë janë heroina", 2008–2009

Shabllone dhe simbole

Shablloni është teknikë në artin e rrugës, ku motivi pritët në letër, karton, plastikë ose material tjetër, dhe më pas ngjyra aplikohet nëpërmjet tij. Kjo teknikë mundëson krijimin e shpejtë, të saktë dhe të përsëritshëm të të njëjtit motiv në vende të ndryshme. Shpesh përdoret për përcjelljen e simboleve dhe mesazheve të qarta me efekt të fortë vizual dhe shoqëror.



▲ Banksy, "Hedhësi i luleve", Jerusalemi, 2003



▲ Zhan-Michel Baskia, simboli i kurorës

Simboli paraqet shenjë vizuale, formë ose imazh që përfaqëson një ide, ndjenjë ose mesazh pa e paraqitur drejtpërdrejt. Simbolet në artin urban dhe në grafitet zakonisht janë të thjeshta dhe dallohen lehtësisht, në mënyrë që mesazhi të kuptohet shpejt.

Kurora, për shembull, është një nga simbolet më të njohura në grafitet dhe në artin urban të Zhan-Michel Baskia. Ajo më së shpeshti paraqitet me tri maja, vizatohet në mënyrë spontane si shenjë ose tag.

Kompozicioni, ngjyra dhe ritmi

Kompozicioni i referohet renditjes së elementeve vizuale – vijave, formave, simboleve, tekstit dhe imazheve – në një vepër arti. Kompozicioni i mirë krijon zgjidhje vizuale harmonike dhe të qartë që tërheq vëmendjen dhe përcjell mesazhin.

Ngjyra ka ndikim të madh në ndjenja dhe në perceptim. Kontrasti i ngjyrave e thekson mesazhin, ndërsa gërshetimi i nuancave të ngjashme krijon harmoni. Në artin urban, ngjyra përdoret shpesh për ta bërë veprën të dukshme nga larg dhe për të tërhequr vëmendjen e kalimtarëve.

Ritmi është përsëritja ose variacioni i elementeve, si: vijat, format dhe ngjyrat. Ai krijon ndjenjë lëvizjeje, dinamikë dhe energji vizuale. Kjo është veçanërisht e rëndësishme në hapësirën urbane.

AKTIVITET

Zgjidhni një hapësirë në shkollën tuaj dhe imagjinoni si do të dukej me një ndërhyrje artistike. Krijoni një vizatim ose skicë për grafit, mural ose ndërhyrje tjetër. Përdorni ngjyrë, simbole dhe kompozicion për të përcjellë një mesazh të rëndësishëm për ty. Pas përfundimit, prezantoni idenë tuaj shkurtimisht dhe shpjegoni pse e zgjodhët këtë mesazh dhe këtë hapësirë.

Hapësira publike dhe mesazhi

Arti urban e përdor mjedisin e qytetit si kanavacë. Ai i transformon sipërfaqet e ndryshme urbane në pika vizuale interesante, duke e pasuruar jetën e përditshme të njerëzve.

Shumë artistë e përdorin artin urban për të përcjellë mesazhe personale, sociale, kulturore ose politike. Mesazhi mund të jetë i drejtpërdrejtë ose simbolik, ndërsa përqendrohet te ndërveprimi midis artit dhe qytetit – si arti e formëson hapësirën dhe si hapësira e formëson artin.

AKTIVITET

Bazuar në skicat e mëparshme për grafit ose mural, realizoni idetë tuaja si ndërhyrje artistike në hapësirën shkollore. Krijoni së bashku një mural të madh ose kolazh në fasadë, dritare ose mur – me leje dhe me materiale të përshtatshme.

Dallimi midis vandalizmit dhe ndërhyrjes artistike

Ndonjëherë arti urban mund të ngatërrohet me vandalizmin, por ekziston një dallim i rëndësishëm:

- **Vandalizmi** – dëmtim ose shënim i hapësirës pa leje, pa vlerë artistike ose shoqërore. Ai ndikon negativisht në mjedis.
- **Ndërhyrja artistike** – është veprim i planifikuar dhe kreativ për të përcjellë një mesazh ose vlerë estetike, në përputhje me hapësirën dhe interesin publik.

Pyetje

1. Çfarë është arti urban dhe cilat forma i përfshin?
2. Cili është dallimi midis grafitëve dhe muraleve?
3. Si përdoret shablloni në artin e rrugës dhe cili është qëllimi i tij?
4. Pse janë të rëndësishme ngjyra, kompozicioni dhe ritmi në artin urban?
5. Si ndikon arti urban në hapësirën publike dhe në komunikimin me njerëzit?

NDËRHJRJA NË HAPËSIRË

NOCIONET KYÇE

ndërhjrje në hapësirë, instalacion, kontekst, ide artistike, hapësirë publike, art i kushtëzuar nga vendi (site-specific art), kompozim hapësinor, ndërveprim, aktivizëm dhe koment social

Ndërhjrja në hapësirë është një nga format më dinamike të shprehjes në artin bashkëkohor. Ajo del jashtë galerive dhe muzeve tradicionale dhe shfaqet në hapësira të ndryshme, si në rrugë, vende publike ose situata të përditshme. Ndërhjrja artistike nxit të menduarit, dialogun dhe interpretimet e reja të realitetit nëpërmjet instalacioneve të përkohshme ose të përhershme, performancave ose aktiviteteve ku merr pjesë publiku.

Edhe pse ndërhjrrjet artistike lidhen kryesisht me artin bashkëkohor, rrënjët e tyre gjenden në lëvizjet pararojë të fillimit të shekullit XX, si dadaizmi dhe surrealizmi. Me veprën “Shatërvani”, Marsel Dyshampi vuri në pikëpyetje konceptin tradicional të artit, duke theksuar rëndësinë e kontekstit. Në vitet 1960 dhe 1970, me zhvillimin e artit konceptual, të performancës dhe land artit, artistët filluan të ndërhjrrjnë në mënyrë aktive në hapësirat publike dhe të përdorin artin si mjet për koment social dhe politik. Kjo qasje është baza e ndërhjrrjeve artistike siç i njohim sot.

Veçoritë kryesore të ndërhjrrjes artistike

- **Art i kushtëzuar nga hapësira (site-specific) dhe lidhshmëria kontekstuale**

Ndërhjrrjet artistike janë të lidhura ngushtë me hapësirën ose kontekstin ku shfaqen. Artistët zgjedhin vende me rëndësi sociale, politike ose kulturore dhe e përdorin hapësirën si pjesë të veprës.

- **Karakter i përhershëm dhe i përkohshëm**

Ndërhjrrjet artistike mund të jenë të përhershme ose të përkohshme dhe afatshkurtra. Ndërhjrrjet e përkohshme shpesh shfaqen papritur dhe zhduken pa paralajmërim. Pikërisht kjo përkohshmëri e forcon mesazhin e tyre, sepse krijon një moment të shkurtër, por të fuqishëm reflektimi, përpara se hapësira të kthehet në gjendjen e saj të zakonshme.

- **Aktivizëm dhe koment social**

Ndërhjrrjet shpesh trajtojnë tema sociale dhe politike. Artistët trajtojnë nëpërmjet hapësirës publike çështje si ekologjia, pabarazia dhe padrejtësitë shoqërore, duke e kthyer artin në kritikë dhe thirrje për ndryshim.

- **Pjesëmarrja e publikut**

Shumë ndërhyrje e përfshijnë publikun në mënyrë të vetëdijshme ose të pavetëdijshme. Me vetë praninë ose reagimin e tyre, shikuesit bëhen pjesë e veprës artistike, duke u zbehur kufijtë mes artistit, veprës dhe publikut.

- **Shkelja e normave**

Shkelja e rregullave dhe e pritshmërive të zakonshme është pjesë thelbësore e ndërhyrjes artistike. Pavarësisht nëse bëhet fjalë për hapësirë publike, institucion kulturor ose sistem shoqëror, ndërhyrja i vë në pikëpyetje normat ekzistuese dhe i nxit shikuesit të mendojnë në mënyrë kritike për mjedisin ku jetojnë.

Shembuj të rëndësishëm të ndërhyrjes artistike

Disa ndërhyrje të rëndësishme artistike kanë lënë gjurmë të qëndrueshme në artin bashkëkohor. Ato tregojnë se si arti mund të ndryshojë hapësirën, të nxisë reflektim dhe të trajtojë çështje të rëndësishme shoqërore. Më poshtë janë disa shembuj të njohur:



◀ Vajzat Guerile, "A duhet gratë të jenë të zhveshura për të hyrë në Muzeun 'Metropolitan'?", Nju-Jork, 1989



◀ Benksi, "Rinoceronti", 2004



▲ Riçard Serra, "Lindje dhe perëndim", Katar, 2014



▲ Kristo dhe Zhan-Klod, "Urat lundruese", Liqeni Iseo, Itali, 2016



▲ Anish Kapur, "Copëtim / Shpërbërje, Lokacioni 1", Zelanda e re, 2009



▲ Kristo dhe Zhan-Klod, "Raihstagu i mbështjellë" (Parlamenti gjerman i mbështjellë), Berlin, Gjermani, 1971–1995

▼ Olafur Eliasson, "Raja e Akullit", Kopenhagë (2014), Paris (2015) dhe Londër (2018), njëkohësisht me konferencat e mëdha për klimën Instalacioni i fuqishëm i kushtëzuar nga hapësira (site-specific), i krijuar në bashkëpunim me gjeologun Minik Rosingun, i përbërë prej blloqeve masive të akullit nga Grenlanda, të vendosura në hapësira publike urbane për t'u shkrirë gradualisht, duke e bërë të dukshëm dhe të prekshëm realitetin e ndryshimeve klimatike.





▲ Fransis Alis, "Paradoksi i praktikës I (Ndonjëherë krijimi i diçkaje çon në asgjë)", Meksiko Siti, Meksikë, 1997



AKTIVITET

Hulumtoni dhe mësoni më shumë për artistët dhe veprat e përmendura më sipër. Ndahuni në grupe të vogla, analizoni një ndërhyrje artistike sipas roleve (vendi, materialet, mesazhi) dhe bëni një prezantim të shkurtër ose poster, duke diskutuar se si vepra e ndryshon përjetimin e hapësirës dhe e nxit mendimin kritik për çështjet sociale, politike dhe kulturore.



◀ Sisley Xhafa, "Y", Çyrih, Zvicër, 2011

► A e dini se...

"Shitja e topave të borës" është një performancë në hapësirën publike në Nju-Jork, ku artisti Dejvid Hamonsi u shiste topa bore kalimtarëve. Ky veprim nxit publikun të mendojë për vlerën dhe komercializimin, duke treguar se si arti mund të ndryshojë mënyrën e përjetimit të hapësirës.

Pyetje

1. Çfarë është ndërhyrja në hapësirë dhe si ndryshon ajo nga arti në galeri?
2. Çfarë do të thotë arti i kushtëzuar nga hapësira (site-specific art)?
3. Pse shumë ndërhyrje janë të përkohshme dhe si e forcon kjo mesazhin e tyre?
4. Si e përdorin artistët komentimin social ose aktivizmin nëpërmjet ndërhyrjeve artistike?
5. Si merr pjesë publiku në ndërhyrjet artistike dhe si e ndryshon kjo hapësirën?

TEMA 4: DIZAJNI, KOMUNIKIMI VIZUAL DHE ARTI DIGJITAL

Përvoja vizuale luan rol kyç në mënyrën se si njerëzit mësojnë, e kuptojnë botën dhe reagojnë ndaj mjedisit. Që nga kohët më të hershme, shumë kohë para shfaqjes së gjuhës së shkruar, njerëzit kanë përdorur imazhe dhe simbole për të shprehur idetë e tyre dhe për të transmetuar informacione.

Sot, mesazhet vizuale janë të pranishme kudo – në art, dizajn, arkitekturë, reklama dhe në mediat digjitale, duke ndikuar në perceptimin tonë, në vendimet dhe në sjelljen e përditshme.

Prandaj, kuptimi i gjuhës vizuale na ndihmon të analizojmë imazhet në mënyrë kritike, të kuptojmë domethënien e tyre dhe të zhvillojmë qëndrimin tonë ndaj kulturës vizuale.

Studimi i përvojës vizuale e zhvillon aftësinë për vëzhgim, mendim krijues dhe analizë. Arti dhe dizajni lidhin funksionin me estetikën dhe tregojnë se si elementet vizuale mund të transmetojnë mesazhe dhe të ndikojnë tek individit dhe shoqëria.

Në këtë temë do të njiheni me llojet e ndryshme të dizajnit, si ai grafik, industrial, dizajni i tekstit dhe i modës, dizajni i enterierit dhe dizajni digjital – me funksionet, veçoritë vizuale dhe zbatimin e tyre në kontekstin e përditshëm dhe në atë kulturor. Do të mësoni si të dalloni shenjat, simbolet dhe mesazhet vizuale, si dhe do të njiheni me rolin e fotografisë dhe mediave digjitale si mjete komunikimi dhe shprehjeje artistike. Gjithashtu, do të zhvilloni ide dhe skica duke gërshtuar formën, ngjyrën, kompozicionin dhe funksionalitetin për të krijuar zgjidhjet tuaja vizuale.

Komunikimi vizual ndërton markë, transmeton vlera kulturore dhe lehtëson komunikimin mes gjuhëve dhe kulturave të ndryshme. Prandaj, të kuptuarit e shenjave, simboleve, ngjyrave dhe gjuhës pamore është thelbësor për këdo që merret me art, dizajn dhe media vizuale.

Qëllimet e temës

- Të kuptoni rolin dhe rëndësinë e dizajnit, komunikimit vizual dhe shprehjes multimediale sot.
- Të dalloni llojet dhe veçoritë e dizajnit, komunikimit vizual, shprehjeve digjitale dhe multimediale dhe të vëreni vlerat e tyre artistike dhe estetike.
- Të kuptoni rëndësinë e mediave vizuale sot dhe veçoritë e tyre bazë.
- Të zhvilloni aftësitë dhe shprehjet krijuese duke përdorur mjete tradicionale ose teknologji moderne në krijimin e zgjidhjeve tuaja ideore gjatë shprehjes multimediale dhe vizuale.

LLOJET E DIZAJNIT

Dizajni është pjesë përbërëse e kulturës dhe e jetës bashkëkohore. Ai lidh artin, teknologjinë dhe nevojat e njeriut, duke krijuar zgjidhje që janë funksionale, të kuptueshme dhe tërheqëse në aspekt vizual. Njohja me llojet e dizajnit, funksionet dhe vlerat e tyre na mundëson të kuptojmë mjedisin vizual dhe të marrim pjesë në mënyrë aktive në formësimin e tij.

Llojet e dizajnit janë: **dizajni grafik, dizajni industrial, dizajni i tekstilit dhe modës, dizajni i enterierit** dhe ai **digjital**. Ato dallohen sipas funksionit, përdorimit dhe veçorive vizuale.

NOCIONET KYÇE

dizajn, dizajn grafik, identitet vizual, logo, ilustrim, tipografi, font, dizajn industrial, dizajn tekstili dhe mode, motiv dekorues (dezeen), kostumografi, ornament, dizajn skenik, vlerë funksionale dhe estetike

Dizajni Grafik


Dizajni grafik është proces i krijimit të përmbajtjeve vizuale me anë të imazheve, tipografisë, elementeve figurative, parimeve të dizajnit, programeve grafike dhe mjeteve digjitale, për të transmetuar mesazhe, zgjidhur probleme dhe shkaktuar ndikim emocional. Në epokën digjitale, dizajni grafik është i pranishëm në faqet e internetit, rrjetet sociale dhe platformat interaktive.

Llojet e dizajnit grafik janë të ndryshme dhe pasqyrojnë mënyrën se si përmbajtja vizuale mund të informojë, të komunikojë dhe të frymëzojë. Secili lloj kërkon njohuri teknike dhe aftësi krijuese të veçanta, të përshtatura me mediumin dhe qëllimin e dizajnit.

Llojet e dizajnit grafik

- **Dizajni i identitetit vizual** – përfshin logot, kartëvizitat, letrat zyrtare, zarfet, posterat, broshurat, reklamat, faqet e internetit, banderolat dhe përmbajtjet për rrjete sociale. Këtu qëllimi ndërlidhet me dallueshmërinë dhe qëndrueshmërinë e markës në të gjitha materialet vizuale. Pol Randi është një nga dizajnerët më me ndikim të shekullit XX, i njohur për logot e tij të thjeshta dhe konceptuale, si dhe për bashkimin e modernizmit me komunikimin vizual.

Disa nga logot më të njohura të Pol Randit dallohen për thjeshtësinë, formën e qartë dhe identitetin e fortë vizual.



Anri Matis, kopertina e librit "Jazz", 1947



- **Dizajni grafik për publikime** – përdoret për libra, revista dhe publikime digjitale. Ai ka të bëjë me krijimin e kompozimeve që organizojnë tekstin dhe imazhet në mënyrë interesante dhe të lexueshme. Për këtë është e rëndësishme njohja e mirë e kompozicionit dhe e tipografisë.



"Neue Grafik", faqja balllore e revistës, 1958



"Neue Grafik", faqe të brendshme të revistës

- **Dizajni grafik për marketing dhe reklamim** – përqendrohet në përmbajtjet vizuale për promovimin e ngjarjeve, produkteve, shërbimeve ose markave. Qëllimi kryesor është të tërheqë vëmendjen e publikut, të përcjellë mesazh të qartë dhe të nxisë veprim (për shembull, pjesëmarrje në një ngjarje, blerje ose vizitë në një faqe interneti). Ky lloj dizajni përfshin posterat, banderolat, broshurat, reklamat digjitale, përmbajtjet për rrjetet sociale, ambalazhet dhe infografikën.



▲ Dejvid Karson, kopertina e revistës "Ray Gun", 1998



▲ Masimo Vinjeli, Harta e Metroës së Nju Jorkut, 1972



▲ Otl Aiher, piktogramet për Lojërat Olimpike në Mynih, 1972



▲ Pol Rand, "Eye Bee M" (poster për IBM), 1981




▲ Milton Glejzer, "Dylan", poster, 1966

- **Dizajni grafik i ambalazhit** – ka të bëjë me zgjidhjet vizuale që mbrojnë dhe promovojnë produktin. Dizajnuesit i marrin parasysh materialet, formën dhe etiketat, në mënyrë që ambalazhi të jetë tërheqës dhe të përcjellë mesazh të qartë te konsumatorët.
- **Dizajni grafik për faqe interneti dhe media digjitale** – ka të bëjë me zgjidhjet vizuale për faqe interneti, aplikacione dhe ndërfaqe digjitale, duke u përqendruar në funksionalitetin, qartësinë dhe përvojën e përdoruesit.

Ilustrimi në dizajnin grafik

Ilustrimi paraqet dekorim, interpretim ose shpjegim vizual të tekstit, idesë ose procesit, për përdorim në media të shtypura dhe digjitale, si: posterat, fletushkat, revistat, librat, materialet mësimore, animacionet, videolojërat dhe filmat. Ilustrimet e bëjnë tekstin më të kuptueshëm dhe më tërheqës në aspekt vizual.



Milton Glejzer,
poster për "Mad Men", 2014

AKTIVITET

Ndahuni në grupe dhe shqyrtoni zgjidhjet tuaja pamore, si dhe të tjerëve.

Analizoni gojarisht ose me shkrim shembuj të dizajnit në jetën e përditshme – posterë, logo, ambalazhe, reklama dhe media digjitale.

Mendoni se çfarë i bën këta shembuj tërheqës në aspekt vizual dhe cilët elemente kontribuojnë që ata të jenë funksionalë dhe komunikues. Së bashku përcaktoni kriteret për vlerësimin e dizajnit dhe të krijimeve multimediale.

Rezultatet paraqitini në një tabelë të përbashkët, me kolona të veçanta për vlerat figurative (ngjyra, kompozicioni, kontrasti, forma), vlerat estetike (harmonia, shprehja, origjinaliteti) dhe vlerat funksionale.

Tipografia në dizajnin grafik

Tipografia është pjesë e rëndësishme e dizajnit grafik dhe ka të bëjë me formësimin dhe përdorimin e shkronjave që teksti të jetë i lexueshëm, i qartë dhe tërheqës në aspekt vizual. Këtu përfshihet përzgjedhja e fontit, madhësia e shkronjave, hapësira ndërmjet shkronjave, fjalëve dhe rreshtave, për të përcjellë mesazhin ose ndikimin emocional.

Në tipografi, **fonti** është stil dhe paraqitje e caktuar e shkronjave (p.sh. Arial, Times New Roman, Helvetica). Një font mund të ketë të njëjtin dizajn, por stile dhe trashësi të ndryshme, si p.sh. i rregullt (regular), i trashë (bold) dhe kursiv (italic), të cilat mundësojnë përdorim tipografik të qëndrueshëm dhe të përshtatshëm në dizajn.

Llojet kryesore të fonteve janë: fonte **me serife** (serif), **pa serife** (sans serif), **skript** (script, që imitojnë shkrimin me dorë), **dekoruese** (display) dhe fonte **me hapësirë të njëjtë** (monospace). Dallohen sipas formës, lexueshmërisë dhe përdorimit në tipografi dhe dizajn. Tipografia është thelbësore në dizajnin e publikimeve, reklamave, identiteteve vizuale dhe mediave digjitale.

Për shembull, **Helvetica** është font pa serife, i krijuar në vitin 1957 në Zvicër, i njohur për formën e pastër, neutrale dhe lehtësisht të lexueshme. Për këtë arsye, ai është një nga fontet më të përdorura në dizajnin grafik, ueb dizajnin, identitetin vizual dhe sinjalistikën publike.

Helvetica

Helvetica Neue 25 Ultra Light

Helvetica Neue 35 Thin

Helvetica Neue 45 Light

Helvetica Neue 55 Roman

Helvetica Neue 65 Medium

Helvetica Neue 75 Bold

Helvetica Neue 85 Heavy

Helvetica Neue 95 Black

Aftësitë dhe mjetet në dizajnin grafik bashkëkohor

Dizajnerët grafikë bashkëkohorë kombinojnë krijimtarinë dhe teknologjinë. Ata përdorin aftësitë, si: përpunimin e fotografive, tipografinë, ilustrimin, animacionin dhe ueb dizajnin për të krijuar zgjidhje vizuale efektive.

Mjetet dhe programet e përdorura më së shpeshti:

- Adobe Photoshop – përpunim fotografish dhe imazhesh të tjera
- Adobe Illustrator – grafikë vektoriale dhe ilustrime
- Adobe InDesign – publikime, broshura dhe libra
- Canva – dizajn i thjeshtë online
- After Effects – animacion dhe video
- Figma – dizajn i faqeve të internetit, aplikacioneve dhe ndërfaqeve me mundësi bashkëpunimi në kohë reale
- Mjete për ueb dizajn dhe projekte interaktive

Këto mjete u ndihmojnë dizajnerëve të shndërrojnë konceptet vizuale në përvoja konkrete dhe kuptimplota.

Dizajni industrial



▲ Xhorxh Karurdin, llamba "Anglepoise", një nga simbolet më të njohura të dizajnit industrial britanik, 1932



▲ Laslo Biro, stilolapsi kimik "BIC Cristal", ikonë e dizajnit industrial, i konceptuar nga Laslo Biro dhe i hedhur në tregun e gjerë nga Marsel Bishi dhe Eduar Bufari në vitin 1950



▲ Kashta fleksibile për pije, shembull i përsosur i dizajnit të orientuar drejt përdoruesit, u shpik në vitin 1937 nga Xhozef Fridmani. Sot, ai është bërë ikonë që tregon se si inovacionet e thjeshta mund të depërtojnë në tregjet globale dhe të bëhen pjesë e përditshmërisë.



▲ Karrigia "Brno", e dizajnuar nga arkitekti modernist Ludwig Mais van der Rohu në vitet 1929–1930, është shembull i parimit të Bauhausit për reduktimin e objekteve në elementet e tyre bazë. Dizajni bazohet në idenë se nuk është e nevojshme që karrigia të ketë katër këmbë, por mund të realizohet si strukturë konzolare (mbështetet vetëm në një anë), duke përdorur një shufër metalike në formë C që mban të gjithë sipërfaqen e uljes.

► A e dini se...

Laslo Biro me krijimin e stilolapsit kimik "BIC" në vitin 1950 realizoi një nga produktet më të prodhuara dhe më të njohura në botë.

Dizajni i tekstit dhe modës

Dizajni i tekstit është art dhe dizajn i aplikuar në pëlhurë përmes motiveve, teksturave, ngjyrave dhe teknikave të ndryshme të punimit. Ai realizohet përmes:

- **shtypjes**, ku përdoren ngjyra dhe motive në sipërfaqe;
- **thurjes**, ku krijohen modele përmes ndërthurjes së fijeve vertikale dhe horizontale;
- **teknikave të përziera**, si qëndisja, palosja (plisimi), aplikacionet, qepja me arna (quilting) dhe prerja me laser, të cilat shtojnë relief, teksturë dhe originalitet.

Motivi dekorues (dezeni) është një motiv ose një skemë që përsëritet në një sipërfaqe të caktuar dhe përdoret në tekstil, veshje, mobilje dhe dizajn grafik. Ai jep strukturë vizuale dhe estetikë dhe mund të jetë gjeometrik, floral, abstrakt ose tematik, në varësi të funksionit dhe stilit të dizajnit.



Dizajni i modës është proces krijues i konceptimit dhe krijimit të veshjeve, aksesorëve dhe këpucëve, duke lidhur artin, kulturën, funksionalitetin dhe estetikën. Ai përfshin zhvillimin e ideve nga koncepti fillestar dhe skicat deri te produkti final që pasqyron stilin, identitetin dhe trendet shoqërore.

Dizajni i modës përfshin:

- zhvillimin e konceptit – frymëzim nga arti, historia, kultura ose jeta bashkëkohore
- skicimin dhe ilustrimin – vizualizimi i ideve të dizajnit
- përzgjedhjen e tekstitit dhe materialeve – pëlhura, ngjyra dhe tekstura
- prerjen dhe ndërtimin – shndërrimi i dizajnit në formë të gatshme për t'u veshur e mbathur
- ndjekjen e trendeve dhe tregut – përshtatje me ndryshimet shoqërore, kulturore dhe teknologjike.

AKTIVITET

Ndahuni në çifte ose në grupe të vogla. Detyra juaj është të krijoni një zgjidhje ideore për një lloj dizajni. Një grup do të punojë në dizajn grafik (p.sh. logo ose poster), një tjetër në dizajn industrial (objekt për përdorim të përditshëm), një grup në dizajn tekstili (motiv dekorues ose teksturë), ndërsa grupet e tjera mund të zgjedhin dizajn të modës, enterierit ose dizajn digjital.

Pas përfundimit, secili grup do të prezantojë zgjidhjen e tij para klasës dhe do të shpjegojë: për cilin lloj dizajni bëhet fjalë, cili është qëllimi i tij dhe cilat janë veçoritë vizuale dhe funksionale më të rëndësishme. Në fund, shkëmbeni mendime dhe diskutoni për qasjet dhe veçoritë e ndryshme të dizajnit.



Dizajni i modës qëndron në prerjen mes artit dhe industrisë, duke përbushur funksionin estetik dhe praktik, si dhe duke luajtur një rol të rëndësishëm në formësimin e kulturës vizuale dhe identitetit.

Dizajni i tekstitit dhe modës lidh traditën, kulturën dhe trendet bashkëkohore, duke shprehur vlera individuale dhe kolektive.

Kostumografia, dizajni unik, ornamentika dhe punimet artizanale

Kostumografia është disiplinë që merret me konceptimin dhe realizimin e kostumeve për teatër, film, operë, balet, televizion dhe shfaqje të tjera. Ajo luan rol kyç në interpretimin vizual të personazhit, kohës, hapësirës dhe kontekstit.

Kostumografia lidh dizajnin e modës, artet pamore dhe artin skenik. Kostumi shërben si mjet për të shprehur karakterin, statusin shoqëror, gjendjen psikologjike dhe identitetin kulturorohistorik të personazheve.



▲ Produksioni “Mbreti Luan” (The Lion King) në Broduei (Broadway) është i njohur për përdorimin inovativ të mbi 232 kukullave dhe maskave me të cilat ringjallet savana afrikane. I dizajnuar nga Xhuli Tejmor dhe Majkëll Kërri, produksioni përdor teknikën e “veprimit të dyfishtë”, me ç’rast publiku sheh njëkohësisht kukullën dhe aktorin që e manipulon atë.

Dizajni unik është i vetëm, origjinal dhe i papërsëritshëm, i krijuar si vepër autoriale që dallon nga zgjidhjet ekzistuese me anë të idesë, formës, konceptit ose realizimit. Ai lidhet me individualitetin dhe vlerën krijuese, dhe jo me prodhimin e gjerë.

Punimet artizanale janë objekte ose vepra të krijuara me dorë, me mjeshtëri dhe kreativitet, që kanë vlerë artistike, dekoruese ose praktike dhe përfaqësojnë shembuj të pashoq ose të kufizuar të punimit me dorë.

Ornamentika është disiplinë artistike që përdoret për dekorimin e objekteve, sipërfaqeve ose hapësirave me motive, lara, vija dhe forma, për të arritur bukurinë estetike dhe për të nxitur interesin vizual.

Dizajni hapësinor dhe skenik

Dizajni hapësinor dhe skenik ka të bëjë me formësimin e hapësirave për teatër, ekspozita, ngjarje publike dhe enteriere, duke marrë parasysh funksionin e hapësirës, lëvizjen e njerëzve dhe efektin vizual. Ai gërsheton elementet arkitekturore, vizuale dhe skenografike për të krijuar një mjedis funksional, estetik dhe mbresëlënës.

Skenë nga baleti “Liqeni i mjellmave”, i interpretuar nga trupa e baletit klasik në Teatrin RAMT në Moskë, me koreografi nga Natalia Rizhenko dhe Viktor Smirnov-Golovanov, skenografi dhe kostume nga Natalia Pogovo.



Vlerat funksionale dhe estetike

Çdo dizajn ka dy vlera themelore:

- **vlerën funksionale** – sa mirë e përmbush qëllimin e vet një objekt ose zgjidhje vizuale;
- **vlerën estetike** – përfshin tërheqjen vizuale, harmoninë dhe shprehjen artistike.

Dizajni i mirë përfaqëson ekuilibrin midis këtyre dy vlerave.

Pyetje

1. Çfarë është dizajni dhe pse luan rol të rëndësishëm në jetën dhe kulturën bashkëkohore?
2. Cilat janë dallimet kryesore midis dizajnit grafik, industrial dhe të tekstilit?
3. Pse tipografia është element kyç në dizajnin grafik?
4. Si plotësohen vlera funksionale dhe estetike në një dizajn të mirë?
5. Në ç'mënyrë dizajni i modës dhe i tekstilit lidhin traditën me trendet bashkëkohore?

KOMUNIKIMI VIZUAL

Komunikimi vizual është procesi i transmetimit të informacionit, ideve dhe mesazheve nëpërmjet mjeteve vizuale, pa përdorur gjuhën verbale ose të shkruarit. Ai është një nga format më të fuqishme dhe më të vjetra të komunikimit sepse njeriu i percepton informacionet vizuale në mënyrë të shpejtë dhe të drejtpërdrejtë.

Në shoqërinë bashkëkohore komunikimi vizual është i pranishëm kudo – në dizajn, art, media, reklama, platforma digjitale dhe në hapësirën publike.

Komunikimi vizual ka fuqinë të informojë, të edukojë, të provokojë, të nxisë mendim/reflektim, madje edhe të ndikojë në sjellje, duke përdorur elemente, përmbajtje dhe mesazhe vizuale.

Shenjat dhe simbolet në komunikimin vizual

Elementet bazë të komunikimit vizual janë shenjat dhe simbolet. **Shenja** ka kuptim të drejtpërdrejtë, praktik dhe të qartë dhe shërben për informim ose orientim, si shenjat e qarkullimit rrugor, piktogramet ose shenjat informuese. Funksioni i saj është praktik dhe universal, që mesazhi të kuptohet nga sa më shumë njerëz.

Ndryshe nga shenja, **simboli** ka kuptim më të thellë dhe shumë shtresor. Ai nuk paraqet vetëm informacion, por edhe ide, emocione ose vlera kulturore. Simbolet varen nga konteksti, tradita dhe përvoja kulturore e marrësit. Ato mund të bartin shumë kuptime duke mbetur të thjeshta dhe të lehta për t'u mbajtur mend. Për shembull, simboli i zemrës lidhet me dashurinë, paqja përfaqësohet në mënyrë simbolike me pëllumbin, ndërsa ngjyrat dhe format mund të kenë kuptime të ndryshme në kultura të ndryshme. Shumë simbole studiohen edhe nga psikologjia, sepse pasqyrojnë shtresat e thella të vetëdijes dhe nënvetëdijes njerëzore.

Simbolet shpesh janë paraqitje që imitojnë formën e një krijese ose të një objekti me të cilin janë të lidhura. Nga ana tjetër, ato mund të jenë edhe të krijuara në mënyrë imagjinare, me forma krejtësisht të shpikura. Ato mund të bazohen edhe në asociacione fonetike, siç ndodh në kulturën kineze. Simbolet e këtilla mund të përfshijnë linja grafike dhe gjeometrike, por edhe fjalë dhe lëvizje rituale.

NOCIONET KYÇE

komunikim vizual, shenjë, simbol, mesazh vizual, përmbajtje vizuale, psikologji e ngjyrave, simbolikë e gjuhës vizuale

AKTIVITET

Shqyrtoni një përmbajtje vizuale, identifikoni mesazhet e dukshme dhe të fshehura dhe diskutoni për vlerat etike dhe morale në dizajnin dhe mediat bashkëkohore. Jepni një vështrim kritik për ndikimin e komunikimit vizual te publiku dhe te të rinjtë, si dhe analizoni se çfarë ju tërheq dhe çfarë mund të përmirësohet.



Shenja STOP është një nga shenjat më të njohura të komunikimit vizual në qarkullimin rrugor. Ajo ka funksion të qartë dhe universal – ndalim i detyrueshëm i automjetit. Ngjyra e kuqe simbolizon rrezikun dhe kujdesin e shtuar, ndërsa forma tetëkëndëshe e bën të dallueshme lehtësisht nga të gjitha këndet. Fjala “STOP” është e shkurtër, e qartë dhe e kuptueshme në nivel global, duke e bërë këtë shenjë një shembull të komunikimit efektiv vizual që ndërthur formën, ngjyrën dhe tekstin.



Yin dhe Yang është një simbol i lashtë i filozofisë kineze që përfaqëson ekuilibrin dhe dualitetin në botë. Simboli përbëhet nga dy forca të kundërta, por të lidhura me njëra-tjetrën: yin (i errët, pasiv, femëror, natë, qetësi) dhe yang (i ndritshëm, aktiv, mashkullor, ditë, lëvizje). Forma e tij rrethore tregon plotësimin dhe kalimin e vazhdueshëm nga njëra gjysmë te tjetra, ndërsa pika e vogël në secilën gjysmë simbolizon se në secilën prej tyre ekziston një pjesë e tjetrës. Në komunikimin vizual, Yin dhe Yang përdoret shpesh si simbol i harmonisë, ekuilibrit, unitetit dhe ndërvarësisë.

Përmbajtja vizuale dhe mesazhi vizual

Përmbajtja vizuale transmeton informacione të vlefshme nëpërmjet imazheve mbresëlënëse, ilustrimeve dhe grafikës që tërheqin vëmendjen. Ajo përfshin fotografi, diagrame, grafikë, infografikë, video online, transmetime në kohë reale (live), pamje të ekranit, GIF dhe animacione, meme dhe prezantime me sllajde.

Përmbajtja vizuale është bërë pjesë e domosdoshme e marketingut në epokën digjitale. Markat përdorin gjithnjë e më shpesh përmbajtje vizuale për të tërhequr publikun dhe për të promovuar produktet dhe shërbimet e tyre.

Llojet e përmbajtjes vizuale



GIF dhe animacionet janë forma vizuale të shkurtra, përsëritëse ose dinamike që shërbejnë për transmetimin e shpejtë të informacionit, emocioneve ose mesazheve. Këto përdoren shpesh në rrjetet sociale, faqet e internetit dhe fushatat digjitale për të tërhequr vëmendjen, për të rritur ndërveprimin dhe për të thjeshtuar komunikimin me anë të lëvizjes dhe ritmit vizual.



Fotografitë dhe imazhet janë lloji më i përhapur i përmbajtjes vizuale sot. Një imazh i fuqishëm mund të transmetojë shumë më tepër informacion dhe emocione sesa vetëm teksti. Me imazhe mund të tregojmë, në vend që vetëm të rrëfejme.



Videot dhe transmetimet e drejtpërdrejta mundësojnë rrëfime dinamike dhe tërheqëse. Historitë që zhvillohen me video shkaktojnë ndikim emocional dhe tërheqin vëmendjen e publikut.



Prezantimet dhe prezantimet me slajde janë forma të komunikimit vizual që ndërthurin tekstin, imazhet, grafikën, ilustrimet dhe multimedien për transmetimin e qartë dhe të strukturuar të informacionit. Këto përdoren në arsim, biznes, marketing dhe në paraqitjet publike.



Infografikat shndërrojnë informacionin e ndërlikuar në një format vizual të thjeshtë për t'u kuptuar. Duke gërshetuar vizualizimin e të dhënave, ilustrimet, tekstin dhe dizajnin grafik, infografikat i shndërrojnë statistikatat dhe faktet në histori vizuale.



Grafikat janë paraqitje vizuale e të dhënave që lehtësojnë analizën dhe kuptimin e informacionit. Këto përdoren për të paraqitur trende, krahasime, shpërndarje dhe marrëdhënie midis vlerave të ndryshme, që të dhënat të bëhen të qarta, të organizuara dhe të kuptueshme lehtësisht nga publiku.



E-librat janë versione digjitale të librave, të disponueshme në kompjuterë, tablete ose në lexues për libra elektronikë. Ato mundësojnë qasje të lehtë në informacion dhe shpërndarjen e dijes në mjedisin digjital.



Memet janë ilustrime vizuale ose të kombinuara me tekst për të transmetuar humor, mesazhe, ide ose referenca kulturore në mënyrë të thjeshtë dhe të shpejtë.



Pamjet e ekranit (screenshots) janë paraqitje statike vizuale të përmbajtjes së shfaqur në një pajisje digjitale. Këto përdoren për të treguar informacione, për të shpjeguar procese, për dokumentim, edukim dhe komunikim në mediat digjitale, duke mundësuar transmetimin e qartë dhe të saktë të një momenti ose gjendjeje të ekranit.



Seminaret në internet (webinars) janë seminare online që ndërthurin video, audio, prezantime dhe përmbajtje vizuale interaktive për transmetimin e njohurive dhe të informacionit në kohë reale ose si përmbajtje e regjistruar. Këto përdoren në arsim, biznes dhe marketing, duke mundësuar komunikim vizual, ndërveprim të drejtpërdrejtë me publikun dhe përfshirje më të madhe me anë të pyetjeve, diskutimeve dhe demonstrimeve.

Mesazhi vizual është kuptimi që dizajneri ose autori dëshiron t'i transmetojë publikut. Ai mund të jetë informues, edukues, bindës ose emocional. Një mesazh vizual i suksesshëm është i qartë, dallohet lehtë dhe është i përshtatur për publikun e synuar. Mënyra se si gërshetohen elementet vizuale ndikon drejtpërdrejt në mënyrën se si mesazhi do të kuptohet dhe përjetohet.

► A e dini se...

Shumica e informacionit që truri përpunon është vizual. Njerëzit reagojnë natyrshëm ndaj imazheve dhe stimujve vizualë shumë më shpejt sesa ndaj tekstit ose të folurit. Ky fakt është konfirmuar nga kërkimet në psikologjinë konjitive dhe neuroshkencë dhe thekson rëndësinë e komunikimit vizual në arsim, marketing dhe në jetën e përditshme.

Mesazhet vizuale i perceptojmë dhe i kuptojmë në tri nivele:

- **Niveli reprezentativ** – ajo që shohim dhe e njohim nga jeta e përditshme.
- **Niveli abstrakt** – elementet bazë vizuale (vija, forma, ngjyra) që transmetojnë ndjenja.
- **Niveli simbolik** – shenja dhe simbole të cilave njerëzit u kanë dhënë kuptim, si shkronjat, flamujt ose shenjat e qarkullimit rrugor.

Për të kuptuar nivelin abstrakt dhe simbolik të mesazhit vizual, nevojitet edukim i përshtatshëm. Këto tri nivele na ndihmojnë t'i kuptojmë më mirë mesazhet vizuale që na rrethojnë.

Simbolika dhe psikologjia e ngjyrave

Ngjyrat luajnë rol kyç në komunikimin vizual sepse kanë **ndikim të fortë psikologjik dhe simbolik** te njeriu. Psikologjia e ngjyrave merret me mënyrën se si ngjyrat e ndryshme shkaktojnë ndjenja, asociacione dhe reagime të caktuara.

Për shembull, ngjyra e kuqe shpesh lidhet me energjinë, pasionin, rrezikun ose urgjencën; ngjyra e kaltër me qetësinë, besimin dhe stabilitetin; e gjelbra me natyrën, rritjen dhe ekuilibrin; e verdha me optimizmin dhe vëmendjen; ndërsa e zeza mund të simbolizojë elegancën, fuqinë, por edhe trishtimin ose të panjohurën. Në dizajn dhe në komunikimin vizual, zgjedhja e duhur e ngjyrave është thelbësore për transmetimin efektiv të mesazhit dhe për krijimin e një efekti të dëshiruar emocional.

Gjuha pamore dhe simbolika e saj

Gjuha pamore në komunikimin vizual përbëhet nga elementet dhe parimet bazë figurative. Këto elemente krijojnë “fjalorin vizual” me të cilin transmetohet kuptimi i mesazhit vizual.

Çdo element artistik ka simbolikën e vet. Vija mund të shprehë lëvizje, qetësi ose tendosje; format mund të duken stabile ose dinamike; kontrasti e orienton vëmendjen, ndërsa kompozicioni e organizon tërësinë vizuale. Duke i ndërthurur, komunikimi vizual bëhet i qartë, i lexueshëm dhe i vlefshëm për nga estetika.

Pyetje

1. Çfarë është komunikimi vizual dhe pse është i rëndësishëm?
2. Cili është ndryshimi midis shenjës dhe simbolit në komunikimin vizual?
3. Çfarë është mesazhi vizual dhe cilat janë tri nivelet e kuptimit të mesazheve vizuale?
4. Cilat lloje të përmbajtjes vizuale përdoren më shpesh për komunikim në epokën digjitale?
5. Si ndikojnë psikologjia e ngjyrave dhe simbolika e gjuhës pamore në transmetimin e mesazhit vizual?

FOTOGRAFIA SI MEDIUM VIZUAL

Fotografia i referohet procesit ose praktikës së krijimit të një fotografie – një imazhi që formohet si rezultat i veprimit të dritës mbi një material të ndjeshëm ndaj saj. Varësisht nga konteksti dhe qëllimi i autorit, fotografia bëhet pjesë përbërëse e jetës së përditshme dhe mund të ketë role të ndryshme. Fotografia mund të dokumentojë ngjarje, të transmetojë emocione, të përcjellë mesazhe dhe të shërbejë si medium i shprehjes artistike.

Fotografitë mund të ndahen në lloje të ndryshme sipas teknikës së realizimit, funksionit dhe përdorimit të tyre. Të kuptuarit e llojeve të ndryshme të fotografisë na ndihmon t'a vlerësojmë më mirë rolin e saj, të analizojmë mesazhet vizuale dhe të bëhemi vëzhgues dhe krijues kritikë të përmbajtjeve vizuale.

Fotografia analoge dhe fotografia digjitale

Llojet e fotografisë sipas teknikës së realizimit janë: analoge dhe digjitale.

Fotografia analoge e përdor filmin si material të ndjeshëm ndaj dritës dhe imazhi krijohet me anë të procesit kimik. **Fotografia digjitale** përdor sensorin digjital për regjistrimin e imazhit dhe ruhet si skedar digjital (JPEG, RAW, TIFF).

Fotografia bardh e zi dhe fotografia me ngjyra

Fillimisht, e gjithë fotografia ka qenë monokrome, pra bardh e zi. Edhe pas shfaqjes dhe përhapjes së gjerë të filmit me ngjyra, fotografia bardh e zi vazhdoi të dominojë për dekada për shkak të kostos më të ulët, stabilitetit më të madh kimik dhe pamjes “klasike”.

Fotografia bardh e zi përdoret gjerësisht në art, në dokumentimin e realitetit dhe në gazetari.

Fotografia me ngjyra përdor ngjyrat për të paraqitur botën në mënyrë më reale dhe dinamike. Ngjyra luan rol të rëndësishëm në transmetimin e atmosferës, emocioneve dhe kuptimit, dhe përdorimi i saj lidhet me psikologjinë e ngjyrave. Ajo dominon në fotografinë reklamuese, të modës, të peizazhit dhe atë komerciale.

NOCIONET KYÇE

fotografi, fotografi analoge dhe digjitale, fotografi bardh e zi dhe me ngjyra, zhanr fotografik, fotografi artistike, fotografi e portretit, fotografi e peizazhit, fotografi e gazetarisë dhe dokumentare, fotografi reklamuese, fotografi publike dhe private

► A e dini se...

Fjala “fotografi” është përdorur për herë të parë në vitin 1839 nga Sër Xhon Hershelli dhe vjen nga fjalët greke phos (“dritë”) dhe graphê (“vizatim”), që do të thotë “vizatim me dritë”.

Llojet e fotografisë

Fotografia përfshin shumë zhanre që, përveç teknikës, klasifikohen edhe sipas temës dhe qëllimit. Këto zhanre ndryshojnë nga shprehja artistike deri te dokumentimi teknik dhe përdorimi komercial. Ndër llojet më të rëndësishme janë fotografia artistike, e portretit, e peizazhit, e modës, e gazetarisë, e reklamës, fotografia dokumentare, si dhe fotografia publike dhe private. Llojet e fotografisë shpesh mbivendosen dhe një imazh mund të ketë më shumë se një funksion njëkohësisht.

Fotografia artistike është formë e artit bashkëkohor në të cilën fotografi vepron si artist, duke përdorur kamerën, jo vetëm për të regjistruar realitetin, por edhe për ta transformuar. Qëllimi nuk është dokumentimi, por krijimi – gjetja e kuptimit, emocionit ose bukurisë përtej së dukshmes, për të shprehur vizionin krijues dhe estetik të autorit.

Fotografia e portretit është një nga zhanret më të popullarizuara të fotografisë. Ajo përqendrohet në paraqitjen e personalitetit, karakterit, identitetit dhe emocioneve të një individi ose grupi njerëzish.

Fotografia e peizazhit paraqet hapësirën natyrore ose urbane, nga pamjet madhështore, deri te hollësitë më të imëta, me qëllim të pasqyrojë bukurinë dhe atmosferën e ambientit.

Fotografia e modës lidh fotografimin me modën, dizajnin dhe reklamën. Ajo shpesh është skenike, konceptuale dhe vizualisht shumë e fuqishme.

AKTIVITET

Hulumtoni lloje të ndryshme të fotografisë dhe veçoritë e tyre bazë. Pastaj fotografoni dhe krijoni skedarë digjitalë me fotografi nga zhanre të ndryshme. Klasifikoni sipas llojit dhe krijoni një album fotografik. Prezantoni albumin tuaj para nxënësve të tjerë, shpjegoni ndarjen dhe theksoni veçoritë kryesore të secilit zhanr.

Fotografia e gazetarisë tregon lajme dhe ngjarje duke paraqitur realitetin në mënyrë objektive, të ndershme dhe etike. Ajo shërben si dokument vizual i historisë, duke regjistruar ngjarjet, konfliktet dhe jetën e përditshme për mediet.

Fotografia komerciale ka për qëllim promovimin e produkteve, shërbimeve ose markave dhe luan rol kyç në marketing dhe komunikimin vizual.

Fotografia dokumentare paraqet realitetin, pra ka për qëllim të dëshmojë, informojë dhe të ruajë momentet historike. Ky lloj i fotografisë ka vlerë të madhe shoqërore dhe kulturore.

Fotografia publike dhe private

Fotografia publike u referohet fotografive të krijuara në hapësirën publike dhe të paracaktuara për audiencën më të gjerë, si fotografitë nga ngjarjet, festalet ose mjedisi urban. **Fotografia private**, nga ana tjetër, krijohet për përdorim personal, për shembull fotografia familjare ose albumet personale. Edhe ky lloj i fotografisë ka vlerë të rëndësishme emocionale dhe kujtimore.

Shembuj historikë dhe bashkëkohorë të llojeve të fotografisë



▶ Françeska Uudman "Hapësira",
Providencë, 1976



▶ Stiv MekKur, "Vajza afgane", 1984



▶ Dorotea Lange, "Nëna migrante",
Kaliforni, 1936



▶ Alfred Ajzenshtat, "Dita e fitores mbi Japoninë",
1945



▶ Ansel Adams, "Lindja e hënës", Nju
Meksiko, 1941



▲ Elina Broterus, "E verdhë në borë", 2019



▲ Riçard Avedon, "Dovima me elefantë", 1955



▲ Xhejms Uelling,
"0158", 2006

Pyetje

1. Cili është dallimi midis fotografisë analoge dhe asaj digjitale sipas teknikës së realizimit?
2. Pse fotografia bardhë e zi përdoret ende edhe sot, pavarësisht zhvillimit të fotografisë me ngjyra?
3. Cilat janë disa nga zhanret kryesore të fotografisë?
4. Çfarë e dallon fotografinë artistike nga fotografia dokumentare?
5. Pse fotografia e gazetarisë konsiderohet si dokument i rëndësishëm vizual i historisë?

MEDIAT DIGJITALE DHE SHPREHJA MULTIMEDIALE

Edukimi digjital

Në jetojmë në botën digjitale. Mendoni se çfarë bëjmë çdo ditë. Përdorim internetin, kërkojmë informacione, klikojmë në lidhje interneti dhe shikojmë përmbajtje të ndryshme. Të gjitha këto i bëjmë në mënyrë natyrale, pa u menduar shumë.

Këto janë aftësi digjitale. Sot, ashtu siç është e rëndësishme të dimë të lexojmë dhe të shkruajmë, po aq e rëndësishme është të dimë edhe "shkrim-leximin" digjital.

Edukimi digjital nënkupton aftësinë për të gjetur, kuptuar, krijuar dhe ndarë informacione me ndihmën e teknologjisë digjitale, si dhe përdorimin e sigurt dhe të përgjegjshëm të internetit dhe mediave digjitale.

Koncepti i edukimit digjital është zhvilluar gjatë shekullit XX dhe vazhdon edhe në shekullin XXI, duke kaluar nga përkufizimi teknik i aftësive dhe kompetencave, në kuptimin më të gjerë të ndërveprimit me teknologjitë digjitale. Ky zhvillim është përshpejtuar veçanërisht me përparimin e teknologjive të inteligjencës artificiale (AI), të cilat janë të projektuara për të simuluar inteligjencën njerëzore nëpërmjet përdorimit të sistemeve të ndërlikuara, si: algoritmet e të mësuarit automatik, përpunimi i gjuhës natyrore dhe robotika.

NOCIONET KYÇE

edukim digjital, art digjital, videoart, animacion, dizajn interaktiv (IxD), përvojë dhe ndërfaqe e përdoruesit (UX/UI), ueb arti, ekspozitë virtuale (VR/3D)



Arti digjital

► A e dini se...

Bipël ka krijuar nga një imazh digjital çdo ditë për më shumë se 13 vjet dhe më pas i ka bashkuar në kolazhin “Çdo ditë: 5000 ditët e para”, i cili u shit si NFT për gati 70 milionë dollarë.

*NFT është shkurtime i Non-Fungible Token, që në shqip përkthehet “token i pazëvendësueshëm”, që do të thotë se personi që e blen zotëron kopjen unike digjitale me dëshmi pronësie.

Arti digjital është term që përdoret për artin që krijohet ose paraqitet me ndihmën e teknologjisë digjitale.

Termi art digjital u përdor për herë të parë në fillim të viteve 1980, kur inxhinierët e kompjuterëve krijuan një program vizatimi që u përdor nga pionieri i artit digjital, Harold Koheni. Ky sistem u bë i njohur si AARON, një makinë robotike e projektuar për të krijuar vizatime të mëdha në fletë letre të vendosura në dysHEME.



►
Harold Kohen,
“Pa titull, vizatim kompjuterik”,
1982



► Bipël, “Çdo ditë: 5000 ditët e para”, kolazh digjital prej 5,000 imazhesh të përditshme të krijuara nga maji i vitit 2007 deri në vitin 2020

Video arti

Video arti është një lloj arti bashkëkohor në të cilin koha, lëvizja, zëri dhe efektet vizuale përdoren si mjete kryesore të shprehjes. Ai përfshin video të shkurtra ose të gjata, instalacione, performanca dhe projeksione, dhe shpesh eksploron konceptet, emocionet ose temat shoqërore në një mënyrë që nuk është e kufizuar nga format tradicionale të shprehjes.

Për shembull, vepra “Qendra e qëndrimit të përkohshëm” e Adrian Pacit është video artistike që paraqet një grup njerëzish të cilët qëndrojnë në shkallët e një avioni të vendosura në pistën e aeroportit, pa një drejtim konkret. Me anë të kësaj skene të thjeshtë, por të fuqishme, artisti eksploron temat e emigrimit, pritjes dhe pasigurisë së njeriut bashkëkohor. Vepra përfaqëson një kritikë ndaj politikave të kufijve dhe ndjenjës së përkatësisë në botën bashkëkohore.



▲ Adrian Paci, “Qendra e qëndrimit të përkohshëm”, kuadër nga një videoprojeksion në formatin 16:9, me ngjyra, zë, 5 minuta e 30 sekonda, 2007

Animacioni dhe spoti

Animacioni është arti i krijimit të iluzionit të lëvizjes dhe të ndryshimit nëpërmjet paraqitjes së një serie të shpejtë dhe të njëpasnjëshme imazhesh statike, pra “kuadrosh”. Duke ardhur nga fjala latine “animare” që do të thotë “t’i japësh jetë”, ai përfshin manipulimin e vizatimeve, modeleve ose imazheve të gjeneruara me kompjuter, për të simuluar lëvizjen, si dhe përfaqëson një medium të fuqishëm për rrëfim, edukim dhe argëtim.

Llojet kryesore:

- **Animacioni tradicional** – kuadro të vizatuara me dorë, zakonisht në letër ose në fletë celuloidi transparente.
- **Animacioni 2D** – vizatime vektoriale ose digjitale që krijojnë imazhe të sheshta në lëvizje.
- **Animacioni 3D** – imazhe të gjeneruara nga kompjuteri (CGI) që krijojnë modele tredimensionale me thellësi, ndriçim dhe teksturë.
- **Animacioni stop-motion** – fotografimi i objekteve ose i figurave fizike që lëvizin pak nga pak midis çdo kuadri.

Animacioni përdoret gjerësisht në film, televizion, videolojëra, marketing, ndërfaqe përdoruesi dhe përmbajtje online. Ai është njëkohësisht disiplinë teknike dhe formë artistike që i jep jetë koncepteve imagjinare.



▲ Kuadro nga filmi i animuar “Klaus”, i njohur për stilin e tij unik të kombinimit të animacionit tradicional 2D me 3D dhe me teknikat moderne digjitale të ndriçimit dhe teksturës, duke krijuar efekt vizual mbresëlënës, viti 2019

Spoti

Spoti është videomaterial i shkurtër që kombinon muzikën, elementet vizuale dhe narracionin për të përcjellë mesazh ose histori në mënyrë dinamike dhe tërheqëse. Qëllimi i tij kryesor është promovimi i muzikës, markave ose ideve krijuese, por shpesh përdoret edhe si formë e shprehjes vizuale. Shembuj të përmbajtjeve të këtilla janë videoklipet muzikore, reklamat dhe performancat e shkurtra vizuale.


Dizajni interaktiv dhe ueb arti

Dizajni interaktiv (IXD) paraqet praktikën e projektimit dhe dizajnit të produkteve, shërbimeve dhe sistemeve interaktive. Qëllimi i tij është të lidhë njerëzit me teknologjinë që përdorin, duke krijuar ndërfaqe (interface) efikase, intuitive dhe tërheqëse.

Dizajni interaktiv (IxD) lidhet ngushtë me:

- **Përvojën e përdoruesit (UX)** – përqendrohet në përvojën e përdoruesit me produktin ose shërbimin: sa i lehtë, efikas dhe i kënaqshëm është përdorimi i tij. Dizajni interaktiv (IxD) ndihmon në krijimin e kësaj përvoje nëpërmjet ndërveprimeve të dizajnuara mirë.
- **Ndërfaqen e përdoruesit (UI)** – i referohet pjesës vizuale dhe taktile të ndërfaqes: butonave, menuve, ikonave, ngjyrave dhe organizimit të elementeve. Dizajni interaktiv (IxD) siguron që ndërfaqja të jetë interaktive dhe logjike për përdoruesin.

Dizajni interaktiv (IxD) është ura lidhëse midis përvojes së përdoruesit (UX) dhe ndërfaqes së përdoruesit (UI), pasi projektton dhe dizajnon mënyrën se si përdoruesi ndërvepron me ndërfaqen.



AKTIVITET

Ndahuni në grupe dhe realizoni videoklipe nga aktivitetet shkollore. Më pas kombinoni materialet e regjistruara për të krijuar një videoprezantim ose një film të shkurtër. Qëllimi është të zhvillohen aftësitë për filmim, montazh dhe punë në grup.



Ueb arti (web art) paraqet krijimtari artistike që përjetohet nëpërmjet internetit, ku platforma e uebit përdoret edhe si hapësirë krijuese, edhe si mjet shpërndarjeje. Ai është shpesh interaktiv dhe i përfshin përdoruesit në procesin e krijimit ose të përjetimit të veprës, duke i sfiduar përkufizimet tradicionale të artit dhe kufizimet institucionale. Ueb arti përfshin forma të ndryshme, si animacionet e bazuara në ueb, projektet interaktive dhe veprat që përdorin teknologjitë e internetit. Ai u zhvillua veçanërisht gjatë viteve 1990, me artistë të rëndësishëm si Olia Lialina.



▲ Olia Lialina, "Verë", 2013

Ekspozitat virtuale

Ekspozitat virtuale janë prezantime digjitale, online të artit, historisë ose biznesit që simulojnë hapësira reale me anë të teknologjive, si: realiteti virtual (VR), shëtitjet 3D dhe mjetet multimediale. Ato u mundësojnë njerëzve nga e gjithë bota të vizitojnë ekspozitat 24 orë në ditë, 7 ditë në javë, duke ofruar një përvojë interaktive dhe gjithëpërfshirëse për eksplorim, mësim dhe komunikim nga çdo vend. Përparësitë kryesore të ekspozitave virtuale janë: qasja më e gjerë e publikut në veprat artistike, interaktiviteti dhe përvoja multimediale. Mediat digjitale dhe shprehja multimediale mundësojnë liri krijuese, interaktivitet dhe qasje globale. Edukimi digjital dhe format e ndryshme të artit digjital janë thelbësore për zhvillimin e gjuhës bashkëkohore vizuale.

Pyetje

1. Çfarë nënkupton edukimi digjital?
2. Cilat janë llojet kryesore të artit digjital dhe me cilat teknologji krijohen?
3. Çfarë roli ka videoarti dhe cilat tema mund të trajtojnë?
4. Çfarë përfaqëson dizajni interaktiv?
5. Cilat janë përparësitë e ekspozitave virtuale për artistët dhe publikun?

FJALOR I NOCIONEVE

A

Abstraksion gjeometrik – Stil që përdor forma gjeometrike të organizuara me përpikëri, për të krijuar efekte vizuale dhe psikologjike.

Absurd – Palogjikshmëri dhe gërshetim irracional elementesh për të shkaktuar tronditje ose reflektim.

Animacion – Teknikë e krijimit të lëvizjes nëpërmjet një serie imazhesh statike ose kuadrosh digjitalë.

Art abstrakt – Shprehje artistike që heq dorë nga paraqitja konkrete dhe përqendrohet te ngjyra, vija dhe forma si elemente të pavarura.

Art modern – Art që zhvillohet duke braktisur kanonet tradicionale, duke përqafuar stilet, teknikat dhe shprehjet individuale.

Art Nouveau – Stil dekorues artistik me vija organike dhe motive lulësh që bashkon artin dhe dizajnin.

Arkitekturë e qëndrueshme – Koncept arkitektonik që siguron efikasitet afatgjatë energjetik dhe përdorim racional të burimeve.

Art urban – Shprehje artistike në hapësirën publike të qytetit që komunikon drejtpërdrejt me komunitetin dhe mjedisin.

Automatizëm – Teknikë e shkrimit ose e vizatimit të lirë, pa kontroll të vetëdijshëm, për të zbuluar nënvetëdijen.

B

Bauhaus – Shkollë dhe lëvizje që bashkon artin, dizajnin dhe arkitekturën, duke theksuar funksionalitetin dhe gjuhën vizuale abstrakte.

Brankushi – Konstantin Brankushi krijoi skulptura abstrakte me linja të pastra dhe forma të stilizuara.

Bust – Paraqitje skulpturore e figurës njerëzore që përfshin kokën, qafën dhe një pjesë të krahavorit.

D

Dizajn grafik – Komunikim vizual me anë të imazhit, formës dhe tekstit, për të përcjellë mesazh.

E

Ekspresionizëm abstrakt – Lëvizje artistike amerikane që theksoi gjestin personal, emocionin dhe nënvetëdijen si elemente qendrore të shprehjes artistike.

Ekspozitë virtuale (VR/3D) – Ekspozitë digjitale në hapësira virtuale ose tredimensionale që ofrojnë përvojë imersive vizuale.

F

Fasadë – Pjesa e jashtme e dukshme që formëson identitetin vizual të objektit.

Figuracion – Paraqitja e formave dhe sendeve të njohura, përfshirë figura njerëzore ose shtazore.

Fluksus – Lëvizje artistike që theksoi eksperimentin, përzierjen e mediave dhe shkatërrimin e kufijve mes artit dhe jetës.

Font – Set i dizajnuar i shkronjave, numrave dhe shenjave me stil të përbashkët vizual.

Formë gjeometrike – Elemente bazë vizuale që strukturojnë kompozicionin dhe e reduktojnë formën natyrore në forma abstrakte.

Fotografi – Art dhe teknikë e kapjes së imazheve nëpërmjet dritës dhe kamerës.

Fotografi artistike – Fotografi e krijuar me qëllim estetik, eksperimental ose konceptual.

Fotorealizëm – Stil pikturë që synoi saktësi të ngjashme me fotografinë në imtësi dhe realizëm.

Fovizëm – Lëvizje artistike që theksoi ngjyrat e forta, të papërziera dhe shprehjen e lirë mbi realizmin

G

Gogen – Pol Gogen përdori ngjyrën dhe simbolikën për të paraqitur tema shpirtërore dhe ekzotike.

Globalizëm – Ndërlidhje e vendeve dhe kulturave në nivel botëror.

GJ

Gjest – Lëvizje fizike e artistit që përcjell energjinë dhe shprehjen emocionale.

H

Hapësirë – Mjedis tredimensional në të cilin vendosen format dhe zhvillohet aktiviteti njerëzor.

Harmoni – Organizimi i elementeve në veprën artistike, për ekuilibër vizual dhe emocional.

I

Iluzion optik – Efekt vizual që krijon ndjesinë e lëvizjes, vibrimit ose ndryshimit në perceptimin e shikuesit.

K

Kandinski – Vasili Kandinski, anëtar i “Kalorësit blu”, ishte pionier i shprehjes abstrakte dhe i dimensionit shpirtëror në art.

Komunikim vizual – Përcjellje e informacionit dhe e ideve me anë të imazheve, formave, ngjyrave dhe elementeve të tjera vizuale.

Kontekst – Rrethanat historike, shoqërore dhe kulturore në të cilat është krijuar vepra.

Kosuth – Jozef Kosuth është përfaqësues i rëndësishëm i artit konceptual, i njohur për përdorimin e tekstit dhe formave minimalistike për të përcjellë konceptin.

Kostumografi – Dizajnimi i kostumeve për teatër, film ose skenë, e që mbështesin karakterin dhe narrativën.

Kubizëm – Lëvizje artistike që e fragmentoi formën në elemente gjeometrike dhe e paraqiti nga disa kënde njëkohësisht.

Kusama – Jajoi Kusama përdori motive përsëritëse dhe instalacione për të krijuar hapësira imersive që e përfshijnë shikuesin.

L

Laps – Mjet tradicional vizatimi që mundëson precizitet, gradim tonal dhe kontroll të vijës.

Lazurë – Shtresë e tejdukshme ngjyre e vendosur mbi një bazë ose shtresë tjetër për të krijuar thellësi, efekte drite dhe kalime të buta tonale.

Land art – Praktikë artistike që përdor peizazhin natyror si material dhe hapësirë për krijimin e veprave.

Logo – Shenjë grafike që përfaqëson identitetin e një organizate, produkti ose ngjarjeje.

M

Maleviç – Kazimir Maleviç ishte themelues i suprematizmit, përdori forma gjeometrike për abstraksion dhe shprehje të pastër vizuale.

Matricë – Sipërfaqe e përgatitur nga e cila transferohet imazhi gjatë shtypjes.

Matis – Anri Matis është figurë prijëse e fovizmit, i njohur për kompozime harmonike dhe ngjyra të fuqishme.

Mesazh vizual – Informacion ose ide që transmetohet dhe interpretohet me anë të mjeteve vizuale.

Monet – Klod Mone ishte një nga themeluesit e impresionizmit, i njohur për një seri pikturash që studiojnë dritën dhe të njëjtën skenë në kohë të ndryshme.

Mondrian – Pit Mondrian zhvilloi neoplasticizmin me kompozime të përpikta gjeometrike dhe ngjyra primare.

Mural – Pikturë në format të madh, që realizohet drejtpërdrejt në sipërfaqe muri, në hapësira publike ose private.

N

Neodada – Lëvizje e inspiruar nga dadaizmi që theksoi absurditetin, lojën dhe provokimin.

Nënvetëdije – Shtresa të thella psikike që drejtojnë intuitën, ëndrrat dhe impulset irracionale.

Ndjenjë – Reagim emocional i shkaktuar nga përjetimi i veprës artistike.

O

Objekt sakral – Ndërtesë arkitekturore e dedikuar për rite fetare dhe shpirtërore.

Op art – Lëvizje artistike që krijon efekte vizuale dinamike nëpërmjet abstraksionit të saktë gjeometrik.

Ornament – Element dekorues që pasuron sipërfaqen me ritëm dhe bukuri vizuale.

P

Perceptim vizual – Mënyra se si syri dhe truri përpunojnë ngjyrën, formën dhe lëvizjen në veprën artistike.

Performancë artistike – Shfaqje e përkohshme dhe e drejtpërdrejtë që përfshin publikun dhe krijon përvojë të menjëhershme.

Pikaso – Pablo Pikaso ishte themelues i kubizmit, i njohur për trajtimin revolucionar të formës dhe perspektivës.

Pikturim me fusha ngjyrash – Stil që përqendrohet në pikturimin e sipërfaqeve të mëdha me ngjyra, si bartëse të emocioneve dhe atmosferës.

Plasticitet – Cilësi e vizatimit ose e formës që sugjeron vëllim, thellësi dhe ndjesi tredimensionale në hapësirë.

Plein air – Pikturim në natyrë të hapur për të kapur dritën dhe atmosferën autentike.

Pointilizëm – Teknikë pikturimi me pika të vogla ngjyre që nga larg krijojnë një tërësi vizuale.

Pollok – Xhekson Pollok është i njohur për pikturën aksion dhe teknikën e pikturimit me spërkatje të ngjyrës.

Postimpresionizëm – Drejtim artistik që lindi nga impresionizmi, por që i theksoi më tepër emocionin, formën dhe shprehjen personale.

Postmodernizëm – Lëvizje artistike dhe kulturore që refuzoi kanonin modernist absolut dhe theksoi ironinë, eklekticizmin dhe ndërtekstualitetin.

Proporcion – Marrëdhënia midis dimensioneve të pjesëve dhe të tërësisë në formën arkitekturore.

R

Ready-made – Objekte të përditshme të transformuara në vepra arti me ndërhyrje minimale nga artisti.

Realitet virtual (VR) – Teknologji që krijon mjedis plotësisht digjital ku përdoruesi mund të lëvizë dhe të ndërveprojë.

Reliev – Formë skulpturore që ngrihet nga një sipërfaqe e sheshtë, duke mbetur e lidhur me të.

Rotko – Mark Rotko krijoi piktura me fusha të mëdha ngjyrash që shkaktojnë reagim emocional intensiv.

S

Sezan – Pol Sezan, postimpresionist që studioi formën dhe hapësirën me anë të gjeometrizimit të natyrës

Simbol – Shenjë vizuale ose materiale që përfaqëson një ide ose kuptim përtej pamjes së drejtpërdrejtë.

Simbolikë – Përdorimi i shenjave dhe i motiveve vizuale me kuptime më të thella.

Skicë – Vizatim i shpejtë paraprak që shënon idenë, formën dhe kompozimin bazë të veprës.

Surrealizëm – Lëvizje artistike që synoi të paraqesë nënvetëdijen, ëndrrat dhe fantazinë si pjesë të shprehjes artistike.

Subjektivitet – Vështrimi personal dhe përjetimi individual i artistit që dominon veprën.

T

Teknika artistike – Mënyrat dhe proceset me anë të të cilave artisti realizon veprën.

Teknika grafike – Procese të shtypjes me të cilat krijohen shumëfishime artistike nga një matricë e përgatitur paraprakisht.

Teknika të pikturës – Mënyra dhe procese të aplikimit të ngjyrës për efekte të ndryshme vizuale dhe shprehëse.

Tekst – Mjet i përdorur shpesh në artin konceptual, për të paraqitur idenë në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe të qartë.

Tërësi organike – Lidhje harmonike e të gjithë elementeve të veprës në një unitet të vetëm, të pandashëm artistik.

Tipografi – Art dhe teknikë e formësimit dhe e rregullimit të tekstit për komunikim të qartë dhe estetik.

Tirazh – Numri i përgjithshëm i kopjeve të shtypura nga një matricë e vetme.

Tush me penë/dru/furçë – Teknikë vizatimi me ngjyrë që përdor penën, shkopin e drurit ose furçën për të krijuar vija me intensitet dhe karakter të ndryshëm, nga të holla e të kontrolluara, deri te të lira dhe ekspresive.

Th

Thëngjill vizatimi – Material i butë vizatimi për tone të thella, kontraste të forta dhe gjurmë ekspresive.

U

Urbanizëm – Planifikimi dhe organizimi i hapësirave urbane për zhvillim funksional dhe harmonik.

V

Van Gog – Vinsent van Gog përdor ngjyrën dhe lëvizjen dinamike të penelit për shprehje të fuqishme emocionale.

Vasareli – Viktor Vasareli ishte pionier i op-artit, i njohur për kompozime që krijojnë iluzion të lëvizjes dhe thellësisë.

Vepër artistike – Shprehje vizuale ose materiale me anë të së cilës artisti ndan ide, emocione ose qëndrime.

Video art – Praktikë artistike që përdor videon si medium për shprehje eksperimentale ose narrative.

Vijë – Element bazë vizual që përcakton drejtimin, formën dhe lëvizjen në vizatim.

Vijë konturore – Vijë që përcakton kufirin e jashtëm të formës.

Vijë teksturore – Vijë që sugjeron veçoritë sipërfaqësore dhe materialin e objektit.

Vizatim – Formë bazë e shprehjes vizuale me anë të vijës dhe formës.

Vëllim – Masa hapësinore që zë trupi ose objekti në hapësirën tredimensionale.

SH

Shrafurë – Metodë e hijezimit me vija paralele ose të kryqëzuara për krijimin e tonit dhe vëllimit.

Shtresëzim – Prania e shumë kuptimeve dhe niveleve në një vepër arti.

ZH

Zhanër fotografik – Kategori e fotografisë që përcaktohet sipas temës, stilit ose funksionit (p.sh. portret, peizazh).

LITERATURA E PËRDORUR

Ministria e Arsimit dhe Shkencës e Republikës së Maqedonisë së Veriut. (2025). Programi mësimor i Artit figurativ për vitin e II të gjimnazit.

- Abazieva, S. (2002). Dlaboko dišenje: Antologija na ženskoto pismo vo makedonskata likovna umetnost na 20 vek. Skenpoint.
- Abazieva, S. (2017). Multimedijalna umetnost. Osten.
- Abazieva, S., & Aleksiev, E. (2015). Vizuelnite umetnosti vo Makedonija – Kniga I: slikarstvo, skulptura, grafika. Osten.
- Adams, L. (1999). Art across time: Volume II (The thirteenth century to the present). McGraw-Hill.
- Cramsie, P. (2010). The story of graphic design. Abrams.
- Davis, M. (2017). Teaching design. Allworth Press.
- Dondis, D. A. (1973). A primer of visual literacy. MIT Press.
- Ferrier, J. (Ed.). (1999). Art of our century. Chêne-Hachette.
- Frangovska, A. (2023). Tehnologija, politika i ekologija u makedonskoj savremenoj umetnosti kao odraz transdisciplinarnosti i transmedijalnosti (Doctoral dissertation, University Singidunum, Belgrade).
- Jovanović, G. (Ed.). (2021). Vo dijalog: vizuelna i primeneta likovna programa na KSP Centar – Jadro (2020–2021). Centar Jadro.
- Lucie-Smith, E. (2009). Lives of the great modern artists. Thames & Hudson.
- Lupton, E. (2010). Thinking with type. Princeton Architectural Press.
- Ocvirk, O., Stinson, R., Wigg, P., Bone, R., & Cayton, D. (1998). Art fundamentals: Theory and practice. McGraw-Hill.
- Tate. (n.d.). <https://www.tate.org.uk>
- The Metropolitan Museum of Art. (n.d.). <https://www.metmuseum.org>
- The Museum of Modern Art. (n.d.). <https://www.moma.org>

LISTA E FOTOGRAFIVE TË VEPRAVE ARTISTIKE

